

Melihate Zeqiri Meleqe Kursoni Dafina Roka

LIBËR PËR MËSUESIN/EN

Gjuhë shqipe **8**



BOTIME

pegi

Melihate Zeqiri

Meleqe Kursoni

Dafina Roka

LIBËR PËR MËSUËSIN/EN GJUHË SHQIPE 8

Për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI

Recensentë të MASHTI-t:

????????????

Redaktore letrare: Aida BARO

Korrektorë letrarë: Brunilda MENO, Arlon LIKO

Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA, Elidor KRUIJA

Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

ISBN: 978-9951-843-22-5

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Të gjitha tekstet letrare dhe jolettrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;

e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al

Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;

e-mail: marketing@botimepegi.al

Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;

e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Hyrje

Libri i mësuesit për “Gjuhën shqipe 8” vjen te ju me dëshirën e mirë për t’ju ardhur sadopak në ndihmë gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Ai mbështetet në programin e lëndës *Gjuhë shqipe 8*, udhëhiqet nga parimet dhe kërkesat e tij për të ndërtuar mësimdhënien dhe për të pajisur nxënësit me kompetencat kyçe dhe të fushës.

Kompetencat e fushës që lidhen me **kompetencat kyçe** gjatë organizimit të mësimdhënies janë:

1. *Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme*; 2. *Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar*; 3. *Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare*; 4. *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale*; 5. *Përdorimi i drejtë i gjuhës*.

Çdo orë mësimore ka në përmbajtjen e saj një sërë kompetencash, ku nxënësit flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri e shkathtësi rreth sistemit gjuhësor, megjithatë theksi vihet në njërin nga kompetencat e fushës (Në librin e Gjuhës shqipe 8, kompetencën *Flasim dhe dëgjojmë* e gjejmë dhe te kompetenca e përbashkët *Bashkëbisedojmë*).

Gjatë hartimit të plan-ditarëve për temat mësimore janë përzgjedhur me kujdes metoda, teknika dhe mjete të përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. Metodatat e të nxënit janë parë si prioritet dhe si përpjekje për hulumtim të vazhdueshëm, nxitje për nxënësit në procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate sa më të mira. Ndër to mund të përmendim metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagram piramidal, lexim i drejtuar, imagjinatë e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, karrigia e autorit, ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, tabela e koncepteve, diagrami i Venit, secili mëson një, shqyrtim i përbashkët, informacion kthyes, prezantim digjital* etj.

Gjithashtu, organizimi i orëve mësimore u ka dhënë rëndësi situatave të të nxënit (**lidhja e temës me njohuritë e mëparshme**), ku nxënësit/es i kërkojnë arsyetime apo përgjigje që e inkurajojnë dhe e bëjnë atë të reflektojë mbi njohuritë e tij/saj dhe të ndërmarrë situata të reja. Situatat e të nxënit e bëjnë nxënësin/es që të eksplorojë, zbatojë dhe integrojë njohuritë e aftësitë gjuhësore, të zhvillojë të menduarit krijues dhe kritik. Plani analitik mësimor i hartuar për t’i ardhur në ndihmë mësimdhënësit/es, ka mbajtur parasysh me korrektësi shpërndarjen e orëve sipas kompetencave të fushës. Në hartimin e planit analitik është respektuar ngarkesa mësimore, për çdo kompetencë përdoret: 60 - 70% njohuri të reja dhe 30 - 40% përpunim njohurish, projekte, vlerësim, kurrikul në bazë shkolle. Shtjellimi i temave mësimore bën përpjekje të vazhdueshme për të pasuruar orën mësimore, duke synuar integrimin me fusha të tjera të të nxënit, si dhe me ato ndërkurrikulare, të cilat ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre.

Llojet e vlerësimit: ai diagnostikues, i vazhdueshëm - vlerësimi për të nxënit (formues) dhe përmbledhës, identifikojnë njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë e nxënësve, si dhe janë procese që pasqyrohen në çdo orë mësimi, por edhe në mbyllje të çdo tremujori. Testimet me përgjigjet përkatëse do të jenë tregues i vlefshëm i progresit të nxënësve. Gjithashtu, risi origjinale e këtij libri është edhe CD-ja e përgatitur në funksion të temave të kompetencës *Dëgjojmë*. Në varësi të mundësive, kushteve dhe mjeteve didaktike të mësuesit/es, fragmentet përkatëse gjenden gjithashtu të shkruara në këtë libër.

Punë të mbarë!

Lëndët e fushës kurrikulare	Plani vjetor Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi Shkalla:4 Klasa: VIII TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës
	Gjysmëvjetori i parë 83 orë		Gjysmëvjetori i dytë 102 orë		
	Shtator-Tetor 43 orë	Nëntor-Dhjetor 40 orë	Janar-Shkurt-Mars 54 orë	Prill-Maj-Qershor 48 orë	
	1. Njohja me nxënësit dhe planin mësimor 2. Rrëfime popullore / Rrëfime nga e kaluara 3. Rrëfime nga e kaluara Bashkëbisedim 4. Histori gjuhe -Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar 5. Kush e solli Dhoqinën 6. Mençuria e popullit 7. Mençuria e popullit/ (shkruesimë rrëfime tjera) 8. Ciklopi 9. Fabula - Gjeli i vogël, maçoku dhe kocomiu 10. Dokumentet e para të shkrimit shqip 11. Histori gjuhe/ përpnim njohurish 12. Urtësia e popullit 13. Përpunim njohurish/ Rrëfime popullore 14. Lektyrë	44./45. Teksti realist / Lektyrë (roman lexuar nga nxënësit/et) 46. Teksti realist / bashkëbisedojmë / shkruesimë 47. Leksikologji /Fjalët me ngjyrim emocional 48.Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve 49. Tekste fantastke/ Liliputët 50. Ujqërit e kuq- lexojmë shkruesimë – bashkëbisedojmë 51. Leksikologji/Sinonimet, antonimet, homonimet Fjalët me ngjyrim emocional 52. Gjuha standard dhe gjuha e letërsisë	84. Tekste poetike Nana me buzë në gaz 85. In memoriam(Gjyshes) 86/87. Folja (rishikim njohurish) Folja në mënyrat kushtore dhe habitore 88. Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore 89./90. Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore 91. Teksti poetik - Vrrull 92.Ora e Shalës 93. Analizë/Tekstet poetike 94./95. Shkëndija e diellit ndaj manushaqes 96. Mëma 97.Shkruesimë poezi 98/99.	138. Sintaksa- Fjalitë nënrenditëse filluese: kryefalore, kundrinore 139. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore: kohore, vendore 140. Teksti rrëfyes Erza, shqiptarja me famë botërore nga muzika drejt kinematografisë 141/142. Teksti rrëfyes- Gjirokastra 143/.144. Projekt/ tekst rrëfyes 145. Sintaksa -përpunim njohurish 146. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore: shkakore, qëllimore 147. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethanore: mënyrore, rjedhimore 148. Teksti informues- paraqitës/	Komunikues efektiv: I/1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. Mendimtarë kreativ: II/1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. Nxënësi i suksesshëm: III/1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. Kontribues produktiv: IV/1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. Individ i shëndoshë: V/1. 3. 5. 6. 7. 8. 9. Qytetarë i përgjegjshëm: VI/1. 2. 3. 4. 5. 6. 7. 8. 9.

Lëndët e fushës kurrikulare I	Plani vjetor Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi Shkalla:4 Klasa: VIII TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës
	Gjysmëvjetori i parë 83 orë		Gjysmëvjetori i dytë 102 orë		
	Shtator-Tetor 43 orë	Nëntor-Dhjetor 40 orë	Janar-Shkurt-Mars 54 orë	Prill-Maj-Qershor 48 orë	
	15. Fonetikë – Ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe 16. Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe 17. Fonetikë/Përpunim njohurish 18. Tekste realiste- Djaloshi i gurtë 19./20. Kujtimet 21. Një jetë e vështirë 22. Përpunim njohurish/Letërsi/bashkëbisedojmë 23. Ese 24. Qortimi i eseve 25. Drejtshkrimi - Përdorimi i drejtë i Pikës dhe i pikëçuditjes 26. Përdorimi i presjes në fjali 27./28. Tekste realiste -	53. Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve. Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve 54. Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën 55. Përpunim njohurish/Histori gjuhe/Fonetikë/Drejtshkrim/Leksikologji Fjalët me ngjyrim emocional 52. Gjuha standard dhe gjuha e letërsisë 53. Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve. Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve 54. Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën	Morfologji/ Folja/ Projekt 100. Teksti poetik Yjeve të pashuar 101. Shqiponja 102/103. Pasthirrma/Pjesëza 104.105. Teksti poetik Të dua baltë shqiptare 106. Teksti poetik Leni lumejt 107/108. Përpunim njohurish/ Morfologji 109.Ushtrime për test/ folja 110.Testim i njohurive / Morfologji 111. Qortimi dhe analiza e testeve 112. Teksti poetik Ora e gjimnastikës 113.Letërsi/Përforcim 114. Testimi i njohurive/ Letërsi	Kulti i disa gjallesave të natyrës 149. Zogjtë 150. Teksti informues-paraqitës/bashkëbisedojmë/shkrualjmë 151. Sintaksa Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethano: kushtore,lejore 152. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethano: krahasore 153. Fjalitë e përbëra me nënrenditje përcaktore 154. Projekt/ Sintaksa 155. Tekste udhëzuese/ Gjashhtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar 156. Shkrualjmë/ Tekst udhëzues 157. Shkrualjmë një plan për një projekt	

Lëndët e fushës I kurrikulare	Plani vjetor Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi Shkalla:4 Klasa: VIII TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
	Gjysmëvjetori i parë 83 orë		Gjysmëvjetori i dytë 102 orë			
	Shtator-Tetor 43 orë	Nëntor-Dhjetor 40 orë	Janar-Shkurt-Mars 54 orë	Prill-Maj-Qershor 48 orë		
	Kthimi i Skënderbeut në Krujë 29. Një medalje për madhësinë 30. Drejtshkrimi - përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave 31. Përdorimi i trepikëshit në fjali 32. Drejtshkrimi/ Përpunim njohurish 33. Drejtshkrimi/Ese 34.Drejtshkrimi/Qortimi dhe analiza drejtshkrimore e eseve 35. Teksti realist - Bora e fëminisë 36. Purpuranti 37. Teksti realist - Përpunim njohurish 38. Përpunim njohurish - drejtshkrimi	55. Përpunim njohurish/ Histori gjuhe/Fonetikë/ Drejtshkrim/Leksikologji 56. Testim i njohurive/ gramatikë 57. Tekste fantastike/ Përleshja e kryetimit me kryepiratin 58. Nëndhesja 59. Një mik i paharruar 60. Përpunim njohurish/ tekstet fantastike 61./62. Borfor-Provat e Askanos 63.64. Shkruajmë/ -tekst fantastik 65. Roboti që donte të flinte 66. Busulla e artë 67. Shkruajmë/ letërsi 68.69. Teksti Fantastik Projekt	115.Qortimi i testeve / analiz 116.Vlerësimi i njohurive 117.118. Ese/ Qortimi dhe analiza e eseve 119.120. Lektyrë 120. Sintaksa –Ndërtimi I fjalisë dhe analiza gramatikore e saj 121.Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali. 122.Ushtrime gjuhësore 122. Tekste dramatike/ Besëlidhja shqiptare 123. 124. I sëmuri për mend 125.126. Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden 127. Lektyrë	158./159. Teksti argumentues Përpërsitë dhe të metat e shpyllëzimit 160. A duhet të lejohen celularët në shkollë 161./162. Projekt 163. Ese 164. Qortimi dhe analiza e eseve 165./166. Tekste përshkruese/ Përshkruajmë në mënyra të ndryshme/ Bshkëbisedojmë/ 167. Teksti përshkrues - Vendi me më shumë libra sesa banorë 168. Përforcim/ Teksti joletrar 169.170. Përpunim njohurish për fushën e sintaksës		

Lëndët e Fushës L Kurrikulare	Plani vjetor Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi Shkalla:4 Klasa: VIII TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
	Gjysmëvjetori i parë 83 orë		Gjysmëvjetori i dytë 102 orë		
	Shtator-Tetor 43 orë	Nëntor-Dhjetor 40 orë	Janar-Shkurt-Mars 54 orë	Prill-Maj-Qershor 48 orë	
	37-38. Komandanti i klasës 39. Shuarja e humorit 40. Tekste letrare/ Përpunim njohurish 41. Testim i njohurive/ Tekstet realiste 42. Qortimi dhe analiza e testeve 43. Vlerësimi i njohurive	70. Ese/ Letërsi 71. Qortimi dhe analiza e eseve 72.73. Përpunim njohurish / Letërsi 74. Testim i njohurive nga letërsia/Tekstet fantastike 75. Qortimi i testeve 76. Vlerësim i njohurive 77. Morfologji/ Përmri pronor 78. Përpunim njohurish/ përmri pronor 79. Përmri vetvetor dhe përmri pyetës 80. Përmri i pacaktuar 81. Përpunim njohurish/ përmri 82. Përpunim njohurish/ letërsi 83. Vlerësimi i njohurive	128./129.Sintaksë/Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje/ Ushtrime 130./131. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre. / Ushtrime 132. Tekste rrëfyese Nanë e dashtun! 133. Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë 134. Përpunim njohurish/ Letërsi 135. Ese 136. Analizë 137. Analizë Vlerësim njohurish	171. Testim i njohurive nga sintaksa 172. Vlerësimi i testeve gjuhësore 173. Testim/Letërsi 174./175. Qortimi dhe vlerësimi i testeve 176/177. Projekt/ Vizita/mbrojta e planetit 178/179. Vizitë/TV 180./181. Vizië/ Biblioteka/ Kuvendi 182. Përforcim - Teksti argumentues/ teksti shpjegues 183. Përpunim i njohurive nga letërsia 184. Përpunim i njohurive nga gjuhësia 185. Përpunim njohurish/ Gjuhë & letërsi	

MODEL PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR (43 orë)

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi
(5 orë në javë)

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Klasa: VIII; Shkalla IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

-
- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
 - II. Mendimtar kreativ 1, 2, 4, 5, 7, 8.
 - III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
 - IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8.
 - V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
 - VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 3, 4, 5, 6, 7, 9.

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletërore. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të

publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletërore të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

- Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe jolettrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Teksti letrar	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja.	1. Njohja me nxënësit dhe planin mësimor	43 orë	1. Mësimdhënia dhe të nxënësve me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja	Vlerësim diagnostikues		Teksti shkollor
Rrëfime popullore	Identifikon elementet bazike të strukturës së tregimit.	2. Rrëfime popullore / Rrëfime nga e kaluara			Vlerësimi i të nxënësve	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	
Teksti letrar/ Tekste Realiste	-Zhvillimi historik i gjuhës shqipe dhe ndikimet.	3. Rrëfime nga e kaluara Bashkëbisedim			Vlerësimi i të shprehurit me gojë		Burime nga interneti
Njohuri për gjuhën/	-Dialektet në territoret ku flitet shqipja, dallimet mes tyre dhe shqipes standarde.	4. Histori gjuhe -Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar		2. Mësimdhënia dhe të nxënësve e bazuar në arritjen e kompetencave	Vlerësimi i Vazhdueshëm	Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	Teksti i nxënësit/ et; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ ja.
Histori gjuhe	-Identifikon elementet përbërëse të romanit.	5. Kush e solli Dhoqinën		3. Mësimdhënia dhe të nxënësve e integruar	Vlerësim për të nxënësve (formativ)		
Fonetikë	-Analizon strukturën e tregimit të shkurtër dhe të romanit dhe zhvillon atë varësisht prej prires.						
Drejtshkrimi	-Gjykon për bisedat me moshatarët dhe me të rritur, duke pyetur						
Leksikologjia							
Morfologji							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	dhe dhënë përgjigje për tema të ndryshme. -Njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare dhe greke. -Përshkruan dhe përcakton idetë dhe tiparet kryesore të teksteve letrare dhe joletrare. -Analizon aspektet gjuhësore të teksteve të vjetra shqipe dhe i krahason me gjuhën standarde. Shpjegon ndërrimet fonetike historike dhe ato aktuale (të gjalla) në gjuhë.	6. Mençuria e popullit 7. Mençuria e popullit/ (shkruajmë rrëfime tjera) 8. Ciklopi 9. Fabula - Gjeli i vogël, maçoku dhe kocomiu 10. Dokumentet e para të shkrimit shqip 11. Histori gjuhe/ përpnim njohurish 12. Urtësia e popullit		4. Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar 5. Çështjet ndërkurrikulare 6. Veprimtaritë/ aktivitetet jashtëkurrikulare	Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	-Identifikon veçoritë e lirikës. -Dallon dhe krahason gjinitë dhe llojet letrare. -Dallon dhe krahason motivet letrare. -Shkruan artikuj në revista për tema të ndryshme. -Rrëfen për ngjarje të ndryshme personale apo ndonjë ngjarje tjetër me gojë dhe me shkrim para një publiku të caktuar. -Përkruan dhe nxjerrë idetë dhe tiparet	13. Përpunim njohurish/ Rrëfime popullore 14. Lektyrë 15. Fonetikë – Ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe 16. Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe 17.Fonetikë/Përpunim njohurish 18.Tekste realiste-Djaloshi i gurtë			Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëtit (formativ)		

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	kryesore të teksteve letrare dhe joletrare. -Përdor forma efektive të shkrimit letrar dhe joletrar. -Interpreton strukturën e esesë: fillimin, trungun, fundin. -Përdor drejt rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit. -Krijon ese narrative, përshkruese dhe bindëse - argumentuese. -	19./20. Kujtimet 21. Një jetë e vështirë 22. Përpunim njohurish/Letërsi/ bashkëbisedojmë 23. Ese 24. Qortimi i eseve 25. Drejtshkrimi - Përdorimi i drejtë i Pikës dhe i pikëçuditjes 26. Përdorimi i presjes në fjali 27./28. Tekste realiste - Kthimi i Skënderbeut në Krujë 29. Një medalje për madhësinë					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	Hulumton dhe gjen të dhëna të ndryshme për të paraqitur ngjarje të rëndësishme historike dhe biografike.	30. Drejtshkrimi - përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave					
	-Përkthyer dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	31. Përdorimi i trepikëshit në fjali 32. Drejtshkrimi/ Përpunim njohurish 33. Drejtshkrimi/Ese 34. Drejtshkrimi/ Qortimi dhe analiza drejtshkrimore e eseve					
		35. Teksti realist - Bora e fëminisë 36.Purpuranti					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
		37-38. Komandanti i klasës 39. Shuarja e humorit 40. Tekste letrare/ Përpunim njohurish 41. Testim i njohurive/ Tekstet realiste 42. Qortimi dhe analiza e testeve 43. Vlerësimi i njohurive					

MODEL PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR (40 orë)

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi
Letërsi (5 orë në javë)
Klasa: VIII; Shkalla IV

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 4, 5, 7, 8.
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8.
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 3, 4, 5, 6, 7, 9

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

• Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

• Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

• Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Teksti letrar	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja.	44-45. Teksti realist / Lektyrë (roman lexuar nga nxënësit/et)	40 orë	1. Mësimdhënia dhe të nxënësve me nxënësin/en në qendër dhe gjithëpërfshirja	Vlerësim diagnostikues		Teksti shkollor
Tekste Realiste	Identifikon elementet bazike të strukturës së tregimit.	46. Teksti realist / bashkëbisedojmë / shkruajmë			Vlerësimi i të nxënësve	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	
Teksti fantastik	-Identifikon elementet përbërëse të romanit. -Analizon strukturën e tregimit të shkurtër dhe të romanit dhe zhvillon atë varësisht prej prires.	47. Leksikologji /Fjalët me ngjyrim emocional 48. Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve 49. Tekste fantastike/Liliputët			Vlerësim i të shprehurit me gojë		Burime nga interneti
Njohuri për gjuhën/	-Gjykon për bisedat me moshatarët dhe me të rritur, duke pyetur dhe dhënë përgjigje për temën ndryshe.	50. Ujqërit e kuq-lexojmë shkruajmë – bashkëbisedojmë		2. Mësimdhënia dhe të nxënësve bazuar në arritjen e kompetencave	Vlerësim i Vazhdueshëm	Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	Teksti i nxënësit/et; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Leksikologji		51. Leksikologji/Sinonimet, antonimet, homonimet					
Drejtshtkrimi	-Analizon aspektet gjuhësore të teksteve të vjetra shqipe dhe i krahason me gjuhën standarde.	Fjalët me ngjyrim emocional 52. Gjuha standard dhe gjuha e letërsisë 53. Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të		3. Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar	Vlerësim për të nxënësve (formativ)		
Morfologji							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	figurshme të fjalëve. Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve 54. Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën 55. Përpunim njohurish/ Histori gjuhe/Fonetikë/ Drejtshkrim/Leksikologji 56. Testim i njohurive/ gramatikë 57. Tekste fantastike/ Përleshja e kryetrimet me kryepiratin 58. Nëndhesja 59. Një mik i paharruar 60. Përpunim njohurish/ tekstet fantastike 61./62. Borfor-Provat e Askanos 63-64. Shkruidmë/ -tekst fantastik 65. Roboti që donte të flinte	figurshme të fjalëve. Mënyrat e fjalëformimit të fjalëve 54. Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën 55. Përpunim njohurish/ Histori gjuhe/Fonetikë/ Drejtshkrim/Leksikologji 56. Testim i njohurive/ gramatikë 57. Tekste fantastike/ Përleshja e kryetrimet me kryepiratin 58. Nëndhesja 59. Një mik i paharruar 60. Përpunim njohurish/ tekstet fantastike 61./62. Borfor-Provat e Askanos 63-64. Shkruidmë/ -tekst fantastik 65. Roboti që donte të flinte		4. Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar 5. Çështjet ndërkurrikulare 6. Veprimtaritë/ aktivitetet jashtëkurrikulare	Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
	-Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	66. Busulla e artë 67. Shkruijme/ letërsi 68-69. Teksti Fantastik Projekt 70. Ese/ Letërsi 71. Qortimi dhe analiza e eseve 72.73. Përpunim njohurish / Letërsi 74. Testim i njohurive nga letërsia/Tekstet fantastike 75. Qortimi i testeve 76. Vlerësim i njohurive 77. Morfologji/ Përmri pronor 78. Përpunim njohurish/ përmri pronor 79. Përmri vetvetot dhe përmri pyetës 80. Përmri i pacaktuar 81. Përpunim njohurish/ përmri 82. Përpunim njohurish/ letërsi 83. Vlerësimi i njohurive			Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit (formativ)		
	Dallon përmrat pronorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar, në fjalitë e dhëna në libër. Zëvendëson në fjali përmrat që mungojnë.						

MODEL PLANI DYMUJOR: JANAR-SHKURT-MARS (54 orë)

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi
(5 orë në javë)
Klasa: VIII; Shkalla IV

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 4, 5, 7, 8.
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8.
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 3, 4, 5, 6, 7, 9.

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

• Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

• Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV.NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

• Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Teksti letrar	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	84. Tekste poetike Nana me buzë në gaz 85. In memoriam (Gjyshes) 86/87. Folja (rishikim njohurish) Folja në mënyrat kushtore dhe habitore 88. Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore 89./90. Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore 91. Teksti poetik - Vruull 92. Ora e Shalës 93. Analizë/Tekstet poetike 94./95. Shkëndija e diellit ndaj manushaqes 96. Mëma	54 orë	1. Mësimdhënia dhe të nxënësve me nxënësin në qendër dhe gjithpërfshirja	Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënësve Vlerësimi i të shprehurit me gojë	 Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	Tekstet i shkollor Burime nga interneti
Tekste poetike	Dallon foljet në mënyrat dëshirore, urdhërore, dëftore, habitore, lidhore, kushtore; jep përkufizimin për kuptimin që shprehin foljet. Dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra; (foljet ndihmëse kam, jam) Kupton zgjedhimin vepror dhe jovepror.			2. Mësimdhënia dhe të nxënësve e bazuar në arritjen e kompetencave	Vlerësimi Vazhdueshëm Vlerësim për të nxënësve (formativ)		Teksti i nxënësve; materialet nga interneti; materialet shpesh të përgatitura nga mësuesit/ja.
Morfologji							

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Morfologji	-Gjykon për bisedat me moshatarët dhe me të rritur, duke pyetur dhe dhënë përgjigje për temë të ndryshme. Kupton pjesët e ligjëratës, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. Mëson pasthirmat, pjesëzat.	97.Shkruajmë poezi 98/99. Morfologji/ Folja/ Projekt 100. Teksti poetik Yjeve të pashuar 101. Shqiponja 102/103. Pasthirmat/Pjesëza 104.105. Teksti poetik Të dua baltë shqiptare		3. Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar 4. Mësimdhënia dhe të nxënësve diferencuar 5. Çështjet ndërkurrikulare	Vlerësim i punëve shkruar Vlerësim për të nxënësve (formativ)	Edukatare qytetare, i Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	
	-Rrëfen për ngjarje të ndryshme personale apo ndonjë ngjarje tjetër me gojë dhe me shkrim para një publiku të caktuar. -Përdor drejt rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit.	106. Teksti poetik Leni lumëjt 107/108. Përpunim njohurish/ Morfologji 109. Ushtrime për test/ folja 110. Testim i njohurive / Morfologji 111. Qortimi dhe analiza e testeve		6. Veprimtaritë/ aktivitetet jashtëkurrikulare	Vlerësim diagnostikues		

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Tekste dramatike	Nxënësi/ja njih dhe interpreton tekstin dramatik.	112. Teksti poetik Ora e gjimnastikës 113. Letërsi/Përforsim 114. Testimi i njohurive/Letërsi 115. Qortimi i testeve / analiz 116. Vlerësimi i njohurive 117. 118. Ese/Qortimi dhe analiza e eseve 119. 120. Lektyrë 120. Sintaksa – Ndërtimi i fjalës dhe analiza gramatikore e saj 121. Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali. 122. Ushtrime gjuhësore 122. Tekste dramatike/ Besëlidhja shqiptare 123. 124. I sëmuri për mend			Vlerësim për të nxënës (formativ) V l e r ë s i m diagnostikues Vlerësim për të nxënës (formativ)		
	-Përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.						
	Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje.						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Sintaksa	Kupton funksionin e tyre.	125.126. Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden 127. Lektyrë 128.129. Sintaksë/Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje/ Ushtrime 130./131. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre./Ushtrime 132. Tekste rrëfyese Nanë e dashtrun! 133. Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë 134. Përpunim njohurish/Letërsi 135. Ese 136. Analizë 137. Analizë Vlerësim njohurish					
Tekste rrëfyese	Përkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit rrëfyës duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.						

MODEL PLANI DYMUJOR: PRILL-MAJ-QERSHOR (48 orë)

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi
(5 orë në javë)
Klasa: VIII; Shkalla IV

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

-
- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
 - II. Mendimtar kreativ 1, 2, 4, 5, 7, 8.
 - III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
 - IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8.
 - V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9
 - VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 3, 4, 5, 6, 7, 9.

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe jolettrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe jolettrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

• Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

• Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV.NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

• Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Teksti informues paraqitës	Rrëfen për ngjarje të ndryshme personale apo ndonjë ngjarje tjetër me gojë dhe me shkrim para një publiku të caktuar.	Kulti i disa gjallesave të natyrës 149. Zogjtë 150. Teksti informues-paraqitës/bashkëbisedojmë/shkruajmë 151. Sintaksa Fjalitë e përbëra me nënrenditje		3. Mësimdhënia dhe të nxënësve integruar	Vlerësim i punëve me shkrim	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	
Sintaksa	Dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore, kushtore, lejore Tregon me se shprehen, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjalia drejtuese. E përdor atë drejt në fjali.	152. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore: krahasore 153. Fjalitë e përbëra me nënrenditje përcaktore 154. Projekt/ Sintaksa 155. Tekste udhëzuese/ Gjashhtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar 156. Shkruajmë/Tekst udhëzues 157. Shkruajmë një plan për një projekt 158./159. Teksti argumentues		4. Mësimdhënia dhe të nxënësve diferencuar 5. Çështjet ndërkurrikulare	Vlerësim për të nxënësve (formativ)	S h k e n c a t s h o q ë r o r e ; shoqëria mjedisi	
Tekste udhëzuese	Përkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.			6. Veprimtaritë/aktivitetet jashtëkurrikulare	Vlerësim diagnostikues		

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Tekste përshkruese	-Përdor drejt rregullat e drejtshkrimit dhe shenjat e pikësimit.	Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit 160. A duhet të lejohen celularët në shkollë 161-162. Projekt 163. Ese 164. Qortimi dhe analiza e eseve 165./166. Tekste përshkruese/ Përshkruajmë në mënyra të ndryshme/ Bshkëbisedojmë/ 167. Teksti përshkruet - Vendi me më shumë libra sesa banorë 168. Përforsim/ Teksti joletrar 169-170. Përpunim njohurish për fushën e sintaksës 171. Testim i njohurive nga sintaksa 172. Vlerësimi i testeve gjuhësore			Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit (formativ)		
	-Përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet mjetet dhe materialet
Teksti argumentues	Përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	173. Testim/Letërsi 174/.175. Qortimi dhe vlerësimi i testeve 176/177. Projekt/ Vizita/mbrojta e planetit 178/179. Vizitë/TV 180/.181. Vizië/ Biblioteka/ Kuvendi 182. Përforcim - Teksti argumentues/ teksti shpjegues 183. Përpunim i njohurive nga letërsia 184. Përpunim i njohurive nga gjuhësia 185. Përpunim njohurish/ Gjuhë & letërsi					

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Rrëfime popullore		Rezultatet e të nxënit të temës: - njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare dhe greke; - dallon (krahason) elemente të letërsisë gojore nga ajo e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Rrëfime nga e kaluara			
Fjalët kyçe: miti, përralla, legjenda, fabula, forma të ndryshme, të hershme, krijim popullor.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon veçoritë e folklorit duke u bazuar në pjesët e mësuara; - interpreton me role krijimet e vjetra popullore; - gjykon për vlerat e krijimeve popullore. Kriteret e suksesit: Rikujton krijimet e vjetra popullore duke konkretizuar secilin prej tyre. Komenton për krijimet e vjetra popullore. Analizon pjesët e zgjedhura në fragmente.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh


Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Krijimet e vjetra popullore” dhe udhëzon nxënësit të tregojnë njohuritë e tyre për krijimet e hershme popullore. Nxënësit tregojnë njohuritë e veta dhe mësuesi/ja shkruan në tabelë mendimet e tyre. Pastaj shpjegon pjesën para mësimit, për krijimet e vjetra popullore dhe për pjesët që do të mësojnë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diamanti 4

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit të lexojnë dhe të mbushin kolonat me kuptimin e secilës pjesë që lexojnë. Udhëzohen të ndalen edhe te fjalori për fjalët kyçe. Për shembull:

Sfinksi - qenie imagjinare në mitologjinë greke, me krahë shpendi, me kokë gruaje, me trup luani ose qeni dhe me bisht gjarpri, që u jepte kalimtarëve gjëgjëza të vështira për t'i zgjidhur. Kur këta nuk i zgjidhnin dot, sfinksi i gëlltiste.

me vërtik – me vrull, me shpejtësi; vorbull – shtjellë, dredhë, që të mbështjell rreth e qark; rizë – peshqir, shami; kujë – klithmë e fortë, të qash me zë të lartë; eshkë – material i thatë dhe shumë i rrudhur, që përdoret për të ndezur zjarrin; briti – thirri, bërtiti; proftasën – (nga greq.) arritën.



Pas përfundimit të detyrës, secili grup prezanton punimet e tij me anë të një nxënësi përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje - Diagrami i Venit

Më tej, nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyrat: 1, 2, 3, 4, 5, 6.



Grupi i dytë: Analizojmë tekstin – detyrat: 7, 8, 9, 10.

Grupi i tretë: Interpretojmë tekstin – detyrat: 11, 12.

Grupi i katërt: Interpretojmë tekstin – detyrat: 11, 12 dhe Gjuha e tekstit – detyrat 13, 14, 15, 16.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojnë rreth tekstit detyrat 17 dhe 18.

Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për ndërtimin e diagramit të Venit.

Sfinksi Dhelpra me bark të... Të përbashkëtat  Të veçantat Të veçantat	Pulka dhe gjelka Legjenda e Syrit të... Të përbashkëtat  Të veçantat Të veçantat
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur Detyrë: Gjeni në internet informacione për pellazgët. Me ndihmën e mësuesit/es, diskutoni rreth prejardhjes së ilirëve dhe gjuhës shqipe. Syri i Kaltër është shpallur monument natyre. Pse? Përshkruani bukurinë e tij. Me ndihmën e prindërve, gjeni ndonjë legjendë tjetër që rrëfen për Syrin e Kaltër. Krahasoni me legjendën e dhënë në libër.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Histori gjuhe		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njihet me historikun e shkurtër të gjuhës shqipe të shkruar (gjuha si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor, dokumentimi i shkrimit të gjuhës shqipe).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË**IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE****Njësia mësimore:** Historik i shkurtër i gjuhës shqipe të shkruar**Fjalët kyçe:** historik, gjuhë, shkrim, komunikim gojor dhe shkrimor, dokumentim.**Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- kupton historikun e shkurtër të gjuhës shqipe si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor;
- dallon gjuhën si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor;
- mëson rreth dokumentimit të shkrimit të gjuhës shqipe.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Histori, Gjeografi, Artet, Letërsi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**Hapi I. Situata e të nxënit-****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Diskutim për njohuritë paraprake. Mësimdhënësi/ja e nis mësimin me diskutimin mbi mënyrën e të shprehurit me anë të komunikimit verbal dhe të atij joverbal. Nxënësit shprehin mendimet e tyre për historikun e gjuhës shqipe.

Hapi II. Lidhja e temës me njohuritë e nxënësve- INSERT- Prezantim i punës hulumtuese

Një nxënës/e lexon informacionin në libër, pastaj udhëzohen të gjithë për punën hulumtuese, si: **INSERT-i** është një metodë, me anë të së cilës nxënësit kontrollojnë sa të thella i kanë njohuritë e fituara. Ata lexojnë materialin dhe gjatë leximit vendosin shenja, që kanë një domethënie të caktuar për informacionin që lexojnë. Shenja “√” vendoset në atë rast kur lexuesi ndesh një informacion të njohur nga ana e tij. Shenja “+” vendoset kur informacioni është i ri, “-“ kur informacioni e kundërshton ose është i ndryshëm nga ai që di, “?” kur ndeshet me një informacion të paqartë.

Në fund, nxënësit i përmbledhin të dhënat në tabelën e mëposhtme:

√	+	-	?
Për shembull: Gjuha është mjeti themelor i komunikimit për shoqërinë njerëzore. Ajo mund të përdoret në formën e saj të folur dhe të shkruar. Forma shkrimore e gjuhëve u parapri nga vizatime që njeriu primitiv bënte në shpella dhe në gurë.	Për shembull: Dokumentimi i shkrimit të gjuhës shqipe është relativisht i vonë, ndonëse shqipja është një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Deri më sot, mund të flasim për dëshmi shkrimore të shqipes, që datojnë jo më herët se shekulli XIV.	P.sh.: Në të mirë të kësaj teze flet dëshmia e një kleriku frëng, Guljelmus Ade. “Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin në përdorim dhe në tërë librat e tyre”.	P.sh.: Pse ende nuk kemi dëshmi për dokumente më të vjetra të gjuhës shqipe?

Prezantim i punës hulumtuese: Mësimdhënësi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve të njohuritë e prezantuar në tekst. Nxënësit lexojnë materialin në tekst dhe vendosin shenjat përkatëse. Pas prezantimit, nxënësit duke identifikuar faktet e nxjerra nga teksti, si dhe nga hulumtimet e tyre, vlerësojnë rëndësinë e këtyre dëshmive.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit- Shkrim i lirë

Nxënësit bëjnë përmbledhje për historikun e shkurtër të shqipes së shkruar, gjuha si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor, dhe për dokumentimin e shkrimit të gjuhës shqipe. Pastaj individualisht, nxënësit punojnë ushtrimet dhe hapet diskutimi me të gjithë nxënësit e klasës, diskutohet për secilin ushtrim:

1. E vërtetë apo e gabuar?
 - Nuk mund të ketë gjuhë të folur pa formën e shkruar të saj.
 - Shkrimi ka lindur njëkohësisht me gjuhën.
 - Dëshmitë e para shkrimore të shqipes i gjejmë në shekullin X.
 - Ka dëshmi që shqipja të jetë shkruar para shekullit XIV.
2. Në ç'periudhë datojnë dëshmitë e para shkrimore të gjuhës shqipe?
3. Cilës sferë i përketin dokumentet e para të shkrimit shqip dhe pse?

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi diagnostifikues i nxënësve, vlerësimi i nxënësve aktivë, vlerësimi i ndërsjellë, vlerësimi i vazhdueshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 50

Hartoni një tekst me temë: “Ndikimi i shkrimit në zhvillimin e shoqërisë njerëzore”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja veçon nxënësit e dalluar duke dhënë motiv për nxënësit pasivë me vlerësimin që u bën në të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Rrëfime popullore		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare dhe greke; - dallon (krahason) elemente të letërsisë gojore nga ajo e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Kush e solli Doruntinën?

Fjalët kyçe: Pashkë, gjëma, rrasa, gjerëqinë, kallogre.

Rezultatet e të nxënës për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- përshkruan ngjarjen në tekst;
- dallon njeriun me vlera në shoqëri;
- zbulon mesazhin që sjell ky tekst te ne.

Kriteret e suksesit:

Rikujton krijimet e vjetra shqiptare.

Komenton përmbajtjen e besës si traditë e shqiptarëve.

Zbulon elementin fantastik në tekst.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fletë të bardha, shënjes, tabela.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Kllaster

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Kush e solli Doruntinën?” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë në kllaster mendimet e tyre për njësinë e re.

Pastaj, mësuesi/ja shkruan në tabelë kllasterin dhe të gjithë nxënësit shprehin mendimet e tyre. P.sh.:



‘Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan fjalët kyçe në tabelë:

Pashkë – festë e të krishterëve që kremton

ringjalljen e Krishtit.

okë – masë peshe, afërsisht 1,5 kg.

avlli – mur rrethues i oborrit të shtëpisë.

shpiket – këtu: shfaqet.

stëhi – qenie mitologjike (përfytyrohet si

gjarpër që u bën të këqija njerëzve).

zhurit – përvëloj, djeg.

gjëma – lajm i keq, mandatë.

rrasa – guri i varrit.

gjeraqinë – një lloj skifteri. Populli e

përdor si krahasim për gratë e bukura, të

shkathëta e të veshura mirë.

kallogre – grua e mjerë, e veshur me të zeza.

Pastaj shpjegon se ç’janë baladat. Në balada gjejmë rrëfimin e autorit dhe shprehjen e ndjenjave të tij për ngjarje që tregojnë një veprim që kërkon trimëri të veçantë. Ato tregojnë edhe botën emocionale të personazhit. Karakteristikë e baladave janë elementet fantastike. Ndër më të njohurat janë: “Balada e murimit”, “Balada e Ymer Agës” etj.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rikujtojnë krijimet e vjetra shqiptare dhe të ndalen te balada, duke qenë se njësia mësimore është baladë. Mësuesi/ja tregon që pjesa që do mësojnë është baladë dhe u shpjegon nxënësve pjesën para leximit.

“Kush e solli Doruntinën?” është një baladë shumë e vjetër, qindravjeçare. Përmes saj, populli shpreh një nga cilësitë e tij më të vyera, mbajtjen e fjalës së dhënë përmes kapërcimit të çdo pengese e çdo vështirësie që mund të dalë rrugës. Ndryshe ajo quhet edhe “Balada e Besës”.

Pastaj, nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit punojnë të ndarë në tri grupe me numër të njëjtë nxënësish.

Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para klasës. Një nxënës/e prezanton grupin (p.sh.: nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta, sepse të gjithë e kanë lexuar dhe ndalen më shumë te fjalët “besa” dhe “mallkimi”, që janë pjesë e legjendës së njohur.

Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh.: ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të nxitë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive e negative, duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre.

Pas prezantimit dhe debateve, udhëzohen grupet e njëjta të punojnë ushtrimet që cakton mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyra 1. Përgjigjuni pyetjeve/Analizojmë tekstin – detyrat: 2, 3, 4.

Grupi i dytë: Interpretojmë tekstin – detyrat: 5, 6, 7.

Grupi i tretë: Gjuha e tekstit – detyra 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj të gjithë punojnë në rubrikën “Reflektojmë rreth tekstit”, detyrat 9, 10. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh	
<u>Doruntina</u> e dëshpëruar e bukur dashuronte vajtonte vallëzonte u martua larg familjes Besa	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar,shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 7
Kthejeni baladën në prozë duke ruajtur karakteristikat e saj. Gjeni materiale për besën dhe diskutoni rreth tyre. Ndaluni të lidhja mes besës dhe ringjalljes.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Rrëfime popullore		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare dhe greke; - dallon (krahason) elemente të letërsisë gojore nga ajo e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			

I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Mençuria e popullit

Fjalët kyçe: gjyshi,mbesa bareshë, njeriu i çuditshëm.

Rezultatet e të nxënës për orën mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan ngjarjen në tekst;
- dallon njeriun me vlera në shoqëri;
- zbulon mesazhin që përcjell ky tekst te ne.

Kriteret e suksesit:

Rikujton krijimet e vjetra shqiptare.

Komenton përmbajtjen e frazeologjive në tekst.

Zbërthen dhe kupton përmbajtjen e frazeologjive në tekst.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjes, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori,Gjeografi


Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Kllaster

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Mençuria e popullit” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë në kllaster mendimet e tyre për njësinë e re.

Pastaj, mësuesi/ja shkruan në tabelë kllasterin dhe të gjithë nxënësit shprehin mendimet e tyre.

Për shembull:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan fjalët kyçe në tabelë:

Vatha - vend i rrethuar me gardh, zakonisht i pambuluar, ku mbahet apo ku rri bagëtia.

Kureshtje - dëshirë e madhe për të parë, për të dëgjuar ose për të mësuar diçka të panjohur.

Kanalizoj - hap një rrjet kanalesh ujitëse, kulluese, që të mos shkaktohen përmbytje.
Velenxë - mbulesë e trashë prej leshi.
Gjakësor - njeri i etur për gjak, vrasës e gjakpirës.

Pastaj shpjegon se rrëfimi i radhës është kallëzim popullor. Nxënësve u kërkohet të shpjegojnë se çfarë nënkuptojnë kur autori i një rrëfimi apo ngjarjeje është i panjohur.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Ndërtimi i njohurive të reja

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të rikujtojnë krijimet e vjetra shqiptare dhe të ndalen te legjenda, duke qenë se njësia mësimore është legjendë. Mësuesi/ja tregon se pjesa që do të mësojnë është legjendë dhe sqaron pjesën para leximit.

“Legjenda e Rozafatit është një legjendë e përcjellë ndër shqiptarë brez pas brezi. Siç bën edhe në shumë përralla, rrëfenja e tregime popullore, Kuteli na ritregon në një formë të re legjendën e Rozafatit. Kjo rrëfenjë është pjesë e përmbledhjes “Tregime të moçme shqiptare”.

Më pas, nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit ndahen në tri grupe dhe punojnë detyrat e caktuara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Diskutues- Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para shokëve të klasës. Një nxënës/e prezanton grupin. (Nxënësit e tregojnë pjesën në pika të shkurta, sepse të gjithë e kanë lexuar dhe ndalen më shumë te deshifrimi i fjalëve/frazeologjive të njeriut të çuditshëm.)

Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh.: ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të nxitë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të shprehin mendime pozitive e negative, duke përdorur komentet e veta për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre. Nxënësit analizojnë fjalët e njeriut të mençur, qëndrimin e gjyshit karshi njeriut të mençur dhe zgjuarsinë e mbesës bareshtë të plakut. Pas prezantimit dhe debateve, grupet udhëzohen të punojnë ushtrimet e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyra 1. Përgjigjuni pyetjeve: a, b, c, d, e, f.

Grupi i dytë: Analizojmë tekstin – detyrat: 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë: Interpretuojmë tekstin / Gjuha e tekstit / Reflektojmë rreth tekstit – detyrat: 6, 7, 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Njerëzit
 Të ditur, të dashur
 Punojnë, ndërtojnë, mësojnë
 Janë gjithnjë vigjilentë.
 Populli

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni rrëfime të tjera popullore, të cilat përfundojnë me mesazhe në fund të tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Histori gjuhe		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njihet me dokumentet e para të shkrimit shqip, me Formulën e Pagëzimit, me Fjalorin e Arnold fon Harfit, me Ungjillin e Pashkëve dhe me shkrimet e librat e mëvonshëm.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dokumentet e para të shkrimit shqip			
Fjalët kyçe: komunikim, alfabet, dokumentet, formulë, pagëzim, fjalor. ungjill, Pashkë.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: ➤ dallon dokumentet e para të gjuhës së shkruar; ➤ përcakton llojin e gjuhës së përdorur në situata të ndryshme komunikimi; ➤ identifikon lehtësisht situatat në të cilat duhet të përdoret gjuha e shkruar; ➤ analizon dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar; ➤ argumenton përparësitë dhe mangësitë e rrëfimit me gojë dhe me të shkruar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori, Gjeografi, Artet, Letërsi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Di, Dua të di, Mësova</i> Diskutim për njohuritë paraprake. Mësimdhënësi/ja e nis mësimin me diskutimin mbi mënyrën e të shprehurit me anë të komunikimit verbal dhe atij joverbal. Nxënësit shprehin mendimet e tyre për dokumentet e para të shkrimit shqip.			
			
Çfarë ju sjellin ndër mend fjalët: piktogram, papirus, pergamenë, alfabet? Shikoni figurat dhe diskutoni. Nxënësit do të udhëzohen të punojnë me metodën <i>Di, Dua të di, Mësova</i> (DDM)			

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.		
Te gjuha e folur, dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njëri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar, dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.		
Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.		
Te gjuha e folur përdoren gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.		

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM, Të nxënit në bashkëpunim – Punë në dyshe

Udhëzohen nxënësit që të bëjnë pyetje rreth njohurive që duan të dinë për dallimin midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.	Cilat janë dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar?	
Te gjuha e folur, dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njëri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar, dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.	A përdorin ato shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi?	
Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.	A ka fusha të ndryshme veprimi gjuha e folur në dallim me gjuhën e shkruar?	
Te gjuha e folur përdoren gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.	A përdoren në situata të ndryshme komunikimi?	

Të nxënit në bashkëpunim – Punë në dyshe


Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në dyshe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura prej tyre. U lihen nxënësve 7 minuta në dispozicion dhe më pas ngrihen për të plotësuar tabelën DDM, rubrikën *Mësova*.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë dy mënyra që përdoren për të komunikuar.	Cilat janë dallimet midis gjuhës së folur dhe asaj të shkruar?	<i>Dallimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar janë këto:</i> 1) Përdorin shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi. 2) Kanë fusha të ndryshme veprimi. 3) Kanë dallime në nivelin shprehës. 4) Përdorin shenja të ndryshme.
Te gjuha e folur, dhënësi dhe marrësi janë njëkohësisht pranë njëri-tjetrit, ndërsa te gjuha e shkruar, dhënësi dhe marrësi kanë distancë mes tyre.	A përdorin ato shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi?	Po, përdorin shenja dhe kanale të ndryshme komunikimi. Gjuha e folur përdor shenja verbale të zëshme dhe në të përdoret kanali dëgjimor, ndërsa gjuha e shkruar përdor shenja verbale pamore dhe si mbështetje përdor kanalin e të parit. Jepen dallime të tjera.
Te gjuha e folur përdoret toni i zërit: ngritja, ulja, ashpërsimi, zbutja, ndërsa te gjuha e shkruar përdoren shenjat e pikësimit.	A ka fusha të ndryshme veprimi gjuha e folur në dallim me gjuhën e shkruar?	Gjuha e folur përdoret në të gjitha raportet komunikuese dhe në të gjitha mjediset: familje, shkollë, institucione, rrugë etj. Ajo shpreh të gjitha nevojat jetësore dhe emocionale, ndërsa gjuha e shkruar përmban mesazhe të ndryshme instruksione, rregulla, ligje, ndjenja etj.
Te gjuha e folur përdoren gjuha standarde dhe dialektet, ndërsa te gjuha e shkruar përdoret vetëm gjuha standarde.	A përdoren në situata të ndryshme komunikimi?	Te gjuha e folur, dhënësi e korrigjon apo e përmirëson deklaratën e tij në kohë reale, ndërsa gjatë përdorimit të gjuhës së shkruar, dhënësi thotë gjithçka që mendon për çështjen. As nuk heq, as nuk shton gjë.

Këto pyetje të përdorura janë vetëm sugjeruese, pasi nxënësit mund të bëjnë pyetje rreth asaj që duan të mësojnë për temën në fjalë.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pema e mendimit

Një nxënës/e lexon informacionin në libër, pastaj udhëzohen të gjithë nxënësit për punën hulumtuese që do të bëjnë. Nxënësit do t'i paraqesin njohuritë e tyre paraprake dhe njohuritë e fituara në pemën e mendimit, si: mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë grupin emëror *Gjuha shqipe* duke e plotësuar me përgjigjet e nxënësve, të cilët i shoqërojnë përgjigjet edhe me materialet që kanë hulumtuar.



Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe ushtrimet e dhëna në tekst. Ushtrimi 1, faqe 193. E vërtetë apo e gabuar? Ushtrimi 2. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme. Ushtrimi 3. Shkruani një tekst të shkurtër me temë: “Rëndësia e dokumentimit me shkrim të një gjuhe”.	
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësimi i nxënësve do të jetë në vijimësi të vlerësimeve të motivuara gjatë orës së mëparshme. Nisur nga shkalla e arritjeve të rezultateve të të nxënësit, nxënësit do të vlerësohen me notë.	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR	Shiko Fletore pune, f. 51
Shkruani një tekst më të zgjeruar me temë: “Rëndësia e dokumentimit me shkrim të një gjuhe”.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin e të shkruarit, të folurit dhe të shprehurit të nxënësve.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Rrëfime popullore		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare e greke; - dallon (krahason) elemente të letërsisë gojore nga ajo e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Ciklopi			
Fjalët kyçe: Odiseja, Ciklopi, Askushi, Zeusi, Troja.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u mbështetur në ilustrimin figurativ në tekst, titullin e tekstit dhe fjalët që shkruan mësuesi/ja në dërrasën e zezë; – analizon ngjarjen në tekst; – vlerëson/reflekton mbi raportin e forcës fizike me forcën mendore (Më mirë i zgjuar, se i fortë).			

Kriteret e suksesit:

Përshkruan zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi figurativ në tekst, titulli i tekstit dhe fjalët që shkruan mësuesi/ja në dërrasën e zezë.

Arsyeton ngjarjen në tekst.

Kupton dhe bën analizën e portretit fizik e të karakterit të personazheve (Odisesë dhe Ciklopi).

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital/ Imagjinata e drejtuar**

Mësuesi/ja mund të përgatitë më parë një prezantim digjital të shkëputur nga filmi për Odisenë. Mund të zgjedhë sekuenca të pjesës kur Odiseja me shokë mashtrojnë Ciklopin dhe çlirohen nga ai. (Kuptohet, nëse është e mundur dhe ka mundësitë teknike.)

Por, nëse në shkollë mungojnë pajisjet teknike, mund të shkruajë në dërrasën e zezë fjalët:

Ciklopi, Odiseja, Troja. Pastaj kërkon nga nxënësit që të hapin tekstin te njësia “Ciklopi”, të shikojnë ilustrimin artistik dhe të imagjinojnë / thurin një ngjarje.

Nxënësit do të krijojnë ngjarjet e tyre duke punuar në dyshe me shokun/shoqen e bankës, të cilat pastaj mund t'i paraqesin para klasës.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim artistik/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Para se të fillojë leximi, mësuesi/ja duke u mbështetur te rubrika para leximit, u shpjegon nxënësve se pjesa që do të lexojnë është përshtatje në prozë e veprës “Ciklopi” të Euripidit, dhe përshkruan rrjedhën e ngjarjes që zhvillohet në rrëfim.

Leximi i pjesës mund të bëhet i ndarë sipas personazheve të saj (mësuesi/ja mund të bëjë më parë përgatitjet për ndarjen e pjesës në personazhe). Pasi lexohet teksti, së bashku me mësuesin/en, nxënësit zbërthejnë fjalët e panjohura dhe marrin njohuri për jetën dhe veprat e *Euripidit si njëri ndër përfaqësuesit më të mëdhenj të tragjedisë të antikitetit grek, së bashku me Sofokliun dhe Eskilin.*

Para se të fillojë puna me studimin e tekstit, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se si bëhet analiza e një personazhi.

Analiza e një personazhi

Analiza e portretit fizik synon aftësimin e lexuesit për ta imagjinuar atë, p.sh.: ngjyra e lëkurës, sytë, goja dhe buzët, trupi, flokët, mustaqet, mjekra, rrobat, këpucët (materiali, stili dhe ndonjë shenjë dalluese).

Analiza e karakterit përfshin cilësitë morale, mendore, shpirtërore etj. Ndër këto cilësi radhiten: ndershmëria, dinjiteti, mendjemprenhtësia, mençuria, përpikëria, toleranca, mirësia, guximi, mirënjohja, mikpritja etj.

Fillon puna me studimin e tekstit. Në klasë formohen 4 grupe nxënësish dhe punojnë detyrat:

Grupi I - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1: a, b, c, d, e.

Grupi II - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2, 3, 4, 5.

Grupi III - Interpretuojmë tekstin, ushtrimet 6, 7.

Grupi IV - Gjuha e tekstit, ushtrimet 8, 9.

Nxënësit pasi të kenë përfunduar detyrat, paraqesin para klasës përgjigjet, mendimet dhe sugjerimet e tyre. Ata mund të bashkëpunojnë dhe të japin mendimin e tyre për përgjigjet e shokëve/shoqeve. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në dyshe të reflektojnë rreth tekstit, duke dhënë përgjigje të argumentuara për pyetjen 10. *Duke u nisur nga historia e Odisesë me Ciklopin, reflektoni mbi raportin e forcës fizike me forcën mendore. Më mirë i fortë, apo i zgjuar?*

Po

Jo

Pse?


Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore:
Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 8

Lidhni me shigjetë veçoritë dalluese në portretizimin e dy personazheve. Bëni analizën e portretit fizik dhe të karakterit të secilit prej tyre.



Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Rrëfime popullore		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh (liston) dhe analizon disa elemente mitologjike shqiptare dhe greke; - dallon (krahason) elemente të letërsisë gojore nga ajo e shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Urtësia e popullit			
Fjalët kyçe: miqësi, kusi, i marrë, koprraci.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – përshkruan një rrëfim popullor; – lexon proverbat në fragment; – komenton proverbat e zgjedhura.			
Kriteret e suksesit: Rikujton dy fjalë të urta. Citon proverbat e zgjedhura. Vlerëson proverbat e zgjedhura në fragment.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutime Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të shkruajnë dy fjalë të urta, të cilat i kanë dëgjuar më parë në familje ose në shkollë. Pastaj, disa nxënës i lexojnë fjalët e urta dhe së bashku diskutojnë rreth kuptimeve të tyre, që lidhen me jetën dhe mesazhin që përcjellin.			

Pastaj mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësise mësimore “Proverbi” dhe shpjegon pjesën para leximit për nxënësit.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Citat – Koment/ Marrëdhënia-pyetje-përgjigje	
Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë proverbat me rend dhe të zgjedhin një proverb për komentim. Për shembull:	
Citat	Koment
Proverbi	Komenti për zgjedhjen i pëlqyer
Pas leximit të citateve të zgjedhura nga nxënësit dhe komentimit, ata udhëzohen të punojnë detyrat e ndara nga mësuesi/ja.	
Grupi i parë: Kuptojmë proverbat – detyrat: 1, 2, 3, 4.	
Grupi i dytë: Analizojmë proverbat – detyra 5.	
Grupi i tretë: Interpretuojmë proverbat – detyrat: 6, 7.	
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Studim teksti	
Nxënësit së bashku me mësuesin/en reflektojnë rreth: gjuhës së proverbave dhe reflektojnë rreth tyre duke u mbështetur në detyrat e tekstit shkollor.	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 9</i>	
Gjeni në Fjalorin e gjuhës shqipe fjalë të urta për atdhedashurinë, zgjuarsinë, të mirën, të keqen. Punoni në grupe. Hulumtoni nëpër libra ose në internet proverba, personazhet e të cilave janë kafshë, p.sh.: gomari, kali, ujku, qeni. Për secilin proverb tregoni ç’anë të karakterit të njeriut simbolizon kafsha. Nxënësit në orën e dytë prezantojnë detyrat e shtëpisë dhe planifikimi për orën e dytë në fazën e parë duhet të jetë kolazh (Kontrollimi i detyrave).	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Fonetikë		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe; - shkruan saktë fjalët që kanë ndryshime pozicionale.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe
Fjalët kyçe: ndryshim, pozicion, kombinim, fonema, shqiptim, shkrim.
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - mëson ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe; - përdor drejt ndryshimet kombinatorike në fund dhe në trup të fjalës; - shkruan saktë fjalët që kanë ndryshime pozicionale.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, fotografi të dokumenteve, materiale, video.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. – Letërsi.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: <i>Diskutim, Mbajtja e strukturuar e shënimeve</i> Cilat janë bashkëtingëlloret e zëshme? Pse quhen të tilla? Listoju ato: b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të shohin rastet kur përdoren drejt ndryshimet kombinatorike. Gjithashtu, udhëzohen nxënësit të mbajnë shënim çështjet kryesore në to, duke i paraqitur në skemë. Bashkëtingëlloret e zëshme <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> shkruhen ashtu siç shqiptohen në rastet e mëposhtme. Kur janë përpara një zanoreje: Bashkëtingëlloret e zëshme: <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> Kur gjenden në fund të fjalës ose në trup të saj, përpara një bashkëtingëlloreje të shurdhët a përpara bashkëtingëllores n: lab (labi), rob (robi), bredh (bredhi), dredh (drodha) zog (zogu) digj (digje), ligj (ligji), hov (hovi), xhuxh (xhuxhi), brez (brezi) mund, kënd, livadh, lagsha, i hovshëm,

Me bashkëtingëllore të zëshme shkruhen e shqiptohen edhe mbiemrat e prejardhur, të formuar me prapashtesën – shëm: *i përjavshëm, i përbuzshëm, i ndërgjegjshëm*.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë individuale - INSERT*

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në dyshe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura prej tyre. U lihet nxënësve 7 minuta në dispozicion dhe më pas ngrihen për të plotësuar tabelën, ku do të paraqesin njohuritë e tyre paraprake dhe njohurit e fituara në INSERT.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen të ndryshimet pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe. Ata bëjnë përmbledhje më të detajuar, si:

<i>Njohuritë që ka marrë më parë</i>	<i>Njohuritë e reja që shtohen këtë orë</i>	<i>Njohuritë që i di, por jo të sakta</i>	<i>Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton</i>
<i>V</i>	+	-----	?
Me ndryshime fonemore apo të fonemave kuptojmë ndryshimin e tingujve në një gjuhë të caktuar. Fjala “fonemë” vjen nga greqishtja e vjetër: <i>phone - tingull, zë</i> . Ndryshimi i tingujve vjen si pasojë e ndikimit të tyre mbi njëri-tjetrin.	Me ndryshime kombinatorike kuptojmë atë ndryshim fonemor që vjen si rezultat i ndikimit të një tingulli mbi një tjetër, si rezultat i kombinimit, i fqinjësisë mes tyre. Siç e thamë më lart, nyjëtimi i një tingulli ndikohet nga një tingull që i prin apo e ndjek atë, duke bërë që ky të mos shqiptohet gjithnjë njësoj. Në ndryshimet kombinatorike bëjnë pjesë: akomodimet (përshtatja), asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat, rëniet e tingujve.	Ndryshimet kombinatorike Llojet Përkufizimi Shembuj Ndryshimet pozicionale Llojet Përkufizimi Shembuj	Në të folmen e gjyshërve, prindërve dhe tuajën, përpikuni të gjeni nga një apo më shumë shembuj për secilin lloj të ndryshimeve pozicionale dhe kombinatorike.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Këto pyetje të përdorura janë vetëm sugjeruese, pasi nxënësit mund të bëjnë pyetje rreth asaj që duan të mësojnë për temën në fjalë.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Bashkëbisedim*

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe për ushtrimet e dhëna në tekst.

1. Në të folmen e gjyshërve, prindërve dhe tuajën, përpikuni të gjeni nga një apo më shumë shembuj për secilin lloj të ndryshimeve pozicionale dhe kombinatorike. Paraqitini sipas modelit të tabelës së dhënë në këtë temë mësimore.
2. Përcaktoni llojin e ndryshimeve fonemore të fjalët në vijim: asgjë: azgjë; eci: heci; punëtor: puntor; bodrum: budrum; mrekulli: mbrekulli; po: puo; kilogram: kilo; kullë: koull; vend: vent.

Mësimdhënësi/ja kontrollon punën e tyre duke korrigjuar gabimet. Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit. Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve. Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të ndryshimeve pozicionale dhe kombinatorike të fonemave në gjuhën shqipe.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Bëni është vëllai i vogël i Mirit. Ai mëson në klasën e dytë. Një mëngjes, kur po bisedonte më vëllanë, ai u habit kur shqiptoi fjalët <i>mëngjez</i> , <i>barkaz</i> , <i>baraz</i> , <i>mëngjezore</i> . A i shqiptoi drejt fjalët Beni? Argumento përgjigjen.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Fonetikë		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njihet me ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe; - dallon ndërrime zanoresh dhe ndërrime bashkëtingëlloresh; - jep përkufizimin për kuptimin e llojeve të ndërrimeve fonemore; - dallon lloje ndërrimesh fonemore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II .Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe			
Fjalët kyçe: ndërrime, fonemë, lloje, histori, gjuhë.			

Rezultatet e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- rikujton njohuritë e marra për ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe;
- mëson ndërtimin e ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe;
- përdor drejt ndërrimet zanore dhe ndërrimet bashkëtingëlloresh;
- veçon ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Nxënësi/ja zhvillon komunikimin në çdolloj fushe. - Letërsi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME
NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:**

Hapi I. Situata e të nxënit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Mësimdhënia e ndërsjellë/ Vështrim – Punë e pavarur

Nxënësit vështrojnë tekstin e dhënë në libër. Lexojnë pjesën e dhënë duke iu përgjigjur kërkesës: Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe. Nxënësit shprehin mendimet e tyre për tekstin e dhënë në libër, duke analizuar tabelat që paraqesin ndërrime zanore dhe ndërrime bashkëtingëlloresh. Më pas, një nxënës/e lexon me zë, disa nxënës japin përgjigjet e tyre, sipas kërkesës me shembuj; plotësohen dhe korrigjohen nga nxënësit dhe mësimdhënësi/ja.

Ndërrime zanoresh:
djalë-djem /shoh-sheh
dal-dola/ sjell-solla

Ndërrime bashkëtingëlloresh:
mik-miq; zog-zogj;
shes-shet; yll-yje; flamur-
flamuj

Kontrollohet puna nga mësimdhënësi/ja, korrigjohen gabimet. Plotësohet tabela nga nxënësit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

- Nxënësit njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e ndërrimeve zanore dhe të ndërrimeve bashkëtingëllore. Nxënësit në grupe dyshe punojnë me tabelën e konceptit.
- Ndalen në dallimin e llojeve të ndërrimeve të zanoreve dhe të ndërrimeve të bashkëtingëlloreve.

Nxënësit do t'i paraqesin njohurit e tyre paraprake dhe njohuritë e fituara në tabelën INSERT.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen në ndarjen e ndërrimeve të zanoreve dhe të ndërrimeve të bashkëtingëlloreve. Ata bëjnë përmbledhje më të detajuar, si:

+++ E di	VVV e re	--- E di ndryshe	??? Dua të di
- Në gjuhën shqipe, ndër ndërrimet e zanoreve hasen më dendur dy dukuri, që quhen metafoia dhe apofonia, por ka edhe raste të tjera. - Në gjuhën shqipe, ndër ndërrimet e bashkëtingëlloreve hasen më dendur ... - Një pjesë e mirë e ndërrimeve historike shfaqen kryesisht në format e ndryshme të së njëjtës fjalë, për shembull, për ndërtimin e shumësit të emrave, si: dash - desh. Siç e dëshmon shembulli, për formimin e trajtës së shumësit të fjalës <i>dash</i> shërben ndërrimi i fonemës –a në –e.	-Ndërrime zanoresh Metafoia Apofonia Përzierja Kontraksioni - Ndërrime bashkëtingëlloresh: k-q/ g-gj/ s-t/ ll-j/ r-j/ r-rr - Shumë ndërrime fonemore vihen re edhe në formimin e kohëve të ndryshme të foljeve, si për shembull: dal - dola; pres - prita; marr - mora etj. Pra, siç shihet nga këta shembuj, disa ndërrime shërbejnë për të kryer funksione gramatikore, pasi falë tyre bëhet dallimi i kuptimeve gramatikore, si numri, rasa, koha, veta etj.	- Ndryshe nga ato raste ku sot mund të shohim se si një tingull ndikon mbi një tjetër, ka disa ndryshime fonemore, të cilat mund të shpjegohen vetëm me anë të rregullave fonetike, që kanë vepruar kohë më parë në gjuhë, por që në ditët e sotme nuk veprojnë më si dikur. Këto ndryshime fonemore quhen ndërrime historike, pra, tashmë i përkasin historisë së gjuhës dhe mund të shpjegohen vetëm në kuadrin e saj.	- Kujtojmë se disa ndryshime fonemore shpjegohen me rregulla fonetike që veprojnë aktualisht në gjuhë, çka na ndihmon të shohim konkretisht ndikimin e tingujve mbi njëri-tjetrin, si pasojë e pozicionit apo e kombinimit të tyre. Kështu, për shembull, për fjalën <i>numër</i>, vihet re se folësit, jo rrallëherë, përdorin trajtën <i>numur</i>.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit janë ndarë në pesë grupe. Secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër.

Ushtrimi 1, faqe 199. Dalloni nëse te çiftet e fjalëve të dhëna ka ndryshime pozicionale, kombinatorike apo ndërrime historike. Plotësoni tabelën e dhënë.

Numër - numur; erdhi - herdhi; dash - desh; dal - dola; bukëpjekës - bukpjekës; kinema - kino; bujk - bujq; mrekulli - mbrekulli; diell - diej; bregore - bregole; bir - bij; kullë - koull; vend - vent; çjerr - çora; ekzistoj - egzistoj; shteg – shtek

Ndryshime pozicionale	Ndryshime kombinatorike	Ndërrime historike

Ushtrimi 2. Formoni shumësin e këtyre emrave: breg, shteg, shëlg, treg, plak, djalë, kalë, lepur. Nënvizoni ndërrimet fonemore.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit. Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve. Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi. Ata vlerësohen, gjithashtu, për përdorimin e drejtë të ndërrimeve historike të fonemave në gjuhën shqipe. (Vlerësim në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. Vlerësim me listë kontrolli).
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrime për ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit/es dhe të orës së mësimi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Djaloshi i gurtë			
Fjalët kyçe: fëmijët, skulptori, djaloshi i gurtë, uji, libri, pushka.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – analizon temën kryesore të tregimit; – zgjeron njohuritë për rëndësinë e librit në ruajtjen dhe ecjen përpara të shtetit; – mëson qëllimin e mesazhit që skulptori dëshiron të përcjellë te fëmijët me skulpturën e djaloshit të lirisë.			
Kriteret e suksesit: Diskuton për temën kryesore të tregimit duke zgjeruar njohuritë për mesazhin që përcjell teksti. Kupton se ndërtimit të shtetit i duhet jo vetëm pushka, por edhe libri. Vlerëson, gjykon qëllimin e mesazhit që skulptori dëshiron të përcjellë te fëmijët me skulpturën e Dialoshit të Lirisë.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Kllaster*

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë fjalët: *liri, pushkë, libër, atdhe, ujë* dhe mund t'u drejtohet nxënësve me këtë pyetje: A mund të shpjegoni mesazhin dhe rëndësinë e këtyre fjalëve për ndërtimin e shtetit dhe ruajtjen e paqes?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre, të cilat mësuesi/ja i hedh në dërrasën e zezë në formën e pemës së mendimeve.



Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e tekstit “Djaloshi i gurtë” dhe u shpjegon nxënësve se pjesa që do të lexojnë, është shkëputur nga përmbledhja “Shtëpia ime ka sy” e shkrimtarit Vehbi Kikaj. Para se të fillojë leximi i pjesës, mësuesi/ja mund t'u shpjegojë nxënësve veprimtarinë letrare dhe artistike të shkrimtarit duke u mbështetur në të dhënat e para leximit.

Pasi të lexohet pjesa, mësuesi/ja së bashku me nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1

Analizojmë tekstin.

Pastaj në klasë formohen 3 grupe dhe punojnë ushtrimet.

Grupi I- Analizojmë tekstin: ushtrimet 2, 3, 4, 5.

Grupi II - Interpretojmë tekstin: ushtrimet 6,7 dhe 8.

Grupi III - Gjuha e tekstit: ushtrimet 9,10 dhe 11.

Pasi grupet të kenë përfunduar detyrat, paraqesin para klasës përgjigjet, diskutojnë duke shkëmbyer mendime dhe duke i argumentuar ato. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura. Ai/ajo ndihmon nxënësit në plotësimin/saktësimin e përgjigjeve/mendimeve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/puno në dyshe/tregoju të tjerëve – Rrjeti i diskutimit

Kjo teknikë është shumë e përshtatshme për këtë pjesë të orës mësimore. Ndihmon nxënësit të reflektojnë rreth tekstit dhe t'u japin formë mendimeve të tyre.

Për realizimin e kësaj teknike, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të japin përgjigje me shkrim në pyetjet e ushtrimeve 12, 13 dhe 14 Reflektojmë rreth tekstit.

Për të pasur përgjigje sa më të sakta, nxënësit mund të udhëzohen të punojnë në grupe dyshe. Pasi të kenë përfunduar çdo grup dysh përfaqësohet me një diskutim, ku prezanton idetë e tij/saj rreth përgjigjeve për pyetjet e dhëna.

Duke u nisur nga natyra, përmbajtja dhe pesha e tekstit, mësuesi/ja mund t'i kushtojë rëndësi dhe theks të veçantë diskutimit dhe përgjigjeve që nxënësit do të japin për pyetjen e ushtrimit 14.

Po në ditët e sotme, çfarë i duhet më tepër Kosovës: libri apo pushka?

Nxënësit duhet të argumentojnë përgjigjet e tyre:

Po

Jo

Pse?

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 10

Lexoni poezinë “Fjalët e qiririt”, të Naim Frashërit. Diskutoni në klasë rreth mesazhit që ajo përcjell.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultate e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përshkruan dhe përcakton idetë e tiparet kryesore të teksteve letrare dhe joletrare; - përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Kujtimet (ora e parë)

Fjalët kyçe: fëmijët, loja, pëmëshitësi, pemët.

Rezultatet e të nxënësve për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- portretizon personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre;
- dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës;
- vlerëson sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmarrin fëmijët.

Kriteret e suksesit:

Përshkruan personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre.

Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa.

Gjykon e përkrah sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmarrin fëmijët pasi pendohen për veprimet e tyre të pamatura apo negative.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja mund t'u drejtohet nxënësve: Periudha e fëmijërisë është koha më e bukur, e cila do të mbetet gjithnjë në kujtesën e secilit prej nesh. Kur ju të jeni në moshë më të rritur, me siguri do të kujtoni me mall kohën e fëmijërisë. Po edhe tani, ndoshta ndonjëri nga ju mund të rrëfejë ndonjë ngjarje apo ndodhi që mund ta keni përjetuar së bashku me shokët/shoqet gjatë pushimeve të verës apo të dimrit. Ngjarje që mund t'ju ketë lënë mbresë për sjelljen apo qëndrimin për të cilin më pas jeni ndier keq dhe menjëherë mund ta keni ndryshuar. Reflektoni në dyshe, nëse keni për të treguar ndonjë ngjarje të veçantë që ju ka ndodhur dhe që mund t'ju ketë bërë të ndryshoni mendim apo edhe të pendoheni për sjelljen ose qëndrimin tuaj. A do të kishit dëshirë ta ndanit me shokët/shoqet e klasës dhe ta prezantoni?

Nxënësit do të reflektojnë në dyshe dhe do të prezantojnë ngjarjet apo ndodhitë që mund të kenë përjetuar dhe pastaj të jenë penduar për sjelljen e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësuesi/ja duhet ta organizojë mësimdhënien në dy orë mësimi. Për orën e parë përdor teknikën DRTA - *Të lexuarit e drejtuar*, për të vazhduar më pas, në orën e dytë, me teknikën *Marrëdhënia pyetje-përgjigje*.

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e njësisë mësimore “Kujtimet” dhe fillon të shpjegojë se kjo pjesë është shkëputur nga tregimi “Nën myshk” i shkrimtarit kosovar Hivzi Sylejmani. Pasi nxënësit marrin informacionin rreth krijimtarisë letrare të shkrimtarit, mësuesi/ja ndan klasën në 3 grupe. Secilit grup i caktohet pjesa që do të lexojë. Pas leximit, grupet do të kenë detyrë t’u përgjigjen pyetjeve të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja (Mësuesi/ja mund t’i përgatitë më parë fletët e bardha, ku do të ketë formuluar pyetjet dhe ndërtuar tabelën).

Ç’mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Grupi I do të lexojë dhe reflektojë për pjesën e parë që fillon nga fillimi deri te... – S’ka hajr prej fëmijëve të sodit! – pikllueshëm i ankohej Ymeri fqiu, i cili i ndihmonte për rregullimin e mallit. Gjysmën e pemëve ma kanë rrëmbyer, bre *hajnat* që janë!...”

Grupi II do të vazhdojë leximin nga: “Duke i ndëgjuar këto fjalë, fëmijët shikuan njëri-tjetrin. Duart u shkuan pavetëdijshtë kah xhepat, kah gjinjt. U erdh keq për të shkretin bablok”, deri te fundi i pjesës së parë.

Grupi III fillon nga pjesa e dytë deri në fund.

Pas përfundimit të leximit të pjesës, nxënësit do të paraqesin para shokëve mendimet dhe idetë e tyre.

Mësuesi/ja mund të shpjegojë dhe zbërthejë fjalët e panjohura, për të cilat nxënësit mund të mos kenë njohuri.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno në dyshe/Shkëmbe mendime

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit pro dhe kundër çështjes.

A vepruan mirë fëmijët që ndryshuan mendje dhe i kthyen shitësit pemët? Po ju, si do të vepronit? Argumentoni pse po (nëse nxënësit mendojnë se fëmijët kanë vepruar mirë) dhe pse jo.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 11

Detyrë: Përshkruani një ngjarje të veçantë që ju ka ndodhur dhe që ju ka bërë të ndryshoni mendim apo edhe të pendoheni.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënësve të temës: - dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Kujtimet (ora e dytë)
Fjalët kyçe: kujtimet, fëmijët, pemëshitësi, loja.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – portretizon personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – vlerëson sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmarrin fëmijët. Kriteret e suksesit: Përshkruan personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre. Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa. Gjykon e përkrah sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmarrin fëmijët pasi pendohen për veprimet e tyre të pamatura apo negative.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësuesi/ja pyet nxënësit: Pasi lexuat tërë pjesën “Kujtimet”, a mund të tregoni nëse jeni ndodhur ndonjëherë në situata të tilla? A jeni penduar për sjelljen/qëndrimin e padrejtë dhe pastaj keni ndryshuar mendje duke e ndrequr gabimin? Apo e kundërta? Shpjegoni emocionet që keni ndier. Nxënësit do të reflektojnë në dyshe dhe do të fillojnë të shprehin mendimet e tyre. Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje Nxënësit tashmë kanë marrë mjaftueshëm informacione rreth ngjarjes dhe ecures së saj, ndaj mësuesi/ja i udhëzon që nëpërmjet diskutimit të studiojnë tekstin dhe t’u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1. Përgjigjuni pyetjeve rreth tekstit. Pastaj ndan klasën në 4 grupe, të cilat do të punojnë ushtrimet: Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet: 2, 3, 4. Grupi II- Analizojmë tekstin, ushtrimet: 5, 6, 7. Grupi III- Interpretojmë tekstin, ushtrimet: 8, 9. Grupi IV- Gjuha e tekstit, ushtrimet: 10, 11.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Ashtu të ndarë në 4 grupe, mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit për fragmentet e shkëputura nga pjesa “Kujtimet”.

Grupi I do të diskutojë **për reagimin e pemëshitësit pasi fëmijët i marrin pemët**: – S’ka hajr prej fëmijëve të sodit! – pikllueshëm i ankohej Ymeri fqiut, i cili i ndihmonte për rregullimin e mallit. – Gjysmën e pemëve ma kanë rrëmbyer, bre hajnat që janë!...

Grupi II diskuton për **ndjenjat e fëmijëve pasi dëgjuan fjalët e pemëshitësit**: “Duke i dëgjuar këto fjalë, fëmijët shikuan njëri-tjetrin. Duart u shkuan pavetëdijshtë kah xhepat, kah gjinjt. U erdh keq për të shkretin bablok”.

– T’ia kthejmë! – tha njëri gjallërisht dhe u hodhi shokëve një shikim pyetës.

– Por tash s’guxojmë t’i afrohemi! – tha tjetri mendueshëm. – Unë po shkoj i pari! – shtoi më i guximshmi dhe u nis me hapa të vendosur.

Grupi III- diskuton për **gëzimin që ndien pemëshitësi kur fëmijët i kthejnë pemët**: – Edhe ju keni prurë, a?! ...Sa të mirë janë fëmijët e sodit!... Qe, qitni këtu sugarët e mi. Vetëm jo të gjitha në një vend. Dardhat veç, mollat veç. Të gjitha veç e veç. Të jenë prapë ashtu siç kanë qenë...

Grupi IV-diskuton për **zemërgjerësinë e pemëshitësit**: – Hajt, hajt!... S’keni çare pa marrë. E keni hak.

Pasi asnjëri nuk u afrohej pemëve, plaku kapi të parin përdore, e priu kah shportat dhe e urdhëroi: – Merr babo! Merr prej cilave të duash!

Nxënësit do të dëgjojnë diskutimet dhe qëndrimet e secilit grup dhe pastaj të gjithë si klasë do të nxjerrin konkluzionet.

Pasi të kenë përfunduar diskutimet, mësuesi/ja pajtohet me qëndrimet pozitive të nxënësve dhe mund t’u drejtohet atyre me këto fjalë: *Në momente dobësie, fëmijët dhe të rriturit mund të hutohen e të gabojnë, por, të ndryshosh mendimin apo të pendohesh për veprimet negative, t’i pranosh dhe të ballafaqohesh me to, tregon se me vullnetin e mirë mund të korrigjojmë sjelljet dhe veset tona.*

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 11

Nxënësit do të kenë detyrë t’u përgjigjen pyetjeve të parashtruara në rubrikën:

Reflektojmë rreth tekstit

1. Si do të silleshit ju, nëse do të gjendeshit në vend të fëmijëve atë ditë me shumë erë?
2. Çfarë ndjesish ju krijohen teksa lexoni pjesën e dytë të tekstit? Si mendoni, a është fëmijëria periudha më e bukur e jetës? Pse?
3. Cilat lojëra pëlqenit më shumë në fëmijërinë e hershme? Po tani?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Një jetë e vështirë			
Fjalët kyçe: jeta, toka, fara, bima, stinët e vitit.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – vlerëson rrugën nëpër të cilën kalon fara nga çasti kur mbillet deri te momenti që piqet dhe jep frytet e saj; – interpreton kuptimin e shprehjeve të figurshme brenda tekstit; – jep mendimin e tij/saj për personifikimin e bimës me njeriun dhe sakrificën për të përballuar vështirësitë në jetë.			
Kriteret e suksesit: Shpjegon rolin e bimës në tekst, për të treguar rrugëtimin e njeriut drejt jetës. Analizon kuptimin e shprehjeve të figurshme brenda tekstit. Gjykon mendimin e tij/saj për modelin e personifikimit të bimës me njeriun në tekst dhe sakrificën për të përballuar vështirësitë në jetë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/ Pema e mendimeve Mësuesi/ja fillon mësimin me diskutimin: • Çfarë kuptoni me termin “jetë”? • Sipas jush, si mund t’i përshkruajmë ciklet apo statet e jetës nëpër të cilat kalojmë? • Po gjatë rrugëtimin tonë jetësor, a hasim vështirësi?			

Nxënësit do të shprehin idetë e tyre lidhur me jetën. Mësuesi/ja hedh në dërrasën e zezë mendimet e nxënësve në formën e pemës së mendimeve, duke u munduar të përdorë zhvillimin dhe rritjen e bimëve gjatë stinëve të vitit, për të personifikuar bimën me njeriun dhe stinët e vitit me ciklet jetësore.

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve: *Personifikimi është figurë stilistike letrare, me anën e së cilës sendit (ose kafshës) i vishen tiparet e njeriut; gjërat pa jetë shpirtëzohen. Pra, personifikimi ndërtohet në bazë të fjalëve që thonë kafshët ose sendet e shpirtëzuara.*

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit me këmbime

Lexohet teksti “Një jetë e vështirë”. Nxënësit marrin njohuri për shkrimtarin dhe romanin nga është shkëputur fragmenti që lexuan. Mësuesi/ja së bashku me nxënësit shpjegojnë fjalët e panjohura në tekst. Duke u mbështetur në pyetjet e rubrikës “Kuptojmë tekstin”, mësuesi/ja vazhdon diskutimin me gjithë klasën. Pastaj formohen 4 grupe (me nga 5-6 nxënës) dhe secili grup punon detyrat që cakton mësuesi/ja.

Grupi I do të ketë detyrë të interpretojë tekstin duke iu përgjigjur pyetjeve në detyrat 2, 3 dhe 5.

Grupi II punon detyrat 4,5 dhe 6.

(Detyra 5 te rubrika “Interpretojmë tekstin” mund të jetë e përbashkët për të dyja grupet.)

Grupi III analizon tekstin dhe plotëson detyrat 7 dhe 8.

Grupi IV gjykon për gjuhën e tekstit duke u përgjigjur pyetjeve të parashtruara në detyrat 9 dhe 10. Pasi grupet të kryejnë detyrat e caktuara, përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre. (Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura).

Bazuar në rrjedhën e ngjarjeve në tekst, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve: *Teksti “Një jetë e vështirë” na mëson se asnjëherë nuk duhet të tërhiqemi dhe të sforcohemi para vështirësive, me të cilat mund të ballafaqohemi gjatë jetës. Dielli perëndon dhe lind çdo ditë. Në lumturi, të gjitha harrohen”.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrethi i diskutimit

Në këtë pjesë të orës, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që në grupe dyshe t’u përgjigjen pyetjeve të detyrave 11 dhe 12.

Po

Jo

Pse?

Grupet dyshe do të argumentojnë para shokëve përgjigjet e tyre duke diskutuar si klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 12

Përshkruani ciklin tuaj jetësor, që nga momenti që keni lindur (nëpërmjet kujtimeve që ju kanë dhënë prindërit) deri në ditët e sotme, duke pasur parasysh këto elemente:

- Kur keni lindur, nëna juaj ka pasur një lindje të thjeshtë?
- Keni qenë një fëmijë i shëndetshëm, apo keni pasur nevojë për ndihmë shëndetësore?
- A ju ka ndodhur ndonjë ngjarje e veçantë gjatë fëmijërisë?
- Si jeni ndier kur dikush ka vepruar padrejtësisht me ju?
- Si jeni ndier kur keni kuptuar se problemet tuaja i kanë edhe fëmijë të tjerë?
- A jeni ndier mirë kur keni kuptuar se problemet tuaja janë pjesë e rritjes?
- A ndiheni krenarë për mënyrën se si i keni kaluar vështirësitë?

Të dhënat do të prezantohen para klasës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt pikën dhe pikëçuditjen duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër, i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përdorimi i pikës dhe i pikëçuditjes			
Fjalët kyçe: përdorim, pikë, pikëçuditje, rregulla pikësimi, fjali.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegoni rastet e përdorimit të pikës dhe të pikëçuditjes; - dallon pikën dhe pikëçuditjen në fjali; - përdor drejt pikën dhe pikëçuditjen në fjali.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, uebfaqe, fjalor, fotografi të dokumenteve, shkumësa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Punë e drejtuar</i> Mësuesi/ja u jep nxënësve një tekst me një paragraf. Udhëzohen nxënësit të përdorin e t'i vënë në vendin e duhur shenjat e pikësimi dhe pikëçuditjen.			
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë e pavarur- Mësimdhënie e ndërsjellë</i> Nxënësit lexojnë në heshtje informacionin e dhënë në libër për pikën dhe pikëçuditjen në gjuhën shqipe:			

Vihet pikë:

- Në fund të një fjalie dëftore: Ja, kështu po ngrihej Shqipëria e re, e pavarur, demokratike.
- Pas një fjale a togu fjalësh ose pas një pjesëze me vlerën e një fjalie, kur nuk shqiptohen me intonacion pyetës a thirrmos: Buzëqeshje. Shpërthime të qeshurash. Duartrokitje.
- Në fund të një fjalie nxitëse jothirrmore, që shpreh këshillë, porosi, propozim, lejim ose pranim: Dëgjomëni mua. T'i doni prindërit. Le t'i diskutojmë propozimet tuaja.
- Në fund të një fjalie të përbërë: Ai vetë s'e kuptoi dot ç'e ngriti në këmbë. Pyete kur do të vijë.

Pikëçuditja vihet:

- Në fund të një fjalie dëftore-thirrmore: Eh, kushedi ku e ka mendjen!
- Në fund të një fjalie dëshirore-thirrmore e nxitëse-thirrmore: Mbetshi mirë me shëndet! Mirupafshim! Asnjë të mos më afrohet! — foli nëna. — Jam me grip.
- Në fund të një fjalie me nënrenditje, që ka si fjali kryesore një fjali me karakter thirrmos, qoftë ajo dëftore, dëshirore ose nxitëse: Sa ma bëtë qejfin që erdhët! Të lumshin këmbët që erdhe!
- Pas një thirrori ose një pasthirrme në krye të një fjalie, për t'u vënë në dukje më shumë, për t'u theksuar më shumë: — Tina! Tina! Tina! — thirrën njëzëri.
- Pas një onomatopeje që përdoret më vete: Pam! Pam! Pam! — u dëgjua një krismë. Ha-ha-ha! — u dëgjuan të qeshura nga jashtë.
- Pikëçuditja mund të përdoret e përsëritur edhe në kllapa për të shfaqur mosmiratim, ironi.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur*

Nxënësit lexojnë punimet e njëri-tjetrit, bëjnë vlerësimin e përdorimit drejt të pikës dhe pikëçuditjes. Pastaj i analizojnë bashkërisht me mësuesin/en.

Puna me ushtrime:

- Përcaktoni rregullën e përdorimit të pikës në fjalitë e tekstit të mëposhtëm (me shkronja nga a në d).
- Shpjegoni rastet e përdorimit të pikës në fragmentin e mëposhtëm.
- Vendosni pikën dhe shkronjën e madhe në fjalitë e mëposhtme.
- Shpjegoni rastet e përdorimit të pikëçuditjes. Përcaktoni rregullën (me shkronja nga a në f).
- Vendosni pikëçuditjet atje ku mungojnë (edhe kur shoqërohen me pikëpyetje).
- Vendosni shenjat e pikësimit që mungojnë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve do të jetë në vijimësi të vlerësimeve të motivuara gjatë orës së parë. Nisur nga shkalla e arritjeve të rezultateve të të nxënësve, nxënësit do të vlerësohen me notë.


DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

- Shkruani një dialog duke përdorur jo më pak se pesë herë pikën dhe pikëçuditjen.
- Në tekstin me titull “Rozafati”, gjeni fjalitë ku është përdorur pikëçuditja dhe shpjegoni pse.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt dy pikat, thonjëzat, pikëpresjen dhe kllapat duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër; i shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave			
Fjalët kyçe: përdorim, dy pika, thonjëzave, pikëpresjes, kllapa, rregulla pikësimi, fjali.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon shenjat e pikësimit në fund të fjalisë, brenda fjalisë, thonjëzat dhe vizat; - shpjegon përdorimin e dypikëshit, pikëpresjes, kllapave dhe thonjëzave në tekstet e dhëna; - argumenton përdorimin e thonjëzave dhe shenjave të tjera të pikësimit në fjalitë e dhëna.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, uebfaqe, fjalor, fotografi të dokumenteve, shkumësa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: -Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Stuhi mendimi</i> Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Diskutohet 3-4 minuta rreth ndonjë paqartësie që mund të ketë ndonjë nxënës. Paqartësitë mund të sqarohen nga nxënësit ose nga mësuesi/ja. Cilat janë shenjat e pikësimit që njihni? Ndërto një organizues grafik me njohuritë që ke marrë nga klasat e mëparshme.			



Sqarohen nxënësit se tema e sotme e mësimit do të trajtojë përdorimin e drejtë të dy pikave, thonjëzave, kllapave dhe pikëpresjes në tekste të ndryshme.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT

Udhëzohen nxënësit të punojnë me teknikën INSERT.

Udhëzohen të hapin tekstet e të plotësojnë tabelën INSERT.

<i>Njohuritë që ka mësuar më parë</i>	<i>Njohuritë e reja që do të marrë në këtë mësim</i>	<i>Njohuritë që di, por që janë ndryshe nga ato të saktat</i>	<i>Njohuri, të cilat kanë nevojë për sqarimin e mësuesit</i>
<i>VVV</i>	<i>+++</i>	<i>-----</i>	<i>???</i>
Dy pikat shënojnë grafikisht një pushim, që zgjat më pak se pika dhe më shumë se presja. Thonjëzat tregojnë që fjalët e përfshira në to nuk janë të një natyre me pjesën tjetër të tekstit, ose që fjalët brenda tyre nuk janë përdorur me kuptimin e tyre të zakonshëm. Pikëpresja shënon grafikisht një pushim më të gjatë se presja, por më të shkurtër se pika. Kllapat shënojnë një pushim të shkurtër, si presja dhe shërbejnë për të dalluar, për të shquar dhe për të veçuar fjalë apo fjali që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërkallur.	Përdoren para onomatopeve, kur vijnë pas fjalësh që i paralajmërojnë: Përdoren para një vargu gjymtyrësh homogjene.		

Plotësohet tabela duke u punuar individualisht nga nxënësit dhe më pas plotësohet nga të gjithë nxënësit në tabelën e zezë.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët
Në këtë fazë të orës mësimore punohet me ushtrimet e dhëna në tekst:

Ushtrimi 1, faqe 207 - Shpjegoni përdorimin e dy pikave dhe të pikëpresjes.

- *Kapedanët më të dëgjuar që morën pjesë, ishin këta: Gjergj Arianiti i Kaninës; Andrea Topia, stërnip i Karl Topisë, kryezot i Skurisë, krahinës midis Krujës e Durrësit, me të dy bijtë dhe me të nipin Tanush Topinë; Teodor Korona, kryezot i Beratit, me disa krerë të tjerë të Myzeqesë; GjergjStres Balsha...*
- *Pjesën më të madhe, pothuaj tërë punën, e mbaruat: Kruja dhe tërë krahina e saj u fitua; Dibra dhe Malësia u bashkuan me ne; armikut s'i mbeti as emri, as shenja në fushat tona; qëndrojnë vetëm fortesat.*
- *Rruga dukej e magjishme; gjithçka në të: pemët, kanalet anësore, gurët kilometrike, ishin të bukur, miqësorë.*

Më pas punohet në fletoren e detyrave të klasës ushtrimi 2.

2. Çfarë ndan pikëpresja dhe çfarë paralajmërojnë dy pikat në fjalitë e mëposhtme?

- Atë mbrëmje, e mbuluar nën jorgan, ajo mendoj për të gjitha. Kujtoi jetën e saj: fëmijërinë, kur këmbëzbathur bridhte udhëve të fshatit; nënën plakë e të dobët gjithnjë të heshtur; babanë punëtor, të ndershëm, po përherë të mbyllur në vetvete; vëllanë e dashur, po të largët.
- Kallëzuesi mund të shprehet me një folje të vetme: *Shtatorja e Nenë Terezës qëndron madhështore në hyrje të aeroportit.*

Punohen ushtrimet 3,4 në faqen 207.

3. Atje ku duhen, vendosini thonjëzat. Shpjegoni përdorimin e tyre.

- Kur kaloi pranë meje, më rrahu krahët e më tha: “Ki mendjen, Artan. Trimëria s’ka kuptim pa zgjuarsinë.”
- Lidhja Shqiptare u krijua për të përballuar rrezikun e copëtimit, kur shqiptarët, siç thotë kënga popullore, lidhën besën si e kemi zakon, të vdesim apo të rrojmë.

4. Shpjegoni përdorimin e kllapave.

- Petriti: – Lamtumirë, kapedan! Të falem nderit! (U afrohet t’i përqafojë, po prapë e mban veten dhe largohet).
- Një ditë (dita s’mbahet mend, as muaji) një fshatar shiti demin për të blerë një maliher.
- Përdorimi i kompjuterave (portativë), vitet e fundit është përhapur në mënyrë marramendëse.

Përgjigjet e ushtrimeve shoqërohen me argumente.

Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të shenjave të pikësimit në tekstet e dhëna.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 52

Formoni nga dy fjali për secilin rast, në të cilat të përdorni: dy pikat; pikëpresjen; thonjëzat; kllapat

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kthimi i Skënderbeut në Krujë (ora e parë)			
Fjalët kyçe: Arbëri, Kruja, Skënderbeu, liria.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – vlerëson kontributin e heroit kombëtar për çlirimin dhe bashkimin e Arbërisë; – rrit frymën e bashkëpunimit në grup duke vlerësuar/respektuar mendimin e shokëve/shoqeve; – jep mendimin e tij/saj mbi efektin që përcjellin te lexuesi/dëgjuesi bëmat dhe trimëria e Skënderbeut.			
Kriteret e suksesit: Kupton rëndësinë e bashkimit të popullit për të fituar lirinë. Analizon elementet ndërtimore të romanit si tekst letrar rrëfimtar. Shkruan një ese për heroizmin e Gjergj Kastriotit Skënderbe.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/ Prezantim digjital Mësuesi/ja u drejtohet nxënësve: A mund të tregoni se kush është heroji ynë kombëtar, i cili ka lënë gjurmë në histori, jo vetëm te shqiptarët, por në mbarë botën? Nxënësit do të japin përgjigjet e tyre. Mësuesi/ja pastaj mund të përdorë projektoren dhe të paraqesë para nxënësve pjesë nga filmi “Skënderbeu”, për shembull: arritjen e heroit në Krujë dhe fjalimin që mban para bashkëkombësve të tij.			

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se pjesa që do të punojnë, është shkëputur nga romani “Historia e Skënderbeut”, i shkrimtarit Odhise Grillo.

Odhise Grillo (1932-2003) është autor i mirënjohur i letërsisë shqipe për fëmijë. Ai ka lëvruar të gjitha gjinitë dhe llojet letrare: vjershën, poemën, fabulën, tregimin, novelën, përrallën, romanin. Ka përshtatur për fëmijë vepra shumë të rëndësishme, si: “Lahuta e Malësisë”, e Gjergj Fishtës; Historia e Skënderbeut” e Naim Frashërit etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësuesi/ja duhet ta organizojë në dy orë mësimi. Pasi shkruan në dërrasën e zezë titullin e njësisë mësimore “Kthimi i Skënderbeut në Krujë”, ndan klasën në 4 grupe.

Grupi I do të lexojë dhe pastaj reflektojë për pjesën e parë nga fillimi deri te “Nga gjithë vendi u nisën me qindra e mijëra vetë për në Krujë, për të parë mbretin, për të përshëndetur Gjergjin, për të përgëzuar shpëtimtarin, për të parë Skënderbeun, birin e madh të Arbërisë.”

Grupi II do të vazhdojë nga “Pleqtë që e kishin njohur qysh kur ishte i vogël dhe e kishin përcjellë në Adrianopojë me lot në sy, vajtën dhe e puthën në duar dhe në ballë duke qarë.”, deri tek “Osmani nuk bëri as gëk, as mëk, po uli kokën dhe doli jashtë. Të nesërmen në mëngjes mori rrugën për në Adrianopojë, në krye të ushtarëve të vet. Disa që nuk dëgjuan fjalën e Skënderbeut, po ngritën jataganin kundër tij, hëngrën dhe”.

Grupi III fillon të lexojë nga “Sa morën vesh këtë lajm, edhe në fortesat e tjera të Arbërisë nuk mbeti më këmbë osmani”, deri tek “A e keni parë diellin si ndriçon në qiell? Ashtu ndriçonte edhe mbreti i Arbërisë, Skënderbeu!”.

Grupi IV fillon nga “Skënderbeu erdhi e zuri vend në mes të tyre si i barabarti në mes të barabartëve, i thjeshtë e i dashur, i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës, si gjithë të tjerët që kishte përreth.”, deri në fund të tekstit.

Pasi të kenë përfunduar leximin dhe reflektimin rreth pjesës që lexuan, nxënësit së bashku me mësuesin/en do të shpjegojnë fjalët e panjohura. Pastaj nxënësit punojnë ushtrimet të parashtruara në rubrikën “Kuptojmë tekstin”.

Për të kompletuar përgjigjet, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Bashkëbisedimi- Puno në dyshe/ shkëmbe mendime

Nxënësit do të punojnë në dyshe detyrën 10 të rubrikës “Reflektojmë rreth tekstit”.

Bashkëbisedoni rreth figurës së Skënderbeut dhe argumentoni përse ai konsiderohet hero i kombëtar.
Pasi të kenë bashkëbiseduar me shokun/shoqen, të gjithë si klasë do të paraqesin argumentet, të cilat Skënderbeun e bëjnë heroin më të madh të kombit shqiptar.

P.sh.: Skënderbeu bashkoi arbitrin në gjithë Arbërinë.

Ai çliroi arbitrin nga zgjedha e pushtuesit osman.

Ktheu buzëqeshjen dhe shpresën e humbur në vatrën e arbërve.

I tregoi botës mbarë se shqiptarët, të bashkuar nën udhëheqjen e prijësit, strategut dhe trimtë të pathyer Skënderbe, mundën të mposhtin një armik aq të madh në numër, siç ishin turqit.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 13

Gjeni në internet Kreun IV të poemës “Istori e Skënderbeut”, që nis me vargjet “Krujë, o qytet i bekuar!/ Prite, prite Skënderbenë,/ Po vjen si pëllumb i shquar,/ Të shpëtonjë mëmëdhenë”. Krahasoni vargjet e poemës me pjesën që lexuat. A i qëndron besnik autori poemës që ka ritreguar?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin e personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kthimi i Skënderbeut në Krujë (ora e dytë)			
Fjalët kyçe: Arbëri, Kruja, Skënderbeu, liria.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – vlerëson kontributin e heroit kombëtar për çlirimin dhe bashkimin e Arbërisë; – rrit frymën e bashkëpunimit në grup duke vlerësuar/respektuar mendimin e shokëve/shoqeve; – jep mendimin e tij/saj mbi efektin që përcjellin te lexuesi/dëgjuesi bëmat dhe trimëria e Skënderbeut.			
Kriteret e suksesit: Kupton rëndësinë e bashkimit të popullit për të fituar lirinë. Analizon elementet ndërtimore të romanit si tekst letrar rrëfimtar. Shkruan një ese për heroizmin e Gjergj Kastriotit Skënderbe.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/krahasime Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të mbështeten në detyrën e dhënë në shtëpi dhe të krahasojnë vargjet e poemës “Krujë, o qytet i bekuar!/ Prite, prite Skënderbenë,/ Po vjen si pëllumb i shkruar,/ Të shpëtonjë mëmëdhenë”. Mësuesi/ja gjithashtu kërkon nga nxënësit të tregojnë se a i qëndron besnik autori poemës që ka ritreguar?			

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Tanimë nxënësit kanë marrë mjaftueshëm njohuri rreth ngjarjes dhe situatave që ndodhin në tekst. Mësuesi/ja ndan klasën në 3 grupe. Nga nxënësit kërkon që pasi grupet të kenë përfunduar detyrat e kërkuara, përfaqësuesit e tyre të prezantojnë përgjigjet dhe të gjithë si klasë të analizojnë përgjigjet e dhëna.

Grupi I - Analizojmë tekstin: ushtrimet 2 dhe 3.

Grupi II - Interpretojmë tekstin: ushtrimet 4, 5, 6, 7.

Grupi III - Gjuha e tekstit: ushtrimet 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit gjatë kryerjes së ushtrimeve duke kontrolluar punën e grupeve dhe duke bërë ndërhyrjet e duhura. Për shembull, tek ushtrimi 3 “Analizojmë tekstin”, nxënësit mund të udhëzohen të renditin mbiemrat në një tabelë si kjo.

Skënderbeu erdhi e zuri vend në mes të tyre si:	<i>i barabarti në mes të barabartëve</i>
	<i>i thjeshtë e i dashur</i>
	<i>i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës...</i>

Te pyetja 6 “Interpretim të tekstit” - Skënderbeu nuk ishte si sulltani, sepse ai i konsideronte luftëtarët e tij të barabartë me vetveten. Prandaj dhe trimat e Skënderbeut gjithnjë korrnin fitore, sepse kryetrimi i tyre, Skënderbeu i trajtonte me dashuri dhe respekt: *Ai ishte i thjeshtë, i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës, si gjithë të tjerët që kishte përreth.*

Po ashtu edhe tek ushtrimi 8 në rubrikën “Gjuha e tekstit”, nxënësit mund të paraqesin në tabelë fjalitë pyetëse që ndodhen në tekst dhe të ndajnë ato që u drejtohen lexuesve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ese e shkurtër shpjeguese

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të shkruajnë një ese të shkurtër me 3 paragrafë dhe me jo më shumë se 50-70 fjalë. Eseja të jetë shpjeguese dhe të mbështetet në tekstin “Kthimi i Skënderbeut në Krujë”. Nxënësit duhet të shpjegojnë se ku qëndron suksesi i Skënderbeut, si arrin ai t’i bashkojë arbrit për ta ndjekur nga pas dhe për të luftuar gjatë gjithë jetës për lirinë e Arbërisë.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 13

Gjeni pjesë të tjera artistike ose letrare që i kushtohen heroit tonë kombëtar.

Emri i Skënderbeut përdoret si emërtesë në institucione të fushave të ndryshme, si p.sh.: Shkolla “Skënderbeu” etj. Gjeni me ndihmën e prindërve emërtesa të tjera që përmbajnë emrin e Skënderbeut.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përshkruan dhe përcakton idetë e tiparet kryesore të teksteve letrare dhe joletrare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Një medalje për madhështinë			
Fjalët kyçe: mori, aktivist, i paepur.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton vlerat e njeriut human; - përshkruan jetën dhe veprat e autores; - diskuton në grup për pjesën e mësuar. Kriteret e suksesit: Përshkruan një personazh pozitiv të lexuar në libër. Analizon pjesën “Një medalje për madhështinë” nga R. J. Palacio. Shkruan një shkrim për djaloshin Agustin Pullman.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Gushëkuqi rrethor Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të përshkruajnë një personazh human në grupet përkatëse dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin për mendimet e tyre. Në secilin grup, nxënësit veprojnë njësoj, pastaj diskutojnë me të gjithë nxënësit e klasës për mendimet e tyre rreth temës. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit. Po ashtu, shpjegon edhe fjalët kyçe.			

Pjesa e mëposhtme është shkëputur nga libri “Mrekullia”, i Ar. Xhi. Palasios. Agustini ka lindur me disa deformime të rënda në fytyrë, por ai ëndërron të jetë një fëmije si gjithë të tjerët. Në moshën 11-vjeçare, kur shkon për herë të parë në shkollë, zë fill sfida e tij: A do ta besojnë të tjerët që ai është njësoj si ata, përtej pamjes së jashtme? Në këtë fragment, personazhi ynë bëhet fitues i një çmimi të rëndësishëm në shkollën e tij.

Pastaj shpjegon edhe fjalët nga fjalori.

Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon se shkrimtarja R. J. Palacio është një autore bashkëkohore amerikane. Ajo ka një eksperiencë të gjatë pune si drejtore artistike dhe disenjatore kopertinash për autorë të ndryshëm. “Mrekullia” është libri i saj i parë. Falë suksesit të jashtëzakonshëm, ai u ndoq edhe nga dy libra të tjerë, të frymëzuar nga i pari.

Pastaj, nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre dhe të lexojnë pjesën “Një medalje për madhështinë”; duhet të punojnë sipas udhëzimit.

Nxënësit punojnë të ndarë në tri grupe me numër të njëjtë nxënësish.

Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para klasës. Një nxënës/e prezanton grupin. (Nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta, sepse të gjithë e kanë lexuar dhe ndalen më shumë te ndarja e çmimeve.)

Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh.: ku mundën të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të obligojë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive e negative, duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre.

Pas prezantimit të mendimeve dhe debateve, grupet udhëzohen të punojnë ushtrimet e caktuara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyra 1. Përgjigjuni pyetjeve 1, 2, 3 dhe Analizojmë tekstin – detyra 2.

Grupi i dytë: Interpretojmë tekstin – detyrat 4, 5, 6.

Grupi i tretë: Gjuha e tekstit – detyra 7.

Pastaj të gjithë reflektojnë rreth tekstit – detyra 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e një pesëvargëshi.

Agustin
I ndrojtur i lumtur
Lexonte luante krijonte
Fitoi çmim të rëndësishëm në shkollën e tij
Pullman

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 15
Gjeni librin në internet apo në bibliotekë dhe lexojeni.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt trepikëshin duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër; e shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përdorimi i trepikëshit (...)			
Fjalët kyçe: përdorim i trepikëshit, rregulla pikësimi, vihet midis presjesh, fjali.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - njihet me përdorimin e trepikëshit dhe e veçon në fjali; - shpjegon rastet e përdorimit të trepikëshit; - dallon trepikëshin në fjali; - përdor drejt trepikëshin në fjali duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër; e shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, uebfaqe, fjalor, fotografi të dokumenteve, shkurtesa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi			

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Hapi I. Situata e të nxënës

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: *Stuhi mendimesh*

Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e trepikëshit.

Trepikëshi tregon që thënia, për arsye të ndryshme, ndërpritet e nuk jepet e plotë.

Nxënësit japin edhe shembuj të tjerë të përdorimit të trepikëshit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në grupe - dyshe*

Një nxënës lexon në libër rastet e përdorimit të trepikëshit që janë dhënë në gjashtë grupe.

Ndërprerja mund të bëhet në fjali dhe në fjalë të veçanta.

a) Për të shprehur ndërprerjen e një thënieje, në mënyrë që t'i lihet lexuesit ta marrë me mend çfarë ka dashur të thotë tjetri: Ja, sa të më rritet djali, pa... Sa të korrim grurin, sa të mbledhim duajt e fundit, pastaj...

b) Në shkurtimet e fjalëve ose të datave që nuk duam t'i japim të plota, ose që s'na kujtohen: Nga rrethi i Gj... Aty nga fillimi i majit të vitit 200...

c) Për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog: - Eja, eja më pranë. - Po priste të fliste ajo...

ç) Pas një numërimi që nuk jepet deri në fund: Ja, caktojmë Dianën një, dy, tre....

d) Në citime, për të treguar që fjalia nuk jepet e plotë në fillim, në mes a në fund të saj: "...shkolla jonë do të pësojë ndryshime në formë,... në strukturë, në përmbajtje...."

dh) Përdoret në vend të një shkronje, fjale, numri a shenje aritmetike që nxënësi/ja duhet ta gjejë: Përdorni trajtat e shkurtra në vendet bosh: Anijet e mëdha mezi ... bëjnë ballë dallgëve të fuqishme.

Punë në grupe

Ndahen nxënësit në gjashtë grupe dhe shkruajnë në tabelë me bojëra uji, 6 rregullat e përdorimit të trepikëshit. Më pas i afishojnë në muret e klasës, ku do të qëndrojnë gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur*

Ushtrimi 1. Shënoni se me cilin rregull të përdorimit të trepikëshit lidhen shembujt e mëposhtëm (nga a në dh).

Ushtrimi 2. Shkruani një dialog të shkurtër, ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trepikëshit.

Ushtrimi 3. Në pjesën e leximit me titull "Ciklopi", gjeni dhe shpjegoni raste të përdorimit të trepikëshit.

Pasi mbarojnë punën, nxënësit lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve do të jetë në vijimësi të vlerësimeve të motivuara gjatë orës së parë. Nisur nga shkalla e arritjeve të rezultateve të të nxënës, nxënësit do të vlerësohen me notë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 53

Shkruani një shkrim të shkurtër me temë "Unë pas dhjetë vjetësh", ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trepikëshit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin dhe personazhin në një tekst tregimtar e dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Bora e fëminisë			
Fjalët kyçe: bora, fëmijët, saja, dardaleca, sokak, mëhalla...			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – parashikon zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi figurativ dhe titulli i tekstit; – analizon ngjarjen në tekst; – krijon një shkrim përshkrues për kujtimet e tij/saj të fëmijërisë.			
Kriteret e suksesit: Përshkruan zhvillimin e ngjarjes duke u nisur nga ilustrimi dhe titulli i tekstit. Arsyeton/kupton rolin e antitezës, mbiemrave dhe ndajfoljeve në zhvillimin e ngjarjes në tekst. Kthen në shqipen standarde tekstin, pa e prishur kuptimin e tij.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinata e drejtuar Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: <i>bora, fëmijët, sajat, daja...</i> Mund të shkruajë dhe një fjali, p.sh.: “ <i>Jemi idhnu- jemi pajtu: kemi qesh e kemi gzu, me topa bore e dardaleca!...</i> ” Pastaj mund të pyesë nxënësit: Çfarë ju sjellin në mendje këto fjalë dhe kjo fjali? Po fjalia “ <i>Jemi idhnu - jemi pajtu</i> ”, çfarë paraqet?			

Nxënësit fillojnë të lidhin mendimet e tyre. Sipas fantazisë së tyre, ata do të sjellin/krijojnë mendime, të cilat mund t'i hedhin në fletore dhe më pas t'i paraqesin para klasës.

Bora sjell gëzim për fëmijët, sepse dalim dhe rrëshqasim me saja. Gjatë pushimeve dimërore është kënaqësi kur bie borë dhe ne shkojmë te daja. Atje, së bashku me shokët e lagjes, rrëshqasim me saja dhe argëtohemi....

Fjalja “Jemi idhnu - jemi pajtu” shpreh kundërshti të mendimeve.

Mësuesi/ja mund të ndihmojë nxënësit dhe t'u shpjegojë se: *figura stilistike, e cila përfitohet duke vënë ballë për ballë dy anë, dy gjendje, dy pamje dhe dy dukuri të kundërta, quhet antitezë.*

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim artistik/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e tekstit “Bora e fëminisë” dhe fillon t'u shpjegojë nxënësve: Teksti letrar që do të punojmë sot, na sjell atmosferën e gëzimit të një brezi fëmijësh në stinën e dimrit. Është i shkruar në dialektin e gegërishtes dhe shpalos ndjenjat e pastra të gëzimit dhe hareshë që fëmijët kanë përjetuar gjatë stinës së dimrit.

Në këtë tregim përshkruhen kujtimet e fëmijërisë, lojërat e bukura në dëborën e parë dhe harenë e një mjedisi të çiltër, ku mbizotërojnë dashuria dhe gëzimi i sinqertë i të vegjëlve. Në këtë tregim, çdokush mund të gjejë copëza të kujtimeve të fëmijërisë së vet.

Autorja e këtij tregimi është Fjolla Spanca. Ajo ka lindur në Mitrovicë, në vitin 1993. Është aktiviste e shoqërisë civile dhe e të drejtave të grave. Ajo ka shkruar shumë artikuj artistikë e publicistikë dhe është vlerësuar me çmime për veprimtarinë e saj krijuese.

Ky tekst letrar kërkon lexim artistik. Mësuesi/ja mund të përzgjedhë 3 nxënës/e që kanë aftësi në të lexuarin artistik, t'iu ndajë tekstin dhe ta lexojnë atë para klasës. Pas leximit shpjegohen fjalët e panjohura dhe të gjithë si klasë, me ndihmën e mësuesit/es, punojnë ushtrimin 1 të rubrikës “Kuptojmë tekstin”. Pastaj, mësuesi/ja formon 3 grupe nxënësish dhe ndan detyrat.

Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2, 3, 4 dhe 5.

Grupi II - Interpretojmë tekstin, ushtrimet 6,7 dhe 8.

Grupi III - Gjuha e tekstit, ushtrimet 8 dhe 9.

Pasi të kenë përfunduar detyrat, nxënësit paraqesin para klasës përgjigjet, mendimet dhe sugjerimet e tyre. Ata mund të bashkëpunojnë dhe të japin mendimin e tyre për përgjigjet e shokëve/shoqeve. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/Puno në dyshe/Tregoj të tjerëve

Për të realizuar këtë teknikë, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që, duke punuar në dyshe, të kryejnë ushtrimet 10 dhe 11 të “Reflektojmë rreth tekstit”.

Rilexoni paragrafin e fundit të tregimit. Si mendoni, a ekziston sot realiteti i fëmijërisë që ka përshkruar autorja?	A rriten sot fëmijët “pa tutën” e prindërve, si atëherë? Çfarë ka ndryshuar në ditët e sotme, krahasuar me vitet e fëmijërisë së autores?
<i>“Ishin kohnat kur mahalla ish shpija jonë! Kohnat kur dashnija ka jetu pa kushte! Kur fëmijët me çizme plastike e çorape prej leshi, rriteshin pa tutë... kohnat lehta, t'mira, t'ihjeshta! Kohna t'patrazueme për shpirtin njomak! Kohna t'varfnisë! Stinë t'pasunisë, së patundshme! Stinë dashnish t'vockla; andrrash t'mdhaja!”</i> <i>Nxënësit shprehin mendimet e tyre, po ekziston apo e kundërta, jo sot nuk ekziston një frymë e tillë...</i>	Po/Jo – Rriten/Nuk rriten me frikë?... Sot, fëmijët më shumë kohë kalojnë në ambiente të mbyllura duke luajtur apo argëtuar me lojëra elektronike. Fëmijëria e autores është më e gjallë... me më shumë aventura, veprimtari, dashuri mes shokëve dhe shoqeve.

Vlerësimi i nxënësve
Vlerësimi do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore. Vlerësim diagnostikues dhe formues.
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 16</i>
Shkruani tregimin duke e kthyer në shqipen standarde, aq sa është e mundur, pa ia prishur kuptimin. Përshkruani kujtimet më të bukura që keni nga fëmijëria juaj.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin dhe personazhin në një tekst tregimtar e dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Purpuranti			
Fjalët kyçe: luftë, judë, samar, ogur, llohëz.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – rikujton vlerat e heroit kombëtar “Skënderbeu”; – përshkruan jetën dhe veprat e autorit; – diskuton në grup për pjesën e mësuar. Kriteret e suksesit: Përshkruan një personazh historik. Analizon pjesën “Purpuranti” nga Bilal Xhaferi. Shkruan një shkrim për figurën e njohur të Skënderbeut.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Gushëkuqi rrethor

Në këtë fazë, udhëzohen nxënësit të përshkruajnë një personazh historik në grupet e tyre dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin për mendimet e veta. Në secilin grup, nxënësit veprojnë njëloj dhe pastaj diskutojnë me të gjithë nxënësit e klasës për mendimet e tyre rreth temës. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit. Po ashtu, shpjegon edhe prozën historike.

Proza historike rrëfen ngjarje të vendosura në periudha të lavdishme.

Në prozën historike mund të përfshihen karaktere imagjinare, figura të njohura historike ose një përzierje mes tyre. Karakteret e krijuara, imagjinare, ndërtohen sipas imazhit të shoqërisë në periudhën historike për të cilën bën fjalë vepra.

Subjekti ndërtohet në bazë të një përzierjeje mes ngjarjeve reale dhe imagjinare. Paraqiten ngjarje të rëndësishme historike, por edhe ngjarje të vogla, të përditshme.

Personazhet përfshihen në një konflikt që është tipik, real për kohën kur zhvillohen ngjarjet. Dialogët dhe monologët e personazheve janë në përputhje me mendimet dhe nivelin e kohës për të cilën flitet. Vendi ku zhvillohen ngjarjet është një vendndodhje gjeografike e njohur, reale.

Në prozat historike i kushtohet vëmendje përshkrimit të detajeve (veshjes, ambientit etj.), për t'u siguruar që ato përshtaten me periudhën kohore për të cilën rrëfëhet.

Pastaj shpjegon edhe fjalët nga fjalori.

Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon për shkrimtarin Bilal Xhaferri. Për shembull, shkrimtari Bilal Xhaferri (1935-1986) ka shkruar vëllimin me tregime “Njerëz të rinj, tokë e lashtë”, vëllimin me poezi “Lirishta e kuqe” dhe romanin “Krastakraus”. Pas internimit nga regjimi i kohës, ai arratiset dhe shkon në Boston, ShBA. Atje themelon revistën “Krahu i shqiponjës”, ku boton shumë artikuj publicistikë, poezi, tregime, pjesë romanësh, skeçe, vizatime, karikatura etj.

Pastaj udhëzohen nxënësit të ndahen në tri grupe, të lexojnë pjesën **“Purpuranti”** dhe të punojnë sipas udhëzimit.

Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve të tjerë. Një nxënës/e prezanton grupin. (Nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta, sepse të gjithë e kanë lexuar dhe ndalen më shumë te ngjarja e luftës.)

Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh.: ku munden të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të obligojë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive e negative, duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre.

Pas prezantimit dhe debateve, grupet udhëzohen të punojnë ushtrimet e përcaktuara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyrat 1, 2 dhe Analizojmë tekstin – detyrat 3, 4, 5

Grupi i dytë: Interpretojmë tekstin – detyrat 6, 7, 8.

Grupi i tretë: Gjuha e tekstit – detyrat 9, 10, 11, 12.

Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit – detyrat 13, 14.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e pesëvargëshit.

Skënderbeu

I fortë i ditur

Luftonte udhëhiqte fitonte

është heroi ynë kombëtar

Gjergj

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 17

Gjeni dy romanë të tjerë që përshkruajnë ngjarje të periudhës së Skënderbeut.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin dhe personazhin në një tekst tregimtar dhe dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Komandanti i klasës (ora e parë)			
Fjalët kyçe: Antoni, komandanti i klasës, mësuesi, shokët.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – gjykon qëllimet/veprimet e personazhit/Antonit; – interpreton kuptimin/mesazhin e tekstit; – jep mendimin e tij/saj për ambicien përvëluese të Antonit. Kriteret e suksesit: Kupton qëllimet/veprimet negative të personazhit/Antonit. Analizon kuptimin dhe qëllimin e mesazhit brenda tekstit. Kritikon/diferencon ambiciet dhe qëndrimin e Antonit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinata e drejtuar Mësuesi/ja mund të pyesë nxënësit: <i>Si veproni për të fituar vlerësimin e shokëve dhe të shoqeve të klasës? Si duhet të jetë portreti i udhëheqësit/ komandantit të klasës?</i> Nxënësit udhëzohen që të punojnë në dyshe dhe të shkruajnë mendimet e tyre. Më pas, nxënësit prezantojnë para klasës mendimet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja shpjegon për nxënësit:			

Portreti është paraqitja e pamjes së jashtme të njeriut (fytyrës, trupit, veshjes etj.).

Herë-herë thuhet “portreti i brendshëm” ose “portreti moral”, duke nënkuptuar bashkësinë e tipareve të karakterit të njeriut, botën e ndjenjave dhe të mendimeve të tij.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e njësisë “Komandanti i klasës” dhe u shpjegon nxënësve: *Në këtë tregim, autori austro-hebre Jozef Ruth (1894-1939) rrëfen për historinë e Antonit, një nxënës i rregullt e me rezultate të larta, që mban brenda vetes një qëllim e dëshirë të fshehur: të bëhet senator. Si do të veprojë Antoni për t’i zënë vendin shokut të klasës?”*

Para se të fillojë leximi, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve veprimtarinë dhe jetën e autorit, duke u mbështetur në të dhënat nga libri shkollor apo materiali shtesë.

Pasi lexohet pjesa dhe zbërthehen fjalët e panjohura, në klasë formohen 4 grupe nxënësish dhe punojnë detyrat e dhëna.

Grupi I - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1.

Grupi II - Analizojmë tekstin, ushtrimi 2.

Grupi III - Analizojmë tekstin, ushtrimi 3.

Grupi IV - Gjuha e tekstit, ushtrimi 4.

Pasi të kenë përfunduar detyrat, përfaqësuesit e grupeve paraqesin para klasës punën e secilit grup. Të gjithë kanë të drejtë të ndërhyjnë për të dhënë sugjerime dhe për të plotësuar përgjigjet e njëri-tjetrit. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjen e duhur.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargëshi

Nxënësit do të formulojnë nga një pesëvargësh, duke u munduar të paraqesin me fjalë se si do të duhej të ishte senatori/udhëheqësi i klasës sipas tyre.

Do të përshkruajnë portretin moral të senatorit/udhëheqësit/komandantit ideal të klasës.

Udhëheqësi
I ndershëm, i ditur, i dashur
Nderon, sakrifikon, punon, mirëkupton
Është shembull për klasën
Nxënës

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 14

Mësuesi/ja mund të formojë 3 grupe nxënësish dhe t’u kërkojë që të shkruajnë:

Grupi I - Një letër drejtuar mësuesit/es, në të cilën i kërkon falje për mungesën e sinqeritetit në një situatë.

Grupi II - Një rrëfim të shkurtër nga përvoja juaj, kur keni bërë plane të pandershme për të arritur një qëllim.

Grupi III - Një shkrim argumentues, në të cilin mbron tezën se ambicia e tepruar shpesh të çon në rrugë të gabuar.

Shkrimet krijuese të nxënësve do të lexohen para klasës në orën e dytë, e cila do të fillojë me reflektimin rreth tekstit “Komandanti i klasës”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin dhe personazhin në një tekst tregimtar e dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Komandanti i klasës (ora e dytë)			
Fjalët kyçe: Antoni, komandanti i klasës, mësuesi, shokët.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – interpreton kuptimin/mesazhin e tekstit; – jep mendimin e tij/saj se si duhet të jetë udhëheqësi i klasës; – shkruan një shkrim/rrëfim për një situatë reale apo imagjinare, të përafërt me ngjarjen dhe situatën në tekstin letrar.			
Kriteret e suksesit: Analizon kuptimin dhe qëllimin e mesazhit brenda tekstit. Kritikon/diferencon ambiciet dhe qëndrimin e Antonit. Përdor fjalor të përshtatshëm në lidhje me situatën reale apo imagjinare që shkruan.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/ Reflektojmë rreth tekstit Mësuesi/ja u drejtohet nxënësve: Duke kujtuar planet e pandershme që Antoni kishte kurdisur në kokën e tij për të zënë pandershmërisht vendin e senatorit të klasës, reflektoni në dyshe dhe veproni si më poshtë: • Jepni mendimin se cilat janë detyrat kryesore të senatorit të klasës. • Kur një senator klase quhet i suksesshëm?			

Mendimet dhe sugjerimet e nxënësve mund të shkruhen në formën e pemës së mendimeve në dërrasën e zezë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Karrigia e autorit

Kjo teknikë është mjaft e përshtatshme për paraqitjen dhe prezantimin me sukses të shkrimeve krijuese.

Mësuesi/ja u kërkon përfaqësuesve të grupeve që të lexojnë punimet e tyre me shkrim, të cilat nxënësit i kanë përgatitur sipas udhëzimeve të kërkuara në orën e parë.

Përfaqësuesi i grupit, i cili luan edhe rolin e autorit, ulet në karrigen e autorit dhe e lexon punimin. Shokët e grupit mund të pozicionohen prapa ose aty afër. Të gjithë nxënësit thellohen në reflektimin e ideve dhe argumenteve që lexojnë. Pasi lexohet pjesa, nxënësit e dy grupeve të tjera mund të bëjnë pyetje në lidhje me pjesën e shkruar. Kështu veprohet edhe me dy shkrimet e tjera. Nxënësit dëgjues të grupeve mund të ulen përballë autorit të shkrimit (përfaqësuesit të grupit), me qëllim që komunikimi të jetë me anë të dëgjuarit dhe të shikuarit.

Pasi punimet janë punuar në grup, të drejtën për të dhënë përgjigje duhet ta kenë edhe pjesëtarët e tjerë të grupit prezantues.

Të lexuarit e nxënësve duhet të jetë i qartë dhe i saktë. Me anën e të lexuarit, nxënësi/ja tërheq vëmendjen maksimale të shokëve të klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Mësuesi/ja mund ta lexojë, por mund t'u kërkojë edhe nxënësve që të lexojnë këtë fragment nga teksti letrar "Komandanti i klasës":

"Komandanti i klasës" ishte, në njëfarë mënyre, zëvendësi i mësuesit. Në mungesë të tij, ky nxënës kaq i privilegjuar duhet të kujdesej për shokët, "të piketonte" ata që bënin zhurmë dhe t'i kallëzonte te mësuesi/ja, të kujdesej që tabela e zezë të ishte gjithnjë e fshirë, shtupa që fshinte tabelën të ishte përherë e njomë dhe shkumësi majëmprehtë; gjithashtu, duhet të mblidhte paratë për fletoret, kallamarët, për riparimin e mureve të ciflosura dhe xhamave të thyer.

Pasi ta kenë lexuar fragmentin, nxënësit do të diskutojnë se cila nga detyrat është negative dhe ata kurrësi nuk do të pranonin ta kryenin.

Diskutimi është njëra nga metodat më të përdorura gjatë procesit mësimor. Diskutimi synon t'i përfshijë të gjithë nxënësit në aftësimin e shprehive folëse dhe argumentuese të tyre për çështje të caktuara mësimore. Në këtë njësi duhet të luftohen/kritikohen/diferencohen ambiciet dhe veset negative. Si metodë ka vlera, pasi nxit nxënësit të japin përgjigje të menjëhershme, duke shpalosur aftësinë e nxënësve për gjykimin e ideve dhe krijimin e koncepteve.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 14

Nxënësit do të kenë për detyrë të përshkruajnë portretin moral të Antonit dhe portretin moral të kapitenit ideal/ të suksesshëm të klasës.

Portreti moral i Antonit	Portreti moral i kapitenit ideal/të suksesshëm të klasës

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste reale		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon temën, kompozicionin, subjektin dhe personazhin në një tekst tregimtar e dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Shuarja e humorit			
Fjalët kyçe: shokët/shoqet, letra, lojërat, humori, ëndrrat, dëshirat, kujtimet.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – parashikon një ngjarje me termat paraprakë, duke shtuar edhe shprehje të tjera; – lexon tekstin në mënyrë artistike; – analizon tekstin gjatë leximit.			
Kriteret e suksesit: Shkruan një shkrim të shkurtër për një ngjarje të rëndësishme gjatë fëmijërisë. Komenton pjesën e lexuar duke përdorur qëndrime pozitive dhe negative. Krijon një tekst për pjesën e mësuar, duke gjetur pjesët e ligjëratës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe, letër, shënjes.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikim me terma paraprakë Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: shokët, letra, lojërat, humori, ëndrrat, dëshirat, kujtimet, dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një shkrim të shkurtër me termat paraprakë, ku të përdorin edhe fjalë shtesë për të krijuar një ngjarje të veçantë nga fëmijëria e tyre, si dhe të tregojnë raportet e tyre me shoqërinë si vlerë e rëndësishme tek të gjithë. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës/e prezantojnë shkrimet e veta duke sjellë pjesë të bukura nga fëmijëria e tyre, por edhe ngjarje që ndonjëherë mund të jenë ndier keq.			

Pas prezantimit, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë së re mësimore në tabelë “Shuarja e humorit” dhe shpjegon pjesën para leximit dhe disa njohuri për shkrimtarin Dritëro Agolli.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim artistik /Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja mund të përzgjedhë 3 nxënës, të cilët kanë aftësi në të lexuarin artistik, t’iu ndajë tekstin dhe ta lexojnë para klasës. Pas leximit shpjegohen fjalët e panjohura dhe të gjithë si klasë, me ndihmën e mësuesit/es, punojnë ushtrimin 1/ Kuptojmë tekstin. Pastaj, mësuesi/ja formon 3 grupe nxënësish dhe ndan detyrat.

Grupi I - Analizojmë tekstin/ushtimet 2, 3 dhe 4.

Grupi II - Interpretojmë tekstin/ushtimet 5, 6 dhe 7.

Grupi III - Gjuha e tekstit/ushtimet 8, 9, 10, 11, 12.

Nxënësit pasi të kenë përfunduar detyrat, paraqesin para klasës përgjigjet, mendimet dhe sugjerimet e tyre. Ata mund të bashkëpunojnë dhe të japin mendimin e tyre për përgjigjet e shokëve dhe shoqeve. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.

Pastaj reflektojnë rreth tekstit, detyra 12.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për krijimin e pesëvargëshit. Nxënësit punojnë në grupet e tyre. Për shembull:

Miku

I ri, i vjetër

Luan, ndihmon, kujton

Shoku i zemrës, i fëmijërisë

Kujtim

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 18

Gjeni dy thënie që tregojnë vlerën e shoqërisë së vërtetë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Gjeni fjalët me ngjyrim emocional në vargjet e Naimit: Vashë bukuroshe e bariut, /që vjen me llërë përveshur/Me zemër të dëfryer e me buzëze të qeshur/Me dy shqerrazë ndër duar, të bukura dhe vetë/Në sythin tënd e shoh gazin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II.Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III.Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribues produktiv V.Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI.Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalët me ngjyrim emocional			
Fjalët kyçe: ngjyrim emocional, gjuhë shprehëse–emocionale, ngjyrim emocional pozitiv dhe negativ.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: nxënësi/ja identifikon në fjali ose në një tekst fjalët që përdoren me kuptim të drejtpërdrejtë dhe ato me ngjyrim emocional. Përdor drejt në fjali fjalët, duke u dhënë ngjyrim emocional pozitiv dhe negativ.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i gjuhës shqipe, webfaqe, foto të dokumenteve, shkumësa me ngjyra...			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin. - Letërsi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Diskutim</i> Lexoni fragmentin e dhënë dhe gjej kuptimin e fjalëve me të zeza: <i>Pikërisht në këtë kohë ajo dëgjoi për ilaçin e ri, “Shërimtari”. Porositi menjëherë një arkë të madhe. E provoi vetë dhe iu kënaq zemra. Ishte një lëng që të ndizte flakë, një zjarr i gjallë. Banjat dhe kurat e tjera u ndaluan në çast. Që tani e tutje ajo e lidhi fatin me “Shkrimtarin”.</i>			

I dha Tomit një lugë kafeje dhe priti në ankth efektin. Dhe ja ku më në fund morën fund meraqet e saj, ja ku i ra shpirti në paqe, ja ku u thye indiferenca e djalit. Edhe flakën t'i kishte vënë atij nën vete, nuk do të gjallërohej e nuk do të shkundej më tepër.
sipas Mark Tëain, "Aventurat e Tom Sojerit"

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Mbajtje e strukturuar e shënimeve.

Ngjyrimi emocional i fjalëve është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj që ai komunikon.

Ngjyrimi emocional e gjallëron gjuhën, e bën më shprehëse, më të fuqishme.



Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim -punë në grupe

Ushtrimi 1 fq, 211. Gjeni se cilit kuptim i përgjigjet fjala *derë* në shembujt e mëposhtëm.

- *Ai nuk po gjente dot derën e dhomës.*
- *Atij iu hap dera e madhe e jetës.*
- *Ai ishte njeri pa derë familjare.*
- *Nga cila derë e keni marrë këtë nuse?*

Ushtrimi 2. Gjeni fjalët që kanë më shumë se një kuptim. Kërkoni në fjalor kuptime të tjera të pesë prej fjalëve të fragmentit të mëposhtëm.

Mjerimi punon, punon ditë e natë, Tu i vlue djersa në gjoks edhe në ballë, tue u zhigatun deri në gjunjë në baltë, e prap zorrët nga uja i bëhen palë-palë. Shpërblim qesharak!... Mjerimi është një plagë e pashlyeshme në ballë të njerëzimit, që kalon nëpër shekuj...

Ushtrimi 3. Zbërtheni kuptimin e shprehjeve frazeologjike. Zëvendësoji me një fjalë të vetme. Shpjegoni kuptimin emocional që ato mbartin.

Shembuj:

si kali pa fre – i papërmbajtur
si pulë e lagur – i përulur, me frikë
kockë e lëkurë – i dobët
daulle e shpuar – llafazan-
s'ia ha qeni shkopin – i zgjuar
ve dorë – godas
i kreh bishtin – e përkëdhel, lavdëroj
i mbylli deren – e braktisi etj.

Nxënësit punojnë ushtrimet dhe diskutojnë për to.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalëve dhe me kuptim të drejtpërdrejtë dhe me ngjyrim emocional.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR <i>Shiko Fletore pune, f. 54</i>
Ndërtoni nga dy fjali me secilën nga fjalët: ballë, gjunjë, baltë. Përdorini një herë me kuptim të mirëfilltë dhe një herë me ngjyrim emocional.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/a bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Kërkim në fjalor. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe gjej kuptimet e fjalëve <i>nënë</i> dhe <i>vend</i> . Kujdes! Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.			

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalëve sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve

Fjalët kyçe: kuptim i drejtpërdrejtë, kuptim i figurshëm, përbërësit e kuptimit, shembulli, metaforë gjuhësore, parashtesa me nuanca përkëdhelëse.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon kuptimet e drejtpërdrejta të fjalëve nga kuptimet e figurshme;
- analizon mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve;
- argumenton kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshme nëpërmjet përbërësve të kuptimeve dhe shembujve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, *webfaqe*, libra shkencorë, fjalori, fotografi të dokumenteve, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin, Letërsi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Hapi I. Situata e të nxënit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: DDM, Punë në dyshe

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: të drejtpërdrejta; të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve?	

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të punojnë në plotësimin e rubrikës “Mësova”.

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: të drejtpërdrejta; të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve?	Kuptimet e figurshme të fjalëve mund të krijohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme: 1) nëpërmjet metaforës gjuhësore; 2) nëpërmjet përdorimit të prapashtesave me nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese.

Lexoni tabelën e mëposhtme dhe plotësoni kolonat e fundit.

Prapashtesa	Shembull	Prapashtesa të tjera	Shembull në çdo rast
-zë	zogëzë	-cak	burracak
-th	birth	-aç	gungaç
-aq	ngordhalaq	-anik	thatanik
-ash	balash	-ak	hollak
-ac	përtac	-osh	gjatosh
-ec	grindavec	-ush	gjtush

Nëpërmjet përdorimit të intonacionit të veçantë me nuanca: përbuzjeje, talljeje, shakaje, ironie: *Vërtet! Ashtu?! Posi?! Me gjithë mend?!*

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

1. Zbërtheni kuptimin e drejtpërdrejtë (kuptimi 1) dhe kuptimin e figurshëm (kuptimi 2) të fjalëve në tabelat e mëposhtme. Argumentoni nëpërmjet shembujve se pse kuptimi 2 është kuptimi i figurshëm i kësaj fjale.

Fjala <i>bir</i>	
Kuptimi 1 <i>Djali kundrejt prindërve</i>	Kuptimi 2 <i>Djalë ose burrë në lidhje me vendlindjen ose shtresën e tij shoqërore</i>
Përbërësit e kuptimit 1 a) <i>Njeri i seksit mashkull.</i> b) <i>Njeri me moshë të re.</i> c) <i>Lidhje gjaku me prindërit.</i>	Përbërësit e kuptimit 2 a) <i>Njeri i seksit mashkull.</i> b) <i>Njeri me moshë të thyer a të re pa lidhje gjaku.</i>
Shembull <i>Eja biri i nënës!</i>	Shembull <i>Bir i fshatit tonë.</i>

2. Lexoni poezinë “Rent or Marathonmak” të Fan Nolit dhe gjeni rastet e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e fjalëve me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Formoni fjali me tri nga fjalët që Noli i ka përdorur në kuptim të figurshëm. Lexojini ato, duke përdorur një intonacion të veçantë, në përputhje me kontekstin e fjalisë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Liliputët
Fjalët kyçe: liliput, kocomi, tribuna, xhuxhmaxhuxh.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja: – kupton letërsinë fantastike; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – vlerëson sjelljen e Liliputëve në fragment.
Kriteret e suksesit: Debaton për tekstin e letërsisë fantastike. Analizon ndërtimin e letërsisë fantastike. Reflekton rreth tekstit duke vlerësuar përmasat e Liliputëve dhe guximin e tyre ndaj Guliverit.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Nxënësit nxiten të mendojnë për letërsinë fantastike. Pse fëmijët pëlqejnë rrëfimet dhe filmat fantastikë? Cilat lloje të rrëfimeve karakterizojnë letërsinë fantastike? Cilat elemente i hasim gjithnjë në këtë letërsi? Mendimet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në dërrasën e zezë. Po ashtu, ai/ajo shpjegon se çfarë është letërsia fantastike.
<pre> graph TD A[Letërsia fantastike] --> B[Rrëfimetë historiv me magji] B --> C[Rrëfime ku ndodhin mrekulli] B --> D[Prania e dukurive mbinatyre] C --> E[Udhëtimi] C --> F[Lufta] C --> G[Konflikti] D --> G H[Karakterizohet nga] --- I[Disa nga elementet e saj janë:] </pre>
Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje Para se të fillojë leximi i pjesës, mësuesi/ja shkruan titullin e saj në dërrasën e zezë: “Liliputët”. Pastaj, duke u mbështetur në rubrikën “Para leximit”, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se për çfarë flitet në këtë pjesë, nga është shkëputur fragmenti që do të lexojnë dhe po ashtu, nxënësit marrin njohuri për shkrimtarin Xhonatan Suift. Pasi të përfundojë leximi i pjesës dhe të jenë zbërthyer fjalët e panjohura, nxënësit së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1/Kuptojmë tekstin. Për të punuar ushtrimet e tjera, mësuesi/ja formon në klasë tri grupe nxënësish (me nga 6-8 nxënës):

Grupi I - ushtrimet 2, 3,4 dhe 5 /Analizojmë tekstin.

Grupi II- ushtrimin 6 /Interpretojmë tekstin.


Grupi III- ushtrimet 7 dhe 8/ Reflekojmë rreth tekstit dhe ushtrimet 9 dhe 10/ Gjuha e tekstit.

Pasi të kenë përfunduar ushtrimet, nxënësit paraqesin përgjigjet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura dhe kërkon nga nxënësit që përgjigjet të paraqiten jo vetëm nga përfaqësuesit e grupeve, por edhe nga nxënësit e tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Sipas veprimtarisë “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke punuar ushtrimet 7 dhe 8 të rubrikës/Reflekojmë rreth tekstit.

Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe dhe pastaj klasa pozicionohet në dy grupe. Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve; nxënësit mund të ndryshojnë pozicion nëse argumentet e grupit tjetër u duken më bindëse.



Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Diagnostifikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur Shiko Fletore pune, f. 19

Lexoni pjesën ku Guliveri shkon në ishullin e gjigantëve, në të cilin raportet në përmasa përmbysen. Hulumtoni në internet për informacione shtesë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE OËNDRIMET			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Të rrethuar nga ujqit e kuq
Fjalët kyçe: Aguaras, Talkavi, Glinaveni, Tauka, ujqërit e kuq.
Rezultatet e të nxënësve për orën mësimore
Nxënësi/ja: – përshkruan personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – vlerëson sjelljen dhe vendimet pozitive të personazheve.
Kriteret e suksesit: Debaton për personazhet duke u ndalur në çdonjërin prej tyre. Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa. Çmon e përkrah sjelljen dhe vendimet pozitive të indianit Talkavi.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësuesi/ja mund t’u drejtohet nxënësve me këtë pyetje: <i>Si i kuptoni fjalët “fantazi” dhe “fantastike”, si diçka reale, shumë e bukur, e mirë, që mund të na ndodhë, apo si diçka që ne e imagjinojmë, por nuk mund të ndodhë në të vërtetë?</i> Nxënësit do të japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja apo një nxënës/e shënon në dërrasën e zezë në formën e pemës së mendimeve, sugjerimet dhe mendimet e nxënësve. <i>Keni dëgjuar për Zhyl Vernin?- mund të jetë pyetja e radhës.</i> Para se të fillojë leximi i tekstit, mësuesi/ja, duke u mbështetur në të dhënat e rubrikës para leximit, shpjegon për nxënësit jetën dhe veprimtarinë letrare të Zhyl Vernit dhe tregon se pjesa që do të lexojnë, është shkëputur nga romani “Bijtë e Kapitenit Grant”. Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e pjesës <i>Të rrethuar nga ujqit e kuq</i> . Veprimtaria e të menduarit dhe e të lexuarit të drejtuar nxit nxënësit të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që lexojnë. Mësuesi/ja organizon leximin e pjesës në heshtje nga nxënësit. Leximi do të jetë me ndërprerje. Pas çdo ndërprerjeje, nxënësit do të parashikojnë se çfarë do të ndodhë më pas dhe do të paraqesin para klasës mendimet e tyre. Ndaletat e leximit nuk parashikohen të jenë të tepërta, sepse mund të cenojnë të kuptuarin e përmbajtjes. Pjesa mund të ndahet në tri pjesë: <u>Pjesa e parë</u> mund të ndalet te: <i>“Kishin ngritur pushkët dhe qenë gati të shtinin kundër radhëve të para të aguarsve, kur Talkavi ua mbajti me dorë armët që kishin në sy.”</i> <u>Pjesa e dytë</u> fillon nga: <i>- Ç’kërkon Talkavi?- tha Roberti.” - deri te: (...) Ndaj orës dy të mëngjesit, Talkavi hodhi në zjarr edhe krahun e fundit me lëndë djegëse dhe nuk u mbeteshin më veç edhe pesë të shtëna.(...)”</i> <u>Pjesa e tretë</u> fillon nga: <i>“Befas u dëgjuan kthetrat e tyre të ngulen në dërrasat gjysmë të kalbura.”</i> dhe vazhdon gjer në fund.

Gjatë kohës që lexojnë, nxënësit do të mendojnë, do të parashikojnë dhe do t'i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Mësuesi/ja përgatit më parë pyetjet dhe i paraqet në mënyrë grafike në dërrasën e zezë, me qëllim që nxënësit ta kenë më të lehtë t'i mbajnë shënim parashikimet e tyre.

Ç'mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Pasi të kenë përfunduar të lexuarit e pjesës, në klasë formohen 4 grupe dhe punojnë detyrat:

Grupi I - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1.

Grupi II - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Grupi III - Interpretojmë tekstin/ ushtrimet 9, dhe 10.

Grupi IV - Gjuha e tekstit/ ushtrimi 11.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/Puno në dyshe/Tregoj të tjerëve

Nxënësit do të punojnë në grupe dyshe detyrat 12 dhe 13 të rubrikës “Reflektojmë rreth tekstit”.

Pasi të përfundojnë detyrat, secili grup përfaqësohet me një diskutim, ku prezanton idetë e veta për përgjigjet e dhëna.

Kjo teknikë është mjaft e përshtatshme për të reflektuar rreth pjesës që nxënësit kanë lexuar dhe punuar më parë. I ndihmon ata t'u japin formë mendimeve të tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 20

1. Nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve 7 dhe 8 të rubrikës “Analizojmë tekstin”.

2. Nëse keni lexuar ndonjë roman të Zhyl Vernit, diskutoni me shokët/shoqet rreth subjektit të tij.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon pozitën e shqipes si gjuhë indoevropiane brenda trungut gjenealogjik gjuhësor. Dallon gjuhën standarde nga dialektet dhe zbaton normën gjuhësore në të folur e në të shkruar.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv****II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik****III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm****IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv****V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë****VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):**

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, autobiografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.

II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Njësia mësimore:** Dialektet e gjuhës shqipe**Fjalët kyçe:** dialekt, variant gjuhësor, krahinë, gegërisht, toskërisht, e folme...**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore****Nxënësi/ja:**

- dallon dialektet e gjuhës në tekste të ndryshme;
- përdor dialektet e gjuhës për qëllime të ndryshme;
- përdor dialektet e duhura në një situatë të caktuar;
- gjen elementet përbërëse të dialekteve të dhënë;
- dallon të përbashkëtat e të veçantat mes dialekteve;
- argumenton mbi rëndësinë e përdorimit të dialekteve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 8”, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Me gjeografinë, me Historinë, me Artin figurativ, me Edukimin qytetar.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE: Stuhi mendimesh, Diagrami i Venit, Informacioni kthyes.**

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/a paraqet hartën para nxënësve; kërkohet të gjejnë pjesën veriore dhe pjesën jugore të trojeve shqiptare. Nxënësit shprehin mendimet me njohurit që kanë, disa prej tyre e sqarojnë duke treguar përmes hartës se ku gjenden këto dy pjesë dhe lumin Shkumbin, i cili i ndan dialektet e shqipes, gegërishten dhe toskërishten. Pastaj veçojmë disa krahina dhe të folmet e tyre.

Dialekti është një variant i gjuhës që përdoret nga folës të një treve të kufizuar ose nga folës të një shtrese shoqërore të veçantë. Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: gegërishten dhe toskërishten. Dialektet e shqipes, përveç të përbashkëtave të shumta, kanë edhe dallime.


Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit

Mësimdhënësi/a udhëzon nxënësi të lexojnë informacionin për dialektet e shqipes në libër, pastaj komentojmë njohurit e reja. Kërkohet të lexojnë tekstet e mëposhtme dhe të përcaktojnë se cili prej tyre i përket dialektit të Veriut dhe cili atij të Jugut. Gjeni ndryshimet ndërmjet tyre...

Dialekti gegë përdoret në të djathtë të rrjedhës të lumit Shkumbin. Pra, deri në Vermosh brenda kufijve të Shqipërisë, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në pjesën jugperëndimore të Malit të Zi.

Dialekti toskë përdoret në të majtë të lumit Shkumbin. Pra, deri në Konispol brenda kufijve të Shqipërisë, dhe në të folmet çame në Greqi deri në gjirin e Prevezës.

Nxënësit paraqesin të veçantat dhe të përbashkëtat e dialekteve të shqipes në diagramin e Venit...



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informacioni kthyesë

Ushtrimi numër 1: Shkruani në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme. (f. 214)

Ushtrimi numër 2: Shkruani në gjuhën standarde tekstet e mëposhtme. (f. 214)

Ushtrimi numër 3: Shkruani pesë fjalë të urta në dialektin e zonës suaj. Rishkruajini ato në gjuhën standarde.

Punojnë individualisht pastaj në çifte; këmbëjnë punimet, vlerësojnë punën e bërë, komentohen në grupe, prezantohen në tabelë dhe shkruhen shembujt sipas kërkesës, përgjigjen nxënësit e klasës për ushtrimet 1, 2 qortojnë gabimet me ndihmën e mësimdhënësit/es. Jepet forma e drejt e përdorimit. Diskutohet me klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim motivues me fjalë e shprehje gjatë orës. Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimit të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko “Fletoren e punës”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/a bën vlerësimin e vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përcakton në hartë trevat që përdorin gjuhën standarde shqipe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha standarde (letrare) dhe dialektet			
Fjalët kyçe: gjuhë standarde, shkolla, media e shkruar dhe e folur, trevat ku flitet standardja.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon kufirin fizik ndarës të dy dialekteve; - dallon gjuhën standarde nga dialektet; - argumenton punën e tij/saj për të ruajtur të pastër shqipen standarde.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, uebfaqe, fotografi të dokumenteve, shkurtesa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Pyetja sjell pyetjen</i> Kontrollohen detyrat e shtëpisë. Mësuesi/ja sqaron nxënësit rreth paqartësive që kanë, më pas fillon me shpjegimin e temës së re. Pyetja sjell pyetjen <i>Çfarë kuptoni me gjuhë standarde?</i> <i>Ku flitet gjuha standarde?</i> <i>Nga dallon gjuha standarde nga dialektet?</i> <i>Cili është dokumenti që përfaqëson kodin e përdorimit të gjuhës standarde?</i> <i>Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.</i>			

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT


Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë me vëmendje informacionin e dhënë në tekst dhe më pas të plotësojnë tabelën INSERT.

Njohuritë që i ka marrë më parë	Njohuritë e reja që shtohen këtë orë	Njohuritë që i di, por jo të sakta	Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton
<i>V</i>	+	-----	?

Në qoftë se nxënësit kanë paqartësi, mësuesi-ja i ndihmon.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim-Punë në grupe
Punohen ushtrimet e tekstit

Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes gjuhës standarde dhe dialekteve.

**Ushtrimi 1.** E vërtetë apo e gabuar?

Varianti i gjuhës standarde shqipe përkon me kohën e shkrimit të shqipes.

Gjuha standarde është varianti zyrtar i përdorimit të një gjuhe.

Të gjitha veprat letrare duhet të shkruhen në gjuhë standarde.

Gjuha e letërsisë është më e pasur se varianti standard i gjuhës.

Ushtrimi 2. Shkruani variantin standard të fjalëve të dhëna më poshtë.

çun, cull, gjalë, mec:

lexonja, lexojsha, lexojshë:

duhet me punu, me punua, me punue:

do vij, kam me ardh, kam të vij:

Ushtrimi 3. Në pjesën e mëposhtme, dalloni fjalët që nuk janë shkruar në variantin standard të shqipes.

Pasi mbarojnë punën, nxënësit lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin drejt të gjuhës standarde në raport me dialektet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 56

Hartoni një tekst në gjuhë standarde me temë: “Nëse e mbrojmë planetin, planeti do të na mbrojë.”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Hulumtim nëpër median e shkruar për të gjetur format dhe strukturat gjuhësore që kanë pushtuar gjuhën shqipe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, autobiografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja			
Fjalët kyçe: Gjuha, fjalë shqipe, fjalë e huaj, shtresa...			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore Nxënësi/ja: - diskuton rreth historikut të gjuhës shqipe; - analizon rëndësinë e përdorimit të leksikut të shqipes.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, Emil Lafe, “Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare”.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS

GJATË ORËS MËSIMORE: *Lëviz / ndalo / krijo dyshe, Diskutim, Puno në dyshe*

Hapi I. Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Lëviz/ndalo/krijo dyshe

Nxënësit do të përdorin këtë teknikë në fazën e parë të procesit mësimor. Ata/ato do të dëgjojnë mendimet e njëri/njëra-tjetrit/tjetrës rreth: *Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja, duke veçuar momentet më kryesore të rrugës drejt standardizimit.* Më pas, mendimet e tyre do të shkruhen në tabelë. Mësuesi/ja shpjegon informacionin më poshtë:



Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Ajo ka një fond të pasur fjalësh, i cili quhet leksik. Leksiku i gjuhës shqipe përfshin: a) shtresën vetjake; b) shtresën e huazuar gjuhës shqipe.

Shtresa vetjake përbëhet nga: fjalët e hershme të leksikut të shqipes: çel, dal, darkë, atë, bir, djalë, derr, djalë, drekë, ëndërr, djathë, hudhër, kohë, lopë, mal, mjekër, mot, motër, natë, punë etj.; fjalët e shqipes të prejardhura dhe të përbëra të formuara brenda shqipes: dimërak, dimëror, punëtor, punishte, shtegtar, zemërmirë, përmirësoj etj.; fjalët e shqipes të formuara nga pasthirrat dhe onomatopetë: çuçurit, mermërit, gurgullon, shushurin, taketuke, tringëllin, zukat, belbëzoj, bubullon etj.

Shtresa e huazuar e fjalëve të shqipes përbëhet nga: fjalët e huaja, të cilat kanë zënë vend në leksik për arsye të ndryshme historike, gjeografike, sociale, kulturore dhe gjuhësore. Në gjuhën shqipe, si në gjithë gjuhët e tjera, kanë zënë vend huazime, si: termat ndërkombëtarë: epilepsi, tuberkuloz etj.; fjalët që kanë sjellë nuanca të reja kuptimore: bejtexhi (vjershëtor, jo poet) etj.; fjalët që i ka pranuar një stil i caktuar shkencor, social, mediatic: absolutisht, agrikulturë, eksperiment, realizoj, situatë, urgjencë etj.; fjalët që janë përdorur në fusha të ndryshme profesionale si terminologji e fushës përkatëse: kompjuter, informatikë, internet, e-mail etj.; fjalët që kanë ardhur së bashku me mjetin dhe konceptin e ri: lavastovilje, televizor, tablet, celular etj.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Fjalët e huaja e prishin gjuhën. Nuk duhet të merren e të përdoren fjalë të huaja në gjuhë, kur kemi fjalët tona. Prandaj, duhet bërë kujdes që të përdorim fjalën shqipe në vend të fjalës së huaj, si:

*i përkryer në vend të perfekt
i vrazhdë në vend të brutal
teproj në vend të ekzagjeroj*

*pajtim në vend të abonim
zbatoj në vend të aplikoj
vendimtar në vend të deciziv*

*zotim në vend të angazhim
ngjarje në vend të eveniment
ndjek në vend të frekuentoj*

*thirrje në vend të apel
zemërim në vend të indinjatë
shmang në vend të evitoj*

*miratoj në vend të aprovoj
ngul këmbë në vend të insistoj
përfundim në vend të konkluzion*

Nxënësit i ilustrojnë me shembuj mendimet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1: Në fjalët dyshe të mëposhtme (fjalë e huaj/fjalë shqipe), gjeni fjalë të tjera sinonime të shqipes, me anën e të cilave ato mund të zëvendësohen. novitet (risi) _____, sensibilitet (ndjeshmëri) _____, aparençë (dukje, pamje e jashtme) _____, monitoroj (vëzhgoj) _____, monitorim (vëzhgim) _____, interlokutor (bashkëbisedues) _____, evokoj (sjell në mend) _____.

Ushtrimi 2: Lexoni një faqe gazete dhe nënvizoni fjalët e huazuara të nevojshme, por edhe ato të panevojshme.

Ushtrimi 3: Shkruani një ese me titull “Qyteti i gabimeve të mëdha”, në të cilën të dalë i qartë keqpërdorimi i fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe.

Ushtrimi 4: Merrni një faqe gazete dhe zëvendësoni fjalët e huaja të panevojshme me fjalët përkatëse shqipe.

Punohet individualisht, pastaj në çifte këmbëjnë punimet, vlerësojnë punën e bërë, komentohen në grupe, prezentohen në tabelë dhe shkruhen shembujt sipas kërkesës, përgjigjen nxënësit e klasës për ushtrimet 1, 2, 3, 4 qortojnë gabimet me ndihmën e mësimitdhënësit/ës. Jepet forma e drejt e përdorimit. Diskutohet me klasën.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për punën hulumtuese, për kthimin e teksteve në shqipen standarde etj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 5: Bëni një projekt, ku të nxirrni në pah fjalë të shkruara gabim në emërtimin e dyqaneve, në titujt e emisioneve televizive, në gazeta dhe kudo që shikoni përdorim të fjalës së huaj në vend të fjalës shqipe. f. 218.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - hulumton në median e shkruar, për të gjetur format dhe strukturat gjuhësore që kanë pushtuar gjuhën shqipe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT Nxënësi/ja: - debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme; - pasuron fjalorin; - zhvillon forma të veçanta të shkrimit: ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj.; - zbaton rregulla gjuhësore dhe drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit; - zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe për të tjerët; - shkruan për tema të caktuara; - përdor rregullat e shfaqjes; planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj) për paraqitjen në media. II. VLERAT DHE QËNDRIMET Nxënësi/ja: - komunikon mirë; - merr pjesë në diskutim, bashkëpunon; - respekton mendimin e të tjerëve; - zhvillon personalitetin dhe humanitetin; - motivohet për zhvillimin e shkathtësive; - zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve; - përdor teknologjinë e informacionit; - dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - kritikon duke u mbështetur mbi argumente; - kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin ku jeton. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë së informacionit. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën
Fjalët kyçe: fjalë e huaj, gjegjëse shqipe, huazime.
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - gjen gjegjëset e shqipes për fjalët e huaja; - analizon thëniet dhe vlerësimet e njerëzve të shquar për gjuhën shqipe; - diskuton rreth formave dhe strukturave të huaja që po pushtojnë gjuhën shqipe.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, uebfaqe, fotografi të dokumenteve, shkumësa me ngjyra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Bashkëbisedim</i> Kohët e fundit kanë filluar të përdoren fjalët: turist, xhins, emigrim, supermarket, eko, transistor, hamburger, suflaqe. Me cilat fusha leksikore lidhen këto fjalë? <i>Diskutojmë së bashku</i> Gjatë shekujve, të parët tanë kanë mbajtur fustanella, shallvare, xhubleta, rubë, rizë. Cili është ndryshimi i këtyre fjalëve me fjalët pantallona, fustan dhe shami koke? Për të diskutuar më mirë kuptimin e fjalëve, përdorni “<i>Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe</i>”. Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Të nxënit në bashkëpunim-Punë me grupe</i> Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet e të lexojnë thëniet dhe vlerësimet e njerëzve të shquar për gjuhën shqipe. <i>Ndahet klasa në grupe dhe secili grup do të japë gjykime e vlerësime rreth thënies përkatëse.</i> Grupi 1: “<i>Fjala e huaj në gjuhë, është si dhia ndër dhen.</i>” - Naim Frashëri Grupi 2: “<i>Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet.</i>” - Filip Shiroka Grupi 3: “<i>Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij.</i>” - Eqrem Çabej Grupi 4: “<i>Gjuha shqipe është një pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe.</i>” - Gjergj Fishta Grupi 5: “<i>Gjuha ruhet atje ku shkruhet.</i>” - Populli Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: <i>Diskutim</i> <i>Me të verdha janë përgjigjet e sakta.</i> A duhet të pajohemi me huazimet? Si duhet: guglloje apo kërkoje; sejvoje apo ruaje; sendoje apo dërgoje; suportoje apo mbështete; dominonte apo mbizotëronte; selektoj apo përzgjedh? Gjeni shembuj të tjerë dhe nxirrni përfundime. Përfundimi: Në rast se fjala e huaj e ka gjegjësen shqipe, duhet ta përdorim atë dhe të mos lejojmë përdorimin e fjalëve të huaja.

Bëni një listë me fjalë dhe shprehje të sotme që dëmtojnë gjuhën. Vendosini në tabelë.

Fjalë të huaja	Shprehje të huaja	Shkurtime pa vend
Ekzagjeroj	Flet me aksent	Flm-faleminderit
Seleksionoj	Kam dalë për shopping	Sms-mesazh
Dimension	Është plot sharm	Sps-sepse
Ambient	Është online	Klb-kalofsh bukur
Epruvetë	Është vend vakant	Hi-përshëndetje

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për analizën dhe vlerësimin e thëniesve të njerëzve të shquar për gjuhën shqipe, për përdorimit drejt të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja etj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Teknologjitë e reja kanë sjellë përdorimin gjithnjë e më të madh të fjalëve dhe të shprehjeve të shkurtuara ose të huazuara. Diskutoni rreth këtij realiteti gjuhësor, duke sjellë shembuj dhe raste të ndryshme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - hulumton në median e shkruar, për të gjetur format dhe strukturat gjuhësore që kanë pushtuar gjuhën shqipe.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën
Fjalët kyçe: fjalë e huaj, gjegjëse shqipe, huazime.
Rezultatet e të nxënës për orë mësimore: Nxënësi/ja: - gjen gjegjëset e shqipes për fjalët e huaja; - analizon thëniet dhe vlerësimet e njerëzve të shquar për gjuhën shqipe; - diskuton rreth formave dhe strukturave të huaja që po pushtojnë gjuhën shqipe.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, uebfaqe, fotografi të dokumenteve, shkumësa me ngjyra.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin. - Letërsi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Hapi I. Situata e të nxënës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Bashkëbisedim</i> Kohët e fundit kanë filluar të përdoren fjalët: turist, xhins, emigrim, supermarket, eko, transistor, hamburger, suflaqe. Me cilat fusha leksikore lidhen këto fjalë? <i>Diskutojmë së bashku</i> Gjatë shekujve të parët tanë kanë mbajtur fustanella, shallvare, xhubleta, rubë, rizë. Cili është ndryshimi i këtyre fjalëve me fjalët: pantallona, fustan dhe shami koke? Për të diskutuar më mirë kuptimin e fjalëve, përdorni “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënës në bashkëpunim-punë me grupe. Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të lexojnë thëniet dhe vlerësimet e njerëzve të shquar për gjuhën shqipe. <i>Ndahet klasa në grupe dhe secili grup do të japë gjykime e vlerësime rreth thënies.</i> Grupi 1: “Fjala e huaj në gjuhë, është si dhia ndër dhen” - Naim Frashëri Grupi 2: “Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet.” - Filip Shiroka Grupi 3: “Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij.” - Eqrem Çabej Grupi 4: “Gjuha shqipe është një pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen me të klasikët e çdo kombi ,e çdo kohe.” - Gjergj Fishta Grupi 5: “Gjuha ruhet atje ku shkruhet.” - Populli Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim Me të verdha janë përgjigjet e sakta. A duhet të pajohemi me huazimet? Si duhet: guglloje apo kërkoje; sejvoje apo ruaje; sendoje apo nise; suportoje apo mbështete; dominonte apo mbizotëronte; selektoj apo përzgjedh? Gjeneri shembuj të tjerë dhe nxirrni përfundime. Përfundimi: Në rast se fjala e huaj e ka gjegjësen shqipe, duhet ta përdorim atë dhe të mos lejojmë përdorimin e fjalëve të huaja.

Bëni një listë me fjalë dhe shprehje të sotme, që e dëmtojnë gjuhën shqipe. Vendosini në tabelë.

Fjalë të huaja	Shprehje të huaja	Shkurtime pa vend
Ekzagjeroj	Flet me aksent.	Flm - Faleminderit
Seleksionoj	Kam dalë për shopping.	Sms - mesazh
Dimension	Është plot sharm.	Sps - sepse
Ambient	Është online	Klb - Kalofsh bukur!
Epruvetë	Është vend vakant	Hi! –Përshëndetje!

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për analizën dhe vlerësimin e thënieve të njerëzve të shquar për gjuhën shqipe, për përdorimin drejt të fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja etj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Teknologjitë e reja kanë sjellë përdorimin gjithnjë e më të madh të fjalëve dhe të shprehjeve të shkurtuara ose të huazuara. Diskutoni rreth këtij realiteti gjuhësor, duke sjellë shembuj dhe raste të ndryshme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv 1, 2, 4, 5, 6, 7. II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik 1, 2, 3, 6, 7, 8. III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm 1, 3, 5, 6. VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Përleshja e kryetrimimit me kryepiratin
Fjalët kyçe: Shpella e piratëve, Gjonbaba, Rusman El Namsuri, piratët.
Rezultatet e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: – dallon personazhet dhe rolin e tyre në rrëfim; – zbulon elementet fantastike në rrëfim; – jep mendimin e tij/saj për gjuhën e vjetër shqipe që has në tekst, dhe rolin që kishte deti për njerëzit që jetonin pranë tij, apo për ata që udhëtonin me anije. Kriteret e suksesit: Klasifikon personazhet dhe detyrat e tyre në rrëfim. Ilustron elementet fantastike të rrëfimit. Kupton/zbërthen fjalët e gjuhës së vjetër shqipe dhe vështirësitë me të cilat ballafaqoheshin njerëzit që jetonin afër detit, sidomos rreziqet nga piratët.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Imagjinata e drejtuar Nxënësit nxiten të mendojnë mbi çështjen: <i>- Keni dëgjuar për shpellat afër detit? Po për piratët? Ndoshta keni lexuar ndonjë roman apo keni parë edhe filma për piratët?</i> Nxënësit fillojnë të thurin mendimet e tyre duke fantazuar dhe kujtuar se: <i>Piratët janë grabitqarë. Ata udhëtojnë me anije dhe thesaret që plaçkitin, i fshehin nëpër shpella.</i> Sipas fantazisë, nxënësit sjellin versionin e tyre. Mësuesi/ja dëgjon rrëfimet e tyre me vëmendje dhe përpaket të ndalet në konceptet që fëmijët sjellin për tregimin fantastik. Një nxënës/e, me ndihmën e mësuesit/es, shkruan në dërrasën e zezë: <i>Tregimi fantastik është ai lloj i tregimit, i cili i vendos ngjarjet në hapësira të ndryshme kohore, në të kaluarën, në të ardhmen e largët... Është rrëfim, në të cilin mbizotërojnë e pamundshmja dhe imagjinaria.</i>
Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e pjesës “Gjonbaba dhe Rusman El Namsuri”. Duke u mbështetur në rubrikën para leximit dhe të dhënat për autorin, u shpjegon nxënësve: Pjesa që do të lexojmë, është shkëputur nga romani “Shpella e piratëve”, i shkrimtarit Petro Marko. Lexohet pjesa, zbërthehen fjalët e panjohura, ndihmohen nxënësit të kuptojnë fjalët e shkruara në gjuhën e vjetër shqipe, dhe të gjithë së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1/Studim teksti. Më pas, mësuesi/ja formon 4 grupe nxënësish dhe punojnë ushtrimet: Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2 dhe 3. Grupi II - Analizojmë tekstin, ushtrimin 4; Interpretojmë tekstin, ushtrimin 5. Grupi III - Interpretojmë tekstin, ushtrimin 6; Gjuha e tekstit, ushtrimin 7. Grupi IV - Gjuha e tekstit, ushtrimet 8 dhe 9. Përfaqësuesit e grupeve paraqesin përgjigjet para klasës. Nxënësit mund të shkëmbejnë mendimet dhe sugjerimet e tyre për përgjigjet e dhëna nga shokët/shoqet e klasës. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim Të gjithë si klasë do të punojnë ushtrimin 10/ Reflektojmë rreth tekstit. Diskutimi është metodë, e cila ndërtohet mbi bazën e dialogut pyetje-përgjigje. Është një shkëmbim pikëpamjesh nxënës-nxënës, mësues-nxënës. Është metodë e rëndësishme, pasi përfshin të gjithë nxënësit në diskutim duke zhvilluar aftësitë e tyre shprehëse/folëse dhe argumentuese.	
Vlerësimi i nxënësve Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Vlerësim diagnostikues dhe formues.	
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 21</i> 1. Nxënësit do të kenë detyrë të kthejnë në shqipen standarde të gjitha fjalët, të cilat në pjesë janë të shkruara në shqipen e vjetër. 2. Nëse keni lexuar libra të tjerë apo keni parë ndonjë film, në të cilin rrëfihen histori me piratë, diskutoni në klasë rreth subjektit të tyre.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Nëndhesja
Fjalët kyçe: lakuriqi i natës, veshët, sytë, nëndhesja.
Rezultatet e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: – dallon elementet fantastike në tekst; – analizon temën kryesore në fragment duke gjykuar në fantazinë e krijuar; – diskuton rreth prozës fantastiko-shkencore. Kriteret e suksesit: Rikujton tregimin fantastiko-shkencor. Vlerëson qëllimin e temës në tregimin fantastiko-shkencor. Ndërton një tekst fantastiko-shkencor sipas modelit të “Nëndheses”, duke u mbështetur në patentat e gjalla të natyrës.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë pjesë të orës mësimore, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: <i>Si mendoni, nga frymëzohen dhe i marrin modelet shkencëtarët për të ndërtuar pajisje teknike, mjete udhëtimi, robotë?</i> Nxënësit diskutojnë në dyshë dhe përgjigjen duke paraqitur mendimet dhe sugjerimet e tyre. Për shembull, nga natyra, çdo gjë që njerëzit kanë arritur të shpikin, modelet i kanë marrë prej saj. Duke studiuar trurin e njeriut, kanë ndërtuar kompjuterët dhe celularët; duke studiuar lëvizjet e kafshëve dhe shpezëve, kanë ndërtuar mjetet e udhëtimit. Pas diskutimeve, mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e njësisë mësimore “Nëndhesja” dhe u shpjegon nxënësve: <i>“Njerëzit gjithmonë janë përpjekur të ndërtojnë pajisje, nëpërmjet të cilave plotësojnë disa nga dëshirat apo pasionet e tyre, p.sh.: të udhëtojnë nën tokë, të zhyten në ujë, në thellësi të mëdha, të fluturojnë në hapësirë etj. Për ndërtimin e këtyre pajisjeve, shkencëtarët bëjnë studime të panumërta mbi natyrën, objektet, kafshët. Shpesh, ata shfrytëzojnë aftësitë e veçanta të kafshëve për t’i përdorur në shpikjet apo zbulimet e tyre shkencore. Në këtë tekst flitet për një nëndhesë, e cila është ndërtuar në bazë të mënyrës se si orientohet një lakuriq nate në errësirë.”</i> Gjithashtu, nxënësit njihen edhe me veprat letrare e artistike të autorit Astrit Bishqemi.
Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një/Marrëdhënia pyetje-përgjigje Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe i udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën në heshtje. Pas leximit, secili grup do të prezantojë njësinë sipas detyrës së udhëzuar. Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve të tjerë. Një nxënës/e prezanton grupin (p.sh.: nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurta, sepse të gjithë e kanë lexuar). Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, për shembull, ku mundën të gjejnë material shpesh dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të obligojë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive e negative, duke përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimet përkatëse. Pas prezantimit dhe debateve, nxënësit së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1/Kuptojmë tekstin dhe pastaj udhëzohen që në grupet e njëjta të punojnë ushtrimet e përcaktuara nga mësuesi/ja.

Grupi I - Analizojmë tekstin/ushtimet 2, 3, 4, dhe 5.

Grupi II - Interpretuojmë tekstin/ushtimet 6,7 dhe 8.

Grupi III - Gjuha e tekstit/ ushtimet 9 dhe 10.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutimi

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të reflektojnë rreth tekstit, duke veçuar pjesët ku flitet për shembujt bindës se përse lakuriqi i natës orientohet në bazë të tingujve, pra “shikon me vesh e jo me sy”.

Ashtu siç është projektuar edhe nëndhesja, për të mos u rrëzuar në hone.

Nxënësit udhëzohen të reflektojnë dhe diskutojnë për provat bindëse ku tregohen vetitë e lakuriqëve të natës.

“– Megjithëse është një kafshë e natës, sytë e saj janë pak të zhvilluar, madje nuk i hyjnë fare në punë. Edhe kur shkencëtarët ia mbyllën me leukoplast, fluturoi për bukuri në dhomën e mbushur tërë pengesa, pa u përplasur asgjekund. Veç nuk ndodhi kështu kur ia shtuposën veshët me dyllë.

Doli pra, që lakuriqi i natës shikonte jo me sy, por... me veshë.

PROVA I

Nga këto që po dëgjoja, çakërrita sytë. Sa interesante! Lakuriqi na shikuaka me veshë! Mos nuk e kisha dëgjuar mirë? Hajde, po deshe e mbaje mendjen te pleshtat kur shpjegon mësuesja e zoologjisë!

– Ja edhe një eksperiment tjetër! – vazhdoi Partini. – I ngjeshën në kokë lakuriqit një kësulë letre dhe e lëshuan në pyllin e dendur, përfundimi qe tragjik: kafsha u përplas në një dru dhe ra pa frymë përtokë. Por, kur hapën në kësulë tri vrima, një te goja e dy te veshët, fluturoi si mos më mirë, pa u përplasur jo më në trungje, por as në degët e holla.

PROVA II

– E ç’del nga kjo?

- Del që në orientimin e lakuriqit lozin rol organet e zërit dhe të dëgjimit. Pra, gjatë fluturimit, lakuriqi lëshon me gojë disa tinguj të veçantë. Këto shkojnë përpara, përplasen në pengesa dhe kthehen me shpejtësi te veshi i kafshës. Ajo merr dijeni mbi largësinë e sendit dhe, po të jetë nevoja, ndryshon drejtimin që të mos përplasen me të.

– Të lumtë! – tha komandant Ylli, sikur të kishte vlerësuar si mësuesit e qemotit “ulu në vend, dhjetë!” – Pikërisht këtë çudi shfrytëzon nëndhesja jonë për të mos u rrëzuar në hone.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 22

Nxënësit do të gjejnë një prozë tjetër fantastiko-shkencore, do të diskutojnë në klasë dhe do të shkruajnë se nga janë frymëzuar autorët për të krijuar elementet e prozës fantastiko-shkencore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Një mik i paharruar			
Fjalët kyçe: astronomi, asteroidet, fëmijët, shifrat, Princi i vogël.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – shpjegon elementet fantastike të pjesës; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – vlerëson sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmarrin fëmijët.			
Kriteret e suksesit: Kupton mesazhin pozitiv të pjesës, i cili shpjegohet përmes elementeve fantastike. Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa. Vlerëson rëndësinë e shokëve/shoqeve në jetë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësuesi/ja mund të fillojë orën duke pyetur nxënësit: Si mendoni, çfarë u pëlqen të rriturve sot, gjërat që kanë vlerë me të vërtetë, apo numrat dhe shifrat (kostoja e gjërave/çmimi)? Dhe para se nxënësit të japin mendimet e tyre, mësuesi/ja mund të lexojë këtë fragment të pjesës “Një mik i paharruar”: “Kur ne u flasim atyre për ndonjë shok të ri, ata nuk na pyesin kurrë: “Si e ka zërin? Cilat lodra i pëlqejnë më shumë? A koleksionon flutura?”. Përkundrazi, ata na pyesin: “Sa vjeç është? A ka vëllezër e motra? Sa peshon? Sa para fiton babai i tij?”.			

Pandehin se vetëm kështu mund ta njohin më mirë. Sikur ne t'u themi të rriturve: "Kam parë një shtëpi të bukur me tulla të kuqe, me lule kacavjerrëse në dritare dhe me pëllumba mbi çati", ata nuk e përfytyrojnë dot se si mund të jetë kjo shtëpi. Sepse, duhet t'u themi: "Pashë një shtëpi që kushton njëqindmijë franga!". Atëherë, ata zënë e thërrasin: "Ua, sa e bukur qenka!"

Nxënësit fillojnë të përgjigjen dhe të shprehin mendimet e tyre. Mësuesi/ja mban shënim në dërrasë të zezë në formën e pemës së mendimeve sugjerimet dhe përgjigjet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Lexohet pjesa "Një mik i paharruar", zbërthehen fjalët e panjohura dhe nxënësit së bashku me mësuesin/en u përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1/Kuptojmë tekstin.

Pastaj në klasë formohen 3 grupe nxënësish (me nga 7-8 nxënës) dhe punojnë ushtrimet:

Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2,3,4 dhe 5.

Grupi II - Interpretojmë tekstin, ushtrimet 6,7,8, dhe 9.

Grupi III - Gjuha e tekstit, ushtrimet 10 dhe 11.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit dhe bën ndërhyrjet e duhura.

Për shembull, tek ushtrimi 5/Analizojmë tekstin, nxënësit mund të udhëzohen të ndërtojnë një tabelë, ku të paraqesin cilësitë e princit të vogël.

Cilësitë fizike të Princit të vogël	Cilësitë shpirtërore të Princit të vogël
Në njërin, princi duket shumë i gjatë . Në një tjetër duket shumë i shkurtër .	Ishte i mrekullueshëm . Qeshte . Donte një dele .

Ushtrimi 10/Gjuha e tekstit:

Në listën e mëposhtme të fjalëve zgjidhni atë që ka kuptim të përafërt me fjalën e nënvizuar dhe shkruajeni në krah të saj. Pesë fjalë janë të tepërta.

Te dhëna, jehonë, inat, detaje, flijohen, dukej, zemërtarë, buçime, mbarojnë, shpirtgjerë, zemërim.

Ky astronom shpalli zbulimin e tij me bujë të madhe përpara një kongresi ndërkombëtar të astronomisë.	Nuk duhet t'u mbajmë inat .
Tregova kaq shumë hollësi rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që vdesin për shifra.	Tregova kaq shumë detaje rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që vdesin për shifra.
Tregova kaq shumë hollësi rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që vdesin për shifra.	Tregova kaq shumë hollësi rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që mbarojnë për shifra.
Nuk duhet t'u mbajmë mëri .	Nuk duhet t'u mbajmë inat .
Fëmijët duhet të jenë mjaft zemërgjerë me të rriturit.	Fëmijët duhet të jenë mjaft shpirtgjerë me të rriturit.
Për ata që e kuptojnë jetën, kjo do të tingëllonte shumë më e vërtetë.	Për ata që e kuptojnë jetën, kjo do të dukej shumë më e vërtetë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Në këtë fazë, nxënësit do të punojnë ushtrimet 12 dhe 13/Reflektojmë rreth tekstit.

- Shpjegoni si e kuptoni thënien “Jo të gjithë mund të kenë miq”. Sa të rëndësishëm janë shokët dhe miqtë në jetën tuaj?

- Rrëfimtari në pjesën që lexuam, shprehet se po e përshkruan mikun e tij, princin e vogël, që të mos e harrojë. Po ju, a i shkruani gjërat që janë të rëndësishme, për të mos i harruar.

Po

Jo

Pse?

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 23

Shkruani një ese krahasuese me titull “Bota në sytë e fëmijëve dhe të rriturve”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare:

Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë dhe

letërsi shqipe

Shkalla e kurrikulës:

IV

Klasa: VIII

Tema: Tekste fantastike

Rezultati i të nxënit të temës:

Nxënësi/ja:

- dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Borfor- Provat e Askanos (ora e parë)

Fjalët kyçe: Bordjogani, mjeti fluturues, ikeasit, Dardali, Arkneri, Zafiri.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

– dallon personazhet dhe rolin e tyre në rrëfim;

- zbulon elementet fantastike në rrëfim;
- jep mendimin e tij/saj duke mbajtur qëndrim se një udhëtim i tillë mund të ndodhë vërtet në të ardhmen.

Kriteret e suksesit:

Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa.

Ilustron elementet fantastike të rrëfimit.

Shkruan një tregim imagjinar për një udhëtim fantastik, por të mundshëm në një të ardhme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikimi me terma paraprakë

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë disa fjalë: *planeti i largët, anije kozmike, jashtëtokësorë, fëmijë, udhëtim,....*dhe kërkon nga nxënësit të thurin fjali duke u mbështetur në termat e shënuar. Nxënësit thurin sipas imagjinatës së tyre fjali të ndryshme. Pasi paraqiten fjalitë para klasës, mësuesi/ja mund të mbajë shënim disa prej tyre në dërrasën e zezë.

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/ Studim teksti

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e pjesës “Borfor - Provat e Askanos”.

Duke u mbështetur në rubrikën “Para leximit”, u shpjegon nxënësve se për çfarë bëhet fjalë në pjesën që do të lexojnë, nga është shkëputur dhe cili është autori.

Leximi i pjesës organizohet sipas veprimtarisë *Të menduarit dhe të lexuarit e drejtuar*.

Mësuesi/ja organizon leximin e pjesës në heshtje. Leximi do të jetë me ndërprerje. Pas çdo ndërprerjeje, nxënësit do të parashikojnë se çfarë do të ndodhë më pas dhe do të paraqesin para klasës mendimet e tyre. Ndaletat e leximit nuk parashikohen të jenë të tepërta, sepse mund të cenojnë të kuptuarin e përmbajtjes.

Teksti mund të ndahet në 4 pjesë:

Pjesa e parë mund të ndalet te: *Mbasi e shkëputi vëmendjen nga fotografitë e mureve, Dardali i hodhi një sy vendit ku gjendej.*

Pjesa e dytë fillon nga: *“I gjithë mjeti fluturues ishte i ndarë në tri dhoma të veçanta, ku secila dhomë mund të nxinte afërsisht njëzet nxënës.”*

Pjesa e tretë fillon nga: *“Zafiri u përpoq të qeshte teksa shihte fytyrën e tmerruar të Dardalit, i cili nuk fliste dot, por edhe ai nuk mundi të bënte asnjë ndryshim në mimikën e fytyrës”.*

Pjesa e katërt fillon nga: *“Të gjithë fëmijët u pushtuan sërish nga emocionet, pasi çasti i shumëpritur kishte ardhur.”* dhe vazhdon deri në fund të pjesës.

Gjatë kohës që lexojnë, nxënësit do të mendojnë, do të parashikojnë dhe do t’i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Mësuesi/ja përgatit më parë pyetjet dhe i paraqet në mënyrë grafike në dërrasën e zezë, me qëllim që nxënësit ta kenë më të lehtë t’i mbajnë shënim parashikimet e tyre.

Ç’mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Pasi të kenë përfunduar të lexuarit dhe parashikimet, nxënësit së bashku me mësuesin/en zbërthejnë fjalët e panjohura dhe punojnë ushtrimin 1/Kuptojmë tekstin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Në klasë formohen 4 grupe nxënësish dhe punojnë ushtrimet:

Grupi I: ushtrimet 2 dhe 3 /Analizojmë tekstin.

Grupi II: ushtrimin 4 /Analizojmë tekstin dhe ushtrimin 5/ Interpretojmë tekstin.

Grupi III: ushtrimet 6 dhe 7/ Interpretojmë tekstin.

Grupi IV: ushtrimet 8 dhe 9/ Gjuha e tekstit.

Përgjigjet e nxënësve paraqiten para klasës nga përfaqësuesit e grupeve. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.

Për shembull, tek ushtrimi 8/ Gjuha e tekstit: Në thëniet e mëposhtme zëvendësoni me një sinonim fjalën/fjalët me të pjerrëta dhe thoni cilës pjesë të ligjëratës i përket ajo (emër, folje, mbiemër, ndajfolje etj.).

Një shpërthim <i>tmerrësisht</i> i fortë	shumë/tepër	ndajfolje
<i>Dimension</i> tjetër	hapësirë...	emër
Përmasa <i>gjigante</i>	të mëdha/kolosale	mbiemër
Kishte <i>ngelur</i> i habitur	mbetur	
<i>Pavarësisht</i> se i dukej		
Dardali <i>u hutua</i>	u habit	

Ushtrimi 9/ Gjuha e tekstit:Fjalët *ikeas* dhe *mertef* janë të imagjinuara.me *ikeas*, autori ka emëruar **banorët** e planetit fantastik,.....*mertef* është **metali nga i cili përbëhet koloseumi fantastik...**

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 24

Formohen 4 grupe nxënësish (me nga 5-7 nxënës) dhe do të kenë detyrë të shkruajnë sipas imagjinatës vijimin e ngjarjeve në prozën e mësipërme.

Kjo detyrë do të prezantohet në orën e dytë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënësve të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Borfor- Provat e Askanos (ora e dytë)
Fjalët kyçe: Bordjogani, mjeti fluturues, ikeasit, Dardali, Arkneri, Zafiri.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – dallon personazhet dhe rolin e tyre në rrëfim; – zbulon elementet fantastike në rrëfim; – jep mendimin e tij/saj duke theksuar se një udhëtim i tillë mund të ndodhë vërtet në të ardhmen.
Kriteret e suksesit: Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa. Ilustron elementet fantastike të rrëfimit. Shkruan një tregim imagjinar për një udhëtim fantastik, por të mundshëm në një të ardhme.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/Reflektim rreth tekstit Mësuesi/ja fillon orën duke u rikujtuar nxënësve pjesën “Borfor - Provat e Askanos”. <i>Në këtë pjesë, personazhet kryesore janë fëmijë, po të rritur, a ka? Cilët janë ata? Po për të afërmit dhe prindërit e fëmijëve, a na tregohet gjë në këtë fragment? Si mendoni ju, ku gjenden ata?</i> Nxënësit fillojnë të përgjigjen. Mësuesi/ja, me ndihmën e tyre, mund të hedhë në dërrasën e zezë përgjigjet dhe sugjerimet e nxënësve në formën e pemës së mendimeve.
Ndërtimi i njohurive të reja: Karrigia e autorit Mësuesi/ja kërkon nga përfaqësuesit e grupeve që të lexojnë punimet e tyre me shkrim, të cilat nxënësit i kanë përgatitur sipas udhëzimeve të kërkuara në orën e parë. Përfaqësuesi i grupit, i cili luan edhe rolin e autorit, ulet në karrigen e autorit dhe lexon punimin. Shokët e grupit mund të pozicionohen prapa ose aty afër. Të gjithë nxënësit thellohen në reflektimin e ideve dhe argumenteve që lexojnë. Pasi lexohet pjesa, nxënësit e tri grupeve të tjera mund të bëjnë pyetje në lidhje me pjesën e shkruar. Kështu veprohet edhe me tri shkrimet e tjera. Nxënësit dëgjues të grupeve mund të ulen përballë autorit të shkrimit (përfaqësuesit të grupit), me qëllim që komunikimi të bëhet me anë të dëgjuarit dhe të shikuarit.

Pasi punimet janë punuar në grupe, të drejtën për të dhënë përgjigje duhet ta kenë edhe pjesëtarët e tjerë të grupit prezantues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja mund të mbështetet te pyetja e ushtrimit 11/ Reflektojmë rreth tekstit: Bashkëbisedoni për zbulimet e planetëve të tjerë. Si mendoni, a ka jetë në këta planetë?

Klasa pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre: po, ka jetë në planetët e tjerë / jo, nuk ka jetë në planetët e tjerë. Nxënësit paraqesin argumentet e tyre para klasës. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve. Gjatë kohës që dy grupet i raportojnë ato, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe t'i bashkohen grupit që ka arsyet më bindëse.

Po	Pse?	Jo
----	------	----

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 24

Lexoni një roman fantastiko-shkencor dhe tregojani shokut/shoqes së bankës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/ Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Roboti që donte të flinte			

Fjalët kyçe: Katerinoja, numërimi i deleve, gjumi.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- kupton tregimin fantastik;
- dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës;
- kupton rëndësinë e gjumit si proces i rëndësishëm për njerëzit.

Kriteret e suksesit:

Përshkruan personazhin e Katerinos dhe sjelljet e tij.

Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa.

Argumenton rëndësinë e gjumit për qeniet njerëzore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Keni dëgjuar për robotët? A e dini se çfarë janë në gjendje të bëjnë ata? Përse i ndërtuan njerëzit robotët?*

Nxënësit fillojnë të thurin mendimet dhe arsyet se përse njerëzit kanë krijuar robotët.

Mendimet e tyre mbahen shënim në dërrasën e zezë.

Pasi të kenë kuptuar rëndësinë dhe qëllimin e ndërtimit të robotëve, mësuesi/ja duke u mbështetur në rubrikën para leximit, shpjegon për nxënësit se pjesa që do të punojnë, flet për robotin Katerino, i cili i kishte zili njerëzit, sepse ata mund të flinin, ndërsa robotët jo. Katerinoja mësoi të flinte, ashtu si njerëzit. Nxënësit marrin informacione edhe për shkrimtarin Xhani Rodari (1953-1980).

Ngjarja që do të lexojnë, ndodh në vitin 2222.

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA

Të lexuarit e drejtuar është një veprimtari, e cila ndihmon në zhvillimin e imagjinatës dhe thurjes së ideve të reja. Duke u nxitur që të mendojnë dhe të parashikojnë rreth asaj që kanë lexuar, nxënësit zhvillojnë të menduarin kritik. Parashikimet e tyre i mbajnë shënim dhe pastaj i paraqesin para shokëve.

Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë titullin e pjesës: “Roboti që donte të flinte”.

Leximi i pjesës organizohet sipas veprimtarisë: Të menduarit dhe të lexuarit e drejtuar.

Mësuesi/ja organizon leximin e pjesës në heshtje. Leximi do të jetë me ndërprerje. Pas çdo ndërprerjeje, nxënësit do të parashikojnë se çfarë do të ndodhë më pas dhe do të paraqesin para klasës mendimet e tyre. Ndaletat e leximit nuk parashikohen të jenë të tepërta, sepse mund të cenojnë të kuptuarin e përmbajtjes.

Pjesa mund të ndahet në 3 fragmente:

Fragmenti i parë mund të ndalet te: *Gjë prej gjëje nuk shihet që ta bënte të buzëqeshte ashtu siç buzëqeshte Luçila. Shihet vetëm një terr të zbrazët, të thellë e acarues.*

Fragmenti i dytë fillon nga: *Nata kaloi me këto përpjekje të kota. Megjithatë, tek po shkonte të zgjonte profesorin me filxhanin e zakonshëm të kafesë në dorë, vendosi të thellonte vëzhgimet e veta.*

Fragmenti i tretë fillon nga: – *Megjithatë, – murmurinte me vete, – një dele arrita ta bëj të kërcejë. Katerino, ngulmo: ki besim te vetja. Nesër do të bëhen dy dele, pastaj tre, e do t’ia dalësh mbanë.*

Gjatë kohës që lexojnë, nxënësit do të mendojnë, do të parashikojnë dhe do t’i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Mësuesi/ja përgatit më parë pyetjet dhe i paraqet në mënyrë grafike në dërrasën e zezë, me qëllim që nxënësit ta kenë më të lehtë t’i mbajnë shënim parashikimet e tyre.

Ç'mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Studim teksti
Në klasë formohen 4 grupe nxënësish dhe punojnë detyrat:
Grupi I – ushtrimet: 1, 2/ Studim teksti.
Grupi II – ushtrimet: 3, 4,5,6/ Analizojmë tekstin.
Grupi III- ushtrimet: 7, 8, 9/ Interpretojmë tekstin.
Grupi IV- ushtrimet: 9,10, 11/ Gjuha e tekstit.
Nxënësit paraqesin para klasës përgjigjet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi i nxënësve:
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.
Vlerësim diagnostikues dhe formues.

Detyrat dhe puna e pavarur *Shiko Fletore pune, f. 25*

Detyrat e kësaj njësie mësimore do të punohen nga nxënësit në shtëpi dhe do të prezantohen në orën e dytë.
Nxënësit do të punojnë ushtrimet 12,13 dhe 14/ Reflektojmë tekstin. Këto detyra do të prezantohen në pjesën e parë të orës mësimore.
Ndërsa për pjesën e ndërtimit të njohurive të reja, nxënësit do të sjellin nga një tregim të shkurtër imagjinar të punuar me shkrim, me titull “Unë dhe roboti im Katerino” ose “Njerëzit dhe robotët në vitin 2222”.

Pasi nxënësit të kenë prezantuar tregimet e tyre të shkurtra, ata do të përzgjedhin tri më të bukurat. Mësuesi/ja duhet t’i udhëheqë/mbikëqyrë nxënësit në atë mënyrë që t’i orientojë drejt përzgjedhjes së tregimit në të cilin:

- është përdorur një gjuhë e pastër dhe e larmishme;
- imagjinata e thurur ka kuptim dhe lidhje (koherenca dhe kohezioni);
- janë përdorur sa më shumë shprehje të figurshme.

Fituesit duhet të jenë ata që e meritojnë dhe jo shokët apo shoqet e ngushta.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Busulla e artë

Fjalët kyçe: Lira, Belakua, hamësit, tartarët, alithimetri.

Rezultatet e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- kupton letërsinë fantastike;
- dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës;
- vlerëson sjelljen dhe vendimet pozitive që ndërmerr Lira.

Kriteret e suksesit:

Debaton për tekstin e letërsisë fantastike.

Analizon ndërtimin e letërsisë fantastike.

Reflekton rreth tekstit dhe përkrah qëndrimet e Lirës si personazhi kryesor në rrëfimin fantastik “Busulla e artë”.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Nxënësit nxiten të mendojnë për letërsinë fantastike. Pse fëmijët pëlqejnë rrëfimet dhe filmat fantastikë? Cilat lloje të rrëfimeve karakterizojnë letërsinë fantastike? Cilat elemente i hasim gjithnjë në këtë letërsi?

Mendimet e nxënësve, mësuesi/ja i shënon në dërrasën e zezë.



Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/ Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Para se të fillojë leximi i pjesës, mësuesi/ja shkruan titullin e saj në tabelë: “Busulla e artë”. Pastaj, duke u mbështetur në rubrikën para leximit, u shpjegon nxënësve se për çfarë flitet në këtë pjesë, nga është shkëputur fragmenti që do të lexojnë, si dhe disa njohuri për shkrimtarin Philip Pullman. Pasi të përfundojë leximi i pjesës dhe të jenë zbërthyer fjalët e panjohura, nxënësit së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1/ Kuptojmë tekstin.

Për të punuar ushtrimet e tjera, mësuesi/ja formon në klasë tri grupe me nga 6-8 nxënës:

Grupi I - ushtrimet 2 dhe 3/ Analizojmë tekstin.

Grupi II- ushtrimin 4/ Interpretojmë tekstin dhe ushtrimin 5 te rubrika: Gjuha e tekstit.

Grupi III- ushtrimet 6 dhe 7/ te rubrika: Gjuha e tekstit.

Pasi të kenë përfunduar, nxënësit paraqesin përgjigjet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura dhe kërkon që përgjigjet të paraqiten jo vetëm nga përfaqësuesit e grupeve, por edhe nga nxënësit e tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Sipas veprimtarisë *Rrjeti i diskutimit*, nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke punuar ushtrimet 8 dhe 9 të rubrikës: Reflektojmë rreth tekstit.

Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe dhe pastaj klasa pozicionohet në dy grupe.

Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion, nëse argumentet e grupit tjetër u duken më bindëse.

Po

Pse?

Jo

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor.

Vlerësim diagnostikues dhe formues.


Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 26

Nxënësit do të kërkojnë në burime të ndryshme dhe do të krijojnë një listë me emrat e autorëve që shkruajnë letërsi fantastike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon përemrat pronorë, vetorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar, në fjalitë e dhëna në libër; - zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përemri pronor			
Fjalët kyçe: përemër, pronor, pyetës, vetvetor, rasë, lakim, roli i përemrit.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon përemrat lidhorë dhe përemrat pronorë në fjali; - përdor drejt në një tekst përemrat lidhorë dhe ata pronorë; - analizon dallimin midis përemrave pyetës dhe përemrave lidhorë të pacaktuar; - argumenton rastet ku përemri pronor krijon paqartësi kuptimore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, fotografi të dokumenteve, materiale, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. – Letërsi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Stuhi mendimi</i> Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Çfarë po shiheni në fotografinë e paraqitur në libër? (faqe 218) Nxënësit shprehin mendimet e tyre rreth fotografisë, pra, çfarë kanë parë. Ata formojnë fjali të ndryshme, si për shembull: <i>Eltoni leu shtëpinë e tij. Eltoni leu shtëpinë e vet.</i> Bëjnë së bashku me mësuesin/en një stuhi mendimi për përemrin pronor. Nxënësit shprehin njohuritë paraprake që kanë për përemrin, ndërtimin e tij dhe llojet e përemrit pronor. Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë disa shembuj të shprehur nga nxënësit dhe bashkërisht analizojnë duke gjetur përemrat dhe llojet e tyre. Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër, klasa dëgjon. Udhëzohen nxënësit që me njohuritë e reja për përemrin pronor, të punojnë në grupe.			



Kontrollohet puna nga mësimpldhënësi/ja, korrigjohen gabimet. Plotësohet në tabelë pema e mendimeve.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM

Një nxënës/e lexon informacionin në libër *Përemri vetvetor dhe përemri pyetës*, pastaj udhëzohen të gjithë nxënësit për punën hulumtuese që do të bëjnë. Nxënësit do t'i paraqesin njohuritë e tyre paraprake dhe njohurit e fituara në tabelën DDM.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen te përemri pronor dhe bëjnë përmbledhje më të detajuar, si:

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Shërben për të lidhur dy fjali të thjeshta në një fjali të përbërë.	Cilët janë përemrat lidhorë të pacaktuar?	Përemrat lidhorë të caktuar dhe të pacaktuar: kush, cili, çfarë, ç', janë të pacaktuar. Nga ana kuptimore, këta përemra janë të zbërthyesëm në dy përemra të tjerë: Ai që punon, fiton. Nisu me atë që erdhe.
I cili – e cila lakohen dhe mund të shoqërohen dhe me parafjalë. <i>Që dhe i cili/e cila.</i> <i>Që nuk ka kategori gramatikore.</i>		
Përemri pronor ka kategorinë e gjinisë, numrit dhe rasës.	A ka klasifikime të tjera edhe për përemrin pronor?	Përemrat pronorë vetorë: im, yt, i tij etj., si dhe përemra pronorë vetvetorë: i vet/e vet.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Një nxënës/e lexon informacionin në libër *Lakimi i përemrave pronorë*, pastaj udhëzohen të gjithë nxënësit për punën hulumtuese që do të bëjnë. Nxënësit do t'i paraqesin njohuritë e tyre paraprake dhe njohuritë e fituara në INSERT.

<i>Njohuritë që i ka marrë më parë</i>	<i>Njohuritë e reja që shtohen këtë orë</i>	<i>Njohuritë që i di, por jo të sakta</i>	<i>Njohuritë e reja që merr dhe nuk i kupton</i>
<i>V</i>	+	-----	?
Përemri pronor përdoret i shoqëruar me emër. Përemri pronor përdoret më vete. Lakimi i përemrit pronor (i shoqëruar me emra në trajtë të shquar). Përemrat pronorë të vetës së parë dhe të vetës së dytë shumës: e mi, e mia, e tu, e tua, lakohen njësoj si mbiemrat e nyjshëm. Përemrat pronorë të vetës së tretë: i (e) tij, i (e) saj, i, (e) tyre, i (e) vet, e veta, lakohen njëjloj si mbiemrat e nyjshëm.	Përemrat pronorë, krahas kategorisë së vetës, të gjinisë dhe të numrit, kanë edhe kategorinë e rasës. Përemrat pronorë mund të përdoren të shoqëruar me emrat ose në vend të këtyre emrave. Në të dyja përdorimet, këta përemra lakohen të gjithë.	Përemrat tanë/tona dhe tuaj/tuaja lakohen vetëm kur përdoren më vete. Kur përemrat pronorë vendosen pas emrit, atëherë ky emër përdoret në trajtë të shquar. Kur përemrat pronorë vendosen para emrit, atëherë emri është gjithmonë në trajtë të pashquar.	Përemrat pronorë, si mund të emërzohen dhe të lakohen si emra mashkullorë ose femërorë?

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur për punën hulumtuese.

Ushtrime: Dalloni përemrat pyetës nga ata lidhorë të pacaktuar.

	<i>Pyetës</i>	<i>Lidhorë të pacaktuar</i>
<i>Nuk e di kush ka të drejtë.</i>		
<i>Kush mendon ndryshe, le ta thotë.</i>		
<i>Ç'të mbjellësh do të korrësh.</i>		+
<i>S'di ç'të bëjë njeriu më parë.</i>		
<i>Ende s'është vendosur në cilën klasë do të mblidhemi.</i>	+	
<i>Mund të takosh kë të duash.</i>		

Bëni dallimin mes lidhëzës, pjesëzës dhe përemrit lidhor që.

Erdhën që të dy. I porosita nxënësit që të përgatiteshin më mirë. Nxënësit që lexojnë vazhdimisht, kanë më shumë pyetje se të tjerët. Kam shpresë që do të bëhet më mirë. Që të gjithë e dinin që kjo punë nuk bëhej. Të niseshe që nesër! Ata që nisen sot, do ta kenë më të lehtë.

Shembull

Lidhëz: Që të gjithë e dinin që kjo punë nuk bëhej.

Përemër lidhor: Ata që nisen sot, do ta kenë më të lehtë.

Pjesëz: Të niseshe që nesër!

Ushtrim: Plotësoni vendet bosh me nga një përemër pronor.

Secili të shohë punën _____.

Ajo e takoi gjyshin në shtëpinë _____.

I moshuari foli, por askush nuk ua vuri veshin fjalëve _____.

Librat e mi janë në çantë, _____ janë mbi tavolinë.

Ne e kryem detyrën _____. Shojja ime del gjithnjë e shoqëruar me
mamanë _____. Djali e la biçikletën _____ në oborrin e shkollës.

Ushtrim: Rishkruani si duhet ato fjali, ku përemri pronor krijon paqartësi kuptimore.
Ajo e ftoi shoqen në shtëpinë e saj.

Ato punuan gjithë ditën në zyrën e tyre.

Blerta i dha Ilirit librin e vet.

Secili të shohë punën e tij.

Ai kërkonte të vetat, ajo të vetët.

Mësimdhënësi/ja kontrollon punën e tyre duke korrigjuar gabimet.
Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit.
Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.
Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të përemrave lidhorë dhe pronorë në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR *Shiko Fletore pune, f. 57*

Krijo një tregim të shkurtër me temë “Në treg”, ku të përdorësh 5 përemra lidhorë dhe 5 pronorë.
Formo fjali me përemrat pronorë: imi, imja, yti, jona, juaja, duke i përdorur në rasat gjinore dhe kallëzore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon përemrat pronorë, vetorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar, në fjalitë e dhëna në libër; - zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrime - Përemri pronor

Fjalët kyçe: përemër, pronor, emërzimi, i caktuar, rasë, lakim, roli i përemrit.

Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon në fjali përemrin pronor;
- analizon përdorimin e përemrave pronorë në fjali;
- analizon kategoritë gramatikore të përemrave pronorë;
- argumenton emërzimin e përemrave pronorë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Fjalori i Gjuhës Shqipe, fotografi të dokumenteve, materiale, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. – Letërsi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Hapi I. Situata e të nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: *Diskutim për njohuritë paraprake*

**Diskutohet detyra e shtëpisë, e cila është dhënë orën e mëparshme.*

- GE - Ktheji në rasën e duhur.

Shoku ynë (dhanore) - shokut tonë

Ime motër (gjinore)- i/e sime motre

Shoqja jonë (kallëzore) - shoqen tonë

Yt vëlla (dhanore) - tët vëllai

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në dyshe*

-Përdor më vete përemrat e mëposhtëm dhe ndërto fjali me ta.

Imi - të mitë

Yti - të tutë; imja - të miam

I tyre - të tyre; e saj - të sajat

I veti - të vetët

-Lako përemrat tanë/tona dhe tuaj/tuaja (lakohen vetëm kur përdoren më vete).

Ky ishte një qytet i vogël, në të cilin kisha kaluar fëmijërinë.

-Ndërto fjali me përemrin pronor- Ky është libri im. Këtë e kam librin tim. Këta janë librat e mi.

Përemri pronor përdoret i shoqëruar me emër. Përemri pronor përdoret më vete.

Përemrat pronorë të vetës së parë dhe të vetës së dytë shumës: e mi, e mia, e tu, e tua, lakohen

njësoj si mbiemrat e nyjshëm. Pronorët e vetës së parë shumës: tanë, tona, tuaj, tuaja, lakohen

ashtu si mbiemrat e panyjshëm. Përemrat pronorë të vetës së tretë: i (e) tij, i (e) saj, i, (e) tyre, i

(e) vet, e veta, lakohen njësoj si mbiemrat e nyjshëm.

Nxënësit vazhdojnë të plotësojnë ushtrimet në faqet 221 – 222.

Ushtrimi 1. Plotësoni vendet bosh me nga një përemër pronor.

Ushtrimi 2. Rishkruani si duhet ato fjali, ku përemri pronor krijon paqartësi kuptimore.

Ushtrimi 3. Lakoni grupet emërore: libri yt, shkolla ime, klasa jonë, lapsi i saj.

Ushtrimi 4. Dalloni përemrat pronorë dhe përcaktoni vetën, rasën dhe numrin në të cilin janë përdorur.

Ushtrimi 5. Plotësoni tabelën.

Ushtrimi 6. Vendosni në formën e duhur përemrat pronorë.

Ushtrimi 7. Lakoni përemrat pronorë të vetës së parë: yni, jona, tanë, tonat (njëjës dhe shumës).

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Lojë në dyshe

-Me temën “Në kamping”, ndërtoni një tekst të shkurtër, ku të përdorni përemra pronorë!

-Nxënësit përforcojnë duke u argëtuar njohuritë për përemrin pronor.

Mësimdhënësi/ja kontrollon punën e tyre duke korrigjuar gabimet.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Nxënësit dëgjojnë dhe vlerësojnë punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të përemrit pronor në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 57

Ushtrimi 8. Formoni fjali me përemrat pronorë: imi, imja, yti, jona, juaja, duke i përdorur në rasat gjinore dhe kallëzore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon përemrat vetorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar, në fjalitë e dhëna në libër; - zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË**IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS****ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: Përemri vetvetor dhe përemri pyetës

Fjalët kyçe: përemër, pyetës, vetvetor, rasë, lakim, roli i përemrit.

Rezultatet e të nxënit për orë mësimore (Përdorimi i drejtë i gjuhës):

Nxënësi/ja:

- njihet me përemrin dhe kategoritë gramatikore;
- njihet me kuptimin leksikor të përemrit vetvetor dhe të përemrit pyetës;
- mëson llojet e përmrave vetvetorë dhe përmrat pyetës; zëvendësimin e emrit;
- shkruan drejt llojet e përmrave vetvetorë dhe përmrat pyetës;
- përdor drejt përmrat dhe zëvendësimin e emrit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:


- Nxënësi/ja zhvillon komunikimin.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Hapi I. Situata e të nxënit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Stuhi mendimi

Bëjmë së bashku një stuhi mendimi për përemrin vetvetor dhe përemrin pyetës.



Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT

Një nxënësi/e lexon informacionin në libër *Përemri vetvetor dhe përemri pyetës*, pastaj nxënësit e tjerë udhëzohen për punën hulumtuese që do të bëjnë. Nxënësit do t'i paraqesin njohurit e tyre paraprake dhe njohuritë e fituara në INSERT.

+++ E di	VVV e re	--- E di ndryshe	??? Dua të di
- Përemri vetvetor është përemri që tregon vetën, e cila përfaqëson njëkohësisht edhe atë mbi të cilin ushtrohet një veprim, edhe atë që e kryen këtë veprim. - Përemri pyetës përdoret për të pyetur për frymorë e sende ose për tipare të tyre. - Përemrat vetvetorë janë: vetja dhe vetvetja.	- Përemrat pyetës janë: <i>kush, cili, çfarë, sa, i sati, se</i>.	-Përemra pyetës që kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës: <i>cili, i sati</i>. -Përemra pyetës që kanë vetëm kategorinë gramatikore të rasës: <i>kush, sa</i>. -Përemra pyetës që nuk kanë kategori gramatikore: <i>ç', çfarë, se</i>.	-Roli i përemrave pyetës

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:- punë në grupe dhe demonstrim
Nxënësit punojnë ushtrimet dhe më pas diskutojnë rreth tyre (në faqen 224).

Ushtrimi 1. Vendosni në vendet bosh përemra vetvetorë.

Ushtrimi 2. Shkruani fjali me përemrat vetvetorë për çdo rasë.

Ushtrimi 3. Plotësoni vendet bosh me fjalët që mungojnë.

Ushtrimi 4. Nënvizoni me vizë përemrat dëftorë dhe qarkoni përemrat vetorë.

Ushtrimi 5. Shkruani fjali me përemrat pyetës.

Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të përemrave vetvetorë dhe të përemrave pyetës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR


Shiko Fletore pune, f. 58

Ushtrimi 6. Me nga tre përemra vetvetorë dhe pyetës, formoni fjali.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon përemrat vetorë, vetvetorë, pyetës, të pacaktuar, në fjalitë e dhëna në libër; - zëvendëson në fjali përemrat që mungojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përemri i pacaktuar			
Fjalët kyçe: përemër, pyetës, vetvetor, rasë, lakim, roli i përemrit.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore (Përdorimi i drejtë i gjuhës); Nxënësi/ja: - njihet me përmrin dhe kategoritë gramatikore; - njihet me kuptimin leksikor të përmrit të pacaktuar; - mëson llojet e përmrave dhe zëvendësimin e emrit; - shkruan drejt llojet e përmrave të pacaktuar; - përdor drejt përmrat dhe zëvendësimin e emrit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Pema e mendimit Nxënësit shprehin njohuritë paraprake që kanë për përmrin, ndërtimin e tij dhe llojet e përmrit. Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë disa shembuj të shprehur nga nxënësit; bashkërisht analizojnë duke gjetur përmrat dhe llojin e tyre. Një nxënës/e lexon me zë informacionin në libër, klasa dëgjon. Udhëzohen nxënësit që me njohurit e reja për përmrat, llojet e përmrave, të punojnë në grupe pemën e mendimit duke konkretizuar me shembuj për secilin lloj të përmrave:			



Kontrollohet puna nga mësime dhënësi/ja, korrigjohen gabimet. Plotësohet në tabelë pema e mendimeve.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: *INSERT*

Një nxënës/e lexon informacionin në libër *Përemri vetvetor dhe përemri pyetës*, pastaj nxënësit e tjerë udhëzohen për punën hulumtuese që do të bëjnë. Nxënësit do t'i paraqesin njohurit e tyre paraprake dhe njohurit e fituara në *INSERT*.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen te përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra; bëjnë përmblendhje më të detajuar, si:

+++ E di	VVV e re	--- E di ndryshe	??? Dua të di
- Përemër vetvetor është përemri që tregon vetën, e cila përfaqëson njëkohësisht edhe atë mbi të cilin ushtrohet një veprim, edhe atë që e kryen këtë veprim. - Përemri pyetës përdoret për të pyetur për frymorë e sende ose për tipare të tyre.	- Përemrat vetvetorë janë: vetja dhe vetvetja. - Përemrat pyetës janë: <i>kush, cili, çfarë, ç', sa, i sati, se.</i>	-Përemra pyetës që kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës: <i>cili, i sati.</i> -Përemra pyetës që kanë vetëm kategorinë gramatikore të rasës: <i>kush, sa.</i> -Përemra pyetës që nuk kanë kategori gramatikore: <i>ç', çfarë, se.</i>	-Roli i përemrave pyetës

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit janë të ndarë në pesë grupe. Secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër.

Ushtrimi 1, faqe 226 – Dalloni përemrat dhe tregoni llojin e tyre.

Ushtrimi 2. Dalloni cilët nga përemrat e mëposhtëm janë pyetës dhe cilët të pacaktuar.

Ushtrimi 3. Lakoni grupet emërore: ca libra, klasa tjetër, secili nxënës, çdo grup.

Ushtrimi 4. Ndërtoni gjashtë fjali me fjalën *kush* të përdorur si përemër pyetës, si përemër lidhor dhe si përemër të pacaktuar.

Ushtrimi 5. Dalloni se në cilat raste, fjalët *shumë, ca, tepër, pak* janë përemra të pacaktuar.

Mësimdhënësi/ja kontrollon punën e tyre duke korrigjuar gabimet.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të përemrit të pacaktuar.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 6. Shkruani një tekst të shkurtër argumentues, për përparësitë dhe rreziqet e përdorimit të internetit, duke përdorur përemra pronorë dhe përemra të pacaktuar.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Nana me buzë në gaz			
Fjalët kyçe: pa za, gazmon.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Ndre Mjedja; – analizon vargjet e krijuara nga Ndre Mjedja; – dallon poezitë me temë të njëjtë. Kriteret e suksesit: Dallon një poezi lirike. Diskuton për poezinë lirike. Shkruan një poezi me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII – fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë një fjali për nënën: <i>Përshkruani pamjen e nënës suaj kur ju takon.</i> Nxënësit udhëzohen të tregojnë me rend përjetimet e tyre kur takohen me nënën. Të gjitha mendimet e nxënësve shënohen në tabelë. Pastaj, mësuesi/ja shënon në tabelë titullin e poezisë “Nana me buzë në gaz” dhe shpjegon pjesën para leximit.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon për autorin Ndre Mjedja dhe udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë. Pas leximit komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon edhe poezinë lirike dhe diskutojnë së bashku. Më tej, nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe.

Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1.

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë, ushtrimi 2.

Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 3,4 dhe 5.

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë, ushtrimet 6, 7, 8 dhe 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj së bashku reflektojnë rreth poezisë duke punuar ushtrimin 10.

Në vargun e fundit thuhet: “Me buz’ në gaz, m’gazmon”. Çfarë bën nëna që e gazmon djalin? Ka të bëjë thjesht me buzëqeshjen e saj, apo me diçka tjetër më të thellë?

Pastaj, nxënësit udhëzohen të zgjedhin vargjet që u pëlqejnë për komentim. Për shembull:

Vargjet	Komenti
Mue nana, kur m’shikon, Me buz’ në gaz m’gazmon...	Nxënësit duhet të japin komentet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e një pesëvargëshi për poezinë e mësuar.

Nëna
e bukur e re
punon gatuan fal dashuri
përkëdhel fëmijën me buzë në gaz

Jetë

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).


Detyrat dhe puna e pavarur *Shiko Fletore pune, f. 27*

Mësoni poezinë përmendesh dhe recitoheni në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: In memoriam (Gjyshes)			
Fjalët kyçe: filiza, fisi, zi.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan lidhjen mes poezisë dhe ilustrimit figurativ (fotografisë) në tekst; - analizon ndërtimin artistik të poezisë; - reciton bukur poezinë.			
Kriteret e suksesit: Shpjegon rolin e pazëvendësueshëm të gjyshes në familje. Krijon vargje për gjyshen. Kupton dialektin dhe çmon mesazhin e poezisë. Shkruan një poezi me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjuar, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimeve Mësuesi/ja shkruan në mes të dërrasës së zezë fjalën “Gjyshja” dhe pastaj nxit nxënësit që të shprehin mendimet e tyre: Çfarë është gjyshja për ju? Nxënësit do të shprehin mendimet dhe fjalët që do thurin për gjyshen. Të gjitha fjalët, me ndihmën e një nxënësi/eje, mësuesi/ja do të mundohet t’i renditë në formën e pemës së mendimeve në dërrasën e zezë.			



Më pas, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit dhe tregon për jetën e autorit dhe veprimtarinë e tij.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon se çfarë është elegjia dhe udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë dhe, pas leximit, komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj shpjegon edhe pjesën pas leximit dhe diskutojnë së bashku. Më pas, nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe.

Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1.

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë, ushtrimet 2, 3 dhe 4.

Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 5 dhe 6.

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë, ushtrimet 7, 8 dhe 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj së bashku reflektojnë rreth poezisë; ushtrimet 10 dhe 11.

Cili varg i elegjisë përshkruan ceremoninë e përcjelljes së gjyshes për në varr?

Si është shprehur paralelizmi mes natyrës dhe gjendjes shpirtërore të poetit?

Pastaj, nxënësit udhëzohen të zgjedhin vargjet që u pëlqejnë për komentim. P.sh.:

Vargjet	Komenti
Asaj që tokën punonte me lopatë, Lopatat ia hedhin tokën përmbi.	Nxënësit duhet të japin komentet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e një pesëvargëshi për poezinë e mësuar.

Gjyshja
e bukur e vjetër
punon gatuan dashuron
me buzë në gazë
Nëna

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur
Mësoni poezinë përmendesh dhe recitoheni në klasë. Lexoni me kujdes pjesën “Pas leximit”, ku poeti ka përshkruar një ngjarje lidhur me këtë poezi. Si mendoni, a është arti një formë e duhur për të përjetësuar kujtimet tona ose njerëzit që kemi njohur dikur? Argumentoni me shkrim.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon foljet në mënyrën kushtore dhe habitore; - jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja në mënyrën kushtore dhe habitore; - dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse <i>kam</i>); - zgjedhon foljet në mënyrën kushtore dhe habitore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Folja në mënyrat kushtore dhe habitore			
Fjalët kyçe: zgjedhim, folje, formë veprorë, mënyra kushtore, habitore.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - rikujton njohuritë e marra për formën veprorë dhe zgjedhimin në mënyrë kushtore dhe habitore; - mëson ndërtimin e formës veprorë të zgjedhimit në mënyrën kushtore dhe habitore; - përdor drejt formën veprorë të zgjedhimit në mënyrën kushtore dhe habitore; - veçon formën veprorë të mënyrës kushtore dhe habitore.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfage, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Zhvillon komunikimin në çdolloj fushe. - Letërsi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Hapi I. Situata e të nxënës

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Mësimdhënia e ndërsjellë

Vështrim – Punë e pavarur

Nxënësit vështrojnë fotografin e dhënë në libër. Lexojnë pjesën e dhënë anash fotografisë duke iu përgjigjur kërkesës: Nëse do t'i zgjidhte të gjitha ushtrimet, Erdi do të merrte notë të mirë. Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pamjen e fotografisë, mandej një nxënës/e lexon me zë pjesën e tregimit; disa nxënës japin përgjigjet e tyre sipas kërkesës me shembuj; plotësohen dhe korrigjohen nga nxënësit dhe mësimdhënësi/ja.

Shkruaj në tabelë fjalitë:

- <u>Mendojmë për këtë.</u>	(e tashme)	}	Veprime të sigurt
- <u>Kam menduar unë për këtë.</u>	(e shkuar)		
- <u>Do të mendoj unë për këtë.</u>	(e ardhme)		

Nxënës/ja dhe mësimdhënësi/ja, nga analiza e fjalive për nga kuptimi, nxjerrin se folja në mënyrën dëftore shpreh një veprim ose një gjendje të sigurt, të vërtetë, që ka ndodhur në të shkuarën, po ndodh në të tashmen apo do të ndodhë në të ardhmen.

Kontrollohet puna nga mësimdhënësi/ja, korrigjohen gabimet. Plotësohet në tabelë pema e mendimeve.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve – Loja zinxhir

- Nxënësit njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e kohëve të mënyrës dëftore: 4 të thjeshta, 4 të përbëra; si ndërtohen ato (mjetet gjuhësore që shërbejnë).
- Nxënësit në grupe dyshe punojnë me tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën kushtore dhe habitore (tabelën e konceptit).
- Ndalen në dallimin e temës dhe mbaresës së foljeve dhe në foljen ndihmëse “kam”, e cila formon kohët e përbëra.

Nxënësit do t'i paraqesin njohurit e tyre paraprake dhe njohurit e fituara në INSERT.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen te zgjedhimi i foljes në mënyrën kushtore dhe zgjedhimi i foljes në mënyrën habitore. Ata bëjnë përmbledhje më të detajuar, si:

+++ E di	VVV E re	--- E di ndryshe	??? Dua të di
Folja e përdorur në mënyrën kushtore, tregon një veprim që mund të kryhej, po të vërtetohej një kusht i caktuar. Folja e përdorur në mënyrën habitore, shpreh ndjenjën e habisë së folësit për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar.	- Mënyra kushtore ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. - Mënyra habitore ka katër kohë: të tashmen, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën	- Me anë të mënyrës habitore, folësi mund të shprehë edhe dyshimin ose mospajtimin, madje edhe ironi.	- Dalloni mënyrën dhe kohën e foljeve. Analizoni rolin e tyre për shprehjen e kuptimit të fjalisë.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit janë të ndarë në pesë grupe. Secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër.

Ushtrimi 1, faqe 229. Zgjedhoni foljet: kam, vizitoj, hap, fle, në të dyja kohët e mënyrës kushtore, sipas shembullit të dhënë.

Ushtrimi 2. Ndërtoni fjali duke i kthyer foljet në mënyrën kushtore sipas shembullit të dhënë.

Ushtrimi 3. Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Ushtrimi 4. Plotësoni tabelën e mëposhtme me foljet: jam, mendoj, pres, ha.

Ushtrimi 5. Plotësoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Ushtrimi 6. Ktheni foljet e dhëna në kohën më se të kryer të mënyrës habitore dhe formoni fjali me to.

Ushtrimi 7. Përcaktoni mënyrën, kohën, vetën, zgjedhimin e foljeve të fjalive të mëposhtme.

Mësimdhënësi/ja kontrollon punën e tyre duke korrigjuar gabimet.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi. Vlerësohen për përdorimin e drejtë të foljes në mënyrat kushtore dhe habitore. Vlerësim i punës së ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. Vlerësim me listë kontrolli.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 59

Ushtrimi 8, faqe 230 - Shkruani një tregim të shkurtër deri në tetë fjali, në të cilin të përdorni nga katër folje të mënyrës habitore dhe kushtore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit/es dhe të orës së mësimi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon foljet në mënyrën dëshirore dhe urdhërore; - jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja në mënyrën dëshirore dhe në atë urdhërore; - dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse kam); - zgjedhon foljet në mënyrën dëshirore dhe në atë urdhërore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore			
Fjalët kyçe: zgjedhim, folje, formë veprorë, mënyra dëshirore, urdhërore.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - rikujton njohuritë e marra për formën veprorë dhe zgjedhimin në mënyrën dëshirore dhe urdhërore; - mëson ndërtimin e formës veprorë të zgjedhimit në mënyrën dëshirore dhe urdhërore; - përdor drejt formën veprorë të zgjedhimit në mënyrën dëshirore dhe urdhërore; - veçon formën veprorë të mënyrës dëshirore dhe urdhërore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfaqe, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe. - Letërsi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: Mësimdhënia e ndërsjellë Vështrim – Punë e pavarur Nxënësit vështrojnë fotografinë e dhënë në libër. Lexojnë pjesën e dhënë anash fotografisë duke iu përgjigjur kërkesës: Nëse do t'i zgjidhte të gjitha ushtrimet, Erdi do të merrte notë të mirë.			

Nxënësit shprehin mendimet e tyre për pamjen e fotografisë, mandej një nxënës/e lexon me zë pjesën e poezisë; disa nxënës japin përgjigjet e tyre, sipas kërkesës me shembuj, plotësohen dhe korrigjohen nga nxënësit dhe mësimehmësi/ja.

Shkruaj në tabelë fjalitë:

- | | | | |
|-------------------------------------|------------|---|--------------------|
| - <u>Mendojmë për këtë.</u> | (e tashme) | } | Veprime të sigurta |
| - <u>Kam menduar unë për këtë.</u> | (e shkuar) | | |
| - <u>Do të mendoj unë për këtë.</u> | (e ardhme) | | |

Nxënësi/ja dhe mësimehmësi/ja, nga analiza e fjalive për nga kuptimi, nxjerrin se folja në mënyrën dëftore shpreh një veprim ose një gjendje të sigurt, të vërtetë, që ka ndodhur në të shkuarën, po ndodh në të tashmen apo do të ndodhë në të ardhmen.

Kontrollohet puna nga mësimehmësi/ja, korrigjohen gabimet. Plotësohet në tabelë pema e mendimeve.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve – Loja zinxhir

- Nxënësit njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen në ndarjen e kohëve të mënyrës dëftore: 4 të thjeshta, 4 të përbëra; si ndërtohen ato (mjetet gjuhësore që shërbejnë).
- Nxënësit në grupe dyshe punojnë me tabelën e zgjedhimit të foljeve në mënyrën dëshirore dhe urdhërore me folje (tabelën e konceptit).
- Ndalen në dallimin e temës dhe mbaresës së foljeve dhe në foljen ndihmëse *kam*, e cila formon kohët e përbëra.

Nxënësit do t'i paraqesin njohurit e tyre paraprake dhe njohurit e fituara në INSERT.

Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, ndalen te zgjedhimi i foljes në mënyrën dëshirore dhe zgjedhimi i foljes në mënyrën urdhërore; bëjnë përmbledhje më të detajuar, p.sh:

+++ E di	VVV E re	--- E di ndryshe	??? Dua të di
-Me anë të mënyrës dëshirore, shprehet një dëshirë në formë urimi ose mallkimi: Ardhtë shëndoshë e mirë! Gëzuar qofshi!	- Mënyra dëshirore ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. - Folja në mënyrën urdhërore del vetëm në vetën e dytë njëjës dhe shumës: Nisu menjëherë! Nisuni menjëherë!		- Dalloni foljet në mënyrën dëshirore. Çfarë shprehin ato? - Dalloni foljet në mënyrën urdhërore. Vini re dallimin nga trajtat e tjera foljore.
Me anë të mënyrës urdhërore shprehet një dëshirë në formë urdhri, kërkesë, këshille, porosie, lutjeje etj.			

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Nxënësit janë të ndarë në pesë grupe, secilit grup i caktohet ushtrimi sipas kërkesës në libër.

Ushtrimi 1, faqe 232. Zgjedhoni foljet: jam, kërkoj, kap, lë, në të dyja kohët e mënyrës dëshirore.

Ushtrimi 2. Ndërttoni fjali me kuptim dëshiror, duke i kthyer foljet në mënyrën dëshirore sipas shembullit të dhënë.

Ushtrimi 3. Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Ushtrimi 4. Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe rolin e foljes *jam*.

Ushtrimi 5. Ktheni foljet e dhëna në kohën e tashme të mënyrës dëshirore dhe formoni fjali me to.

Ushtrimi 6. Klasifikoni pohimet sipas skemës së dhënë.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe secili grup vlerëson punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të veçanta (të kufizuara).

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimi. Vlerësohen për përdorimin e drejtë të foljes në mënyrat dëshirore dhe urdhërore.

Vlerësim i punës së ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. Vlerësim me listë kontrolli.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 61

Ushtrimi 7, faqe 232 - **Dalloni mënyrën dhe kohën e foljeve.**

– *Më thuaj të vërtetën! Po të jepja tani një urdhër, që vetëm mbreti ka të drejtë ta japë, a do të zbatohej? Do të kundërshtonte e të thoshte njeri “jo”?*

– *Jo, madhëri, askush nuk do të guxonte. Për sa kohë je mbret, vullneti yt është ligj.*

Atëherë Tomi tha: - Ngrihuni në këmbë dhe shpejt drejt kështjellës!

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit/es dhe të orës së mësimi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultatet e të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon zgjedhimin jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore; - jep përkufizimin për kuptimin që shpreh folja; - dallon kohët e thjeshta nga ato të përbëra (folja ndihmëse kam).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv			

V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë
VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit
II. VLERAT DHE QËNDRIMET
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore
Fjalët kyçe: zgjedhim, folje, formë joveprore, mënyra, dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore, urdhërore, pjesëza u
Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore: Nxënësi/ja: - diskuton për zgjedhimin jovepror në të gjitha mënyrat; - dallon foljet e zgjedhimit jovepror në fjali; - analizon foljen <i>jam</i> kur përdoret me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse; - bën dallimin midis pjesës <i>u</i> të formës joveprore dhe trajtës së shkurtër; - shkruan një tekst të shkurtër duke përdorur të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit jovepror të foljeve.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe e klasës VIII, uebfage, libra shkencorë, fjalor, fotografi të dokumenteve, video.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe. - Letërsi.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Hapi I. Situata e të nxënësve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/es: Stuhi mendimi, Diskutim Bëj shndërrimin pësor të fjalive: <i>Rrezet e diellit ndriçonin dhomën e Arditit.</i> <i>Arkeologët nxjerrin në dritë një qytetërim të ri.</i> <i>Nëna natyrë ofron mundësi të pafundme zgjedhjesh.</i> <i>Era e fortë rrëzonte gjethet e zverdhura të vjeshtës.</i> *Kujdes! Kur të bëni shndërrimin pësor të fjalive: <i>Forma veprare kthehet në formën joveprore.</i> <i>Kryefjala kthehet në kundrinor të zhdrejtë me parafjalë.</i> <i>Kundrinori i drejtë kthehet në kryefjalë.</i> <i>Folja duhet të jetë në të njëjtën kohë në të dyja format!</i> Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënësve në bashkëpunim *Nxënësve do të ndahen në grupe, për të punuar ushtrimet e dhëna në tekst. Grupi 1 <i>Bëni dallimin mes përdorimit të foljes “jam” si folje me kuptim të plotë dhe si folje ndihmëse.</i>

Ku je?
 Jam duke ardhur.
 Ku keni qenë kaq kohë?
 Qenke veshur e stolisur si rrallëherë.
 Qofsha gabim, por zor se kthehet më.
 Mund të ishim nisur që dje.
 Që të gjithë duhet të ishim atje.

Grupi 2

Bëni dallimin mes pjesëzës “u” të formës joveprorë dhe të trajtës së shkurtër përemërore.

U bëfsh njëqind vjeç!
 U thashë të prisnin pak.
 Merruni edhe me sport.
 Mos u anko kot!
 Kush u foli atyre?
 Jepuani të drejtën e fjalës!
 U shqetësova më shumë se ç’duhej.

Grupi 3

Rishkruani fjalitë duke i kthyer foljet nga mënyra dëftore në atë lidhore.

Ti zgjohesh shumë herët në mëngjes. Ti të zgjohesh herët në mëngjes!
 Të mendohej gjatë, përpara se të merrte një vendim.
 Më parë mendohej gjatë, para se të merrte një vendim.
 Do të takohemi me shokët pas dreke.
 Të takohemi pas dreke me shokët.
 Nuk e di se nga fshihet kohët e fundit.
 Kohët e fundit, se nga të fshihet, nuk e di!

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Si e bëjnë formën joveprorë foljet? Ndërto një fjali me to.

Laj – mënyra dëshirore koha e tashme (u lafsha).
 Gëzova – mënyra dëftore, koha e kryer e thjeshtë (u gëzova).
 Laj – koha e tashme mënyra lidhore.
 Këndova – mënyra dëftore koha e ardhme.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Më pas diskutojnë rreth zgjidhjes së ushtrimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësim. Vlerësimi në punën e ushtrimeve me gojë, me shkrim, individualisht. Vlerësimi me listë kontrolli.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 62

Shkruani një tekst të shkurtër, ku të përdorni të tria mënyrat e formimit të zgjedhimit jovepror të foljeve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit/es dhe të orës së mësim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Vrull			
Fjalët kyçe: hare, mote, Arbëria.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan lidhjen në mes poezisë dhe ilustrimit figurativ (fotos) në tekst; - analizon ndërtimin artistik të poezisë; - reciton bukur poezinë. Kriteret e suksesit: Shpjegon rolin e familjes për ruajtjen e traditës dhe dashurisë ndaj vendlindjes. Krijon vargje për vendin. Kupton dialektin dhe çmon mesazhin e poezisë. Shkruan një poezi me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: “A mendoni se me kalimin e kohës, njeriu mund ta harrojë vendlindjen e tij?” (Nëse do të jetonit në ndonjë vend tjetër.) (Shikoni në foto veshjen tradicionale dhe komentoni.) Pastaj nxiten nxënësit të shprehin mendimet e tyre. Të gjitha mendimet shënohen në tabelë. Pas përfundimit të kësaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit dhe tregon për jetën e autorit (Zef Serembe) dhe për veprimtarinë e tij.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon për strofën dhe llojet e saj dhe udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë. Pas leximit komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre.

Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1.

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë, ushtrimet 2 dhe 3.

Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 4, 5, 6 dhe 7.

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë, ushtrimet 8, 9, 10 dhe 11.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj zgjedh vargjet e pëlqyera për komentim.

Vargjet	Komenti
Arbëria matanë detit, na kujton, se ne të huaj jemi te ky dhe! Sa mote shkuan! E zëmra nuk harron,... Që nga turku mbetëm pa mëmëdhe...	Nxënësit duhet të japin komentet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e një pesëvargëshi për poezinë e mësuar.

Poezia
e bukur e vjetër
krijohet botohet përkthehet
është një grup vargësh
Rima

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur *Shiko Fletore pune, f. 28*

Mësoni poezinë përmendesh dhe recitoheni në klasë.

Gjeni një poezi të një poeti tjetër arbëresh, i cili trajton të njëjtin motiv.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënësit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Ora e Shalës
Fjalët kyçe: lahuta, ferlikët, gurra, breshan.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Gjergj Fishta; – analizon vargjet e krijuara nga Gjergj Fishta; – dallon poezitë me temë të njëjtë. Kriteret e suksesit: Dallon rimën e përdorur në poezi. Diskuton për veprën “Lahuta e Malcis” dhe 30 këngët e saj. Shkruan një poezi me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjes, tabela.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Lahuta e Malcis” dhe udhëzon nxënësit të tregojnë njohuritë që kanë rreth kësaj vepre dhe 30 këngëve të saj. Të gjitha mendimet shënohen në tabelë. Pastaj, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Ora e Shalës” dhe shpjegon për nxënësit pjesën para leximit dhe për rimën. Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë dhe pas leximit komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj udhëzohen të punojnë të ndarë në grupe. Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimet 1, 2, 3. Grupi i dytë: Analizojmë poezinë, ushtrimi 4, 5, 6. Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë, ushtrimi 7. Grupi i katërt: Reflektojmë rreth poezisë/ ushtrimet 8, 9 dhe Gjuha e poezisë, ushtrimi 10. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj, së bashku reflektojnë rreth tekstit duke kryer ushtrimin 10.

Gjeni figura të tjera mitologjike, të përmendura në këngë të tjera të poemës epike “Lahuta e Malcis”.

Pas diskutimeve, ata udhëzohen të zgjedhin vargjet që u pëlqejnë të komentojnë. P.sh.:

Vargjet	Komenti
Mbasi bukë trimat kan ngrânë Jânë çue prap e dalë m’njâ n’ânë E po rrin tue bisedue Me njat t’bukurën Oré të Shalës,	Nxënësit duhet të japin komentet e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Lahuta

E bukur, e vjetër

Trashëgohet, ruhet, krijohet

Instrument muzikor epik

Malësia

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësoni përmendësh poezinë dhe recitoheni në klasë. Shkruani një poezi me temë të njëjtë. Gjeni figura të tjera mitologjike, të përmendura në këngë të tjera të poemës epike “Lahuta e Malcis”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.’

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënësve të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi dhe në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara):

I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.

V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes (2 orë)

Fjalët kyçe: manushaqe, bukuroshe, lulëz perëndi, gëzohu, hithra, ferra

Rezultatet e të nxënësve për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Naim Frashëri;

- analizon vargjet e krijuara nga Naim Frashëri;

- dallon poezitë me temë të njëjtë.

Kriteret e suksesit:

Dallon figurën e simbolit në poezi.

Diskuton për gjendjen aktuale të vendit dhe për realizimin e dëshirave të autorit.

Shkruan një poezi me temë të njëjtë.

Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjues, tabela.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Naim Frashëri” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një kllaster me mendimet e tyre për temën. P.sh.:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes” dhe u shpjegon nxënësve pjesën para leximit dhe figurën stilistike: *simboli*.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë dhe pas leximit, komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj udhëzohen të punojnë të ndarë në grupe.

Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimet 1, 2, 3, 4

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë, ushtrimi 5.

Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 6, 7

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë, ushtrimet 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj së bashku reflektojnë rreth tekstit, duke kryer ushtrimet 10, 11.

Po sot, në ç’ gjendje është atdheu ynë? Me çfarë mbiemrash do ta karakterizonit atë? Lidhni fjalën “manushaqe” me mbiemrat që do të përzgjidhni, më pas përgjigjuni pyetjes:

Si mendoni, a është përmbushur pritshmëria e poetit në lidhje me të ardhmen e atdheut? Diskutoni në grupe.

Pas diskutimeve, nxënësit udhëzohen të zgjedhin vargjet që u pëlqejnë të komentojnë. P.sh.:

Vargjet	Komenti
Manushaqe bukuroshe, pse s’ngre kryetë përpjetë, po rri e mpit’ edhe e qetë? Pse s’zbukuroh’e shëndoshe?	Përrshkrim shumë i bukur i vendit, duke e krahasuar me lulen dhe shqetësimin për gjendjen aktuale.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë nxënësit/et udhëzohen për pesëvargësh.

Manushaqe
E bukur, e qeshur
Lulëzon, zbukuron, gjallëron
Lulëz e perëndisë, që të mbolli vetë Zoti.
Shqipëria

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur *Shiko Fletore pune, f. 29*

Shkruani një përshkrim ose rrëfim letrar, në qendër të të cilit të vendosni një objekt apo frymor simbolik. Përpikuni që mes rreshtave të lini të kuptohet se kujt i referoheni me të. Lexoni punët me shkrim të njeri-tjetrit dhe diskutoni rreth tyre.

Në orën e dytë vazhdohet me poezi patriotike. Mësuesi/ja organizon orën e mësimi duke u mbështetur te të dhënat e rubrikës “Bashkëbisedojmë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Mëma			
Fjalët kyçe: mëma, e shenjë, rreze drite, yll qiellor.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – përshkruan elementet dalluese të poezisë lirike; – analizon vargjet e krijuara për nënën; – dallon poezitë me temë të njëjtë. Kriteret e suksesit: Rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Asdreni. Krijon një poezi lirike me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII, fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër			
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Nëna” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një tekst të shkurtër për dashurinë që ndiejnë për nënën dhe të përshkruajnë kujdesin e saj ndaj tyre. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës/e lexojnë tekstin e shkurtër dhe diskutojmë të gjithë për shprehjet më të mira. Pastaj mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit dhe për shkrimtarin Aleksandër Stavre Drenova (1872-1947), i njohur në letërsinë shqipe me pseudonimin Asdreni.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje /Diagrami i Venit

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë dhe pas leximit komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyrat 1, 2, 3, 4.

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë – detyrat 5, 6.


Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë – detyra 7.

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë – detyrat 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Pastaj së bashku reflektojnë rreth tekstit - detyra 10.

Krahasoni me diagramin e Venit nënën e kësaj poezie me nënën tuaj.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh**

Nëna
E bukur, e re
Punon, dashuron, ledhaton
Është plot dhembshuri e mall të zjarrtë.
Engjëll

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 30

Bëni një punë me shkrim, në të cilën të shprehni ndjenjat për nënën tuaj duke iu referuar vargjeve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Yjeve të pashuar			
Fjalët kyçe: ngujuar, zaptues, u bënë fli.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – përshkruan elementet dalluese të poezisë lirike; – analizon vargjet e krijuara për atdheun dhe për dëshmorët; – dallon poezitë me temë të njëjtë.			
Kriteret e suksesit: Rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Esad Mekuli. Krijon një poezi lirike me temë të njëjtë. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - fleta të bardha, shënjuar, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër			
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë: <i>A mendoni se për lirinë ia vlen çdolloj sakrifice? Pse?</i> Më pas udhëzon nxënësit të shkruajnë një shkrim të shkurtër për temën e dhënë. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës/e lexojnë shkrimin e shkurtër dhe diskutojnë të gjithë për shprehjet më të mira. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën para leximit dhe për shkrimtarin Esad Mekuli.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia - Pyetje-përgjigje/Diagrami i Venit

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon një nxënës/e të lexojë poezinë me zë dhe pas leximit komentojnë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyrat: 1, 2, 3.

Grupi i dytë: Analizojmë poezinë – detyra 4.


Grupi i tretë: Interpretojmë poezinë – detyrat: 5, 6.

Grupi i katërt: Gjuha e poezisë – detyrat: 7, 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj, së bashku reflektojnë rreth tekstit – detyrat: 10, 11.

Nxënësit ndërtojnë diagramin e Venit.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh**

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për krijimin e një pesëvargëshi.

Liria
E bukur e dashur
Fitohet luftohet ruhet
Është fituar me shumë sakrifica
Dëshmor

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni dhe lexoni poezi të tjera nga letërsia shqipe, të cilat u janë kushtuar të rënëve për liri.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shqiponja			
Fjalët kyçe: vetëtimë, bebëzat, fortësinë.			
Rezultatet e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - njeh jetën dhe krijimtarinë e autorit: - dallon temën e poezisë dhe identifikimin e shqiptarëve; - analizon gjuhën dhe thurjen e poezisë.			
Kriteret e suksesit: Ilustron me shembuj peizazhin e shqiponjës në poezi sipas përshkrimit të autorit: Vlerëson lidhjen e shqiptarëve me shqiponjën, me të cilin shpesh identifikohen. Reciton bukur poezinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh (Brainstorming) Mësuesi/ja shënon në dërrasën e zezë titullin e poezisë “Shqiponja” dhe i nxit nxënësit të diskutojnë në dyshe për këtë temë. Nxënësit do të hedhin idetë e tyre në letër, pastaj do t’i prezantojnë para klasës. Mësuesi/ja shënon në dërrasën e zezë mendimet që kanë thurur nxënësit për shqiponjën. Duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, secilit nxënës i shtohet informacioni në kujtesën e vet.			
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje /përgjigje - Diskutim Para se të fillojë leximi i poezisë, mësuesi/ja duke u mbështetur në rubrikën <i>Para leximit</i> , u tregon nxënësve se cili është objekti i poezisë “Shqiponja”. Pastaj u shpjegon për jetën dhe veprimtarinë e autorit Ymer Elshani. Më pas bëhet leximi artistik i poezisë dhe nëpërmjet metodës <i>Pyetje-përgjigje</i> , nxënësit punojnë në grupet e tyre.			

Mësuesja ndan klasën në 3 grupe dhe secili punon ushtrimet:

Grupi I punon ushtrimin 1.

Grupi II punon ushtrimet 2 dhe 3.

Grupi III punon ushtrimet: 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Nxënësit punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet para klasës. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Pastaj, të gjithë nxënësit së bashku me mësuesin/en kryejnë ushtrimin 9. Përgjigjet e nxënësve mund të jenë të ndryshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, nxënësit zgjedhin strofën që u pëlqen për komentim. Për shembull:

Citati: Shkruani strofën që ju pëlqen.	Komenti: Komentoni strofën që zgjedhët.
Në qiellin e gjerë arbëror Valon si flamur – kurorë. Krahët – shkëmb i fortë, Fortësinë ia kanë rritur Ndeshjet me stuhi.	Nxënësit shkruajnë komentet e tyre për strofën e zgjedhur.

Vlerësimi i nxënësve

Vlerësimi do të kryhet sipas pjesëmarrjes aktive të nxënësve në orën mësimore.

Vlerësim diagnostifikues dhe formues.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shiko Fletore pune, f. 31

Mësojeni përmendësh poezinë “Shqiponja”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja njihet me ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe. Dallon ndërrime zanoresh dhe ndërrime bashkëtingëlloresh, jep përkufizimin për kuptimin e llojeve të ndërrimeve fonemore. Dallon lloje ndërrimesh fonemore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Pasthirrma
Fjalët kyçe: pasthirrma, tingulllimitimet, nxitëse, emocionale, të thjeshta, të përngjitura, shprehje...
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Nxënësi/ja: – dallon pasthirrmat nga pjesët e tjera të ligjëratës; – dallon pasthirrmat emocionale nga ato nxitëse; – dallon pasthirrmat sipas formimit të tyre, ndërton tekste në të cilat përdor pasthirrma dhe tingulllimitimet.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video...
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; Letërsi; Artet
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Hapi I. Situata e të nxënës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim Vështrim – Punë e pavarur Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit se çfarë po shihni në fotografinë e paraqitur në libër, në faqen 235. Nxënësit shprehin mendimet e tyre, pra se çfarë kanë parë dhe formojnë fjali të ndryshme. Nxënësit vështrojnë tekstin e dhënë në libër. Lexojnë pjesën e tregimit duke iu përgjigjur kërkesës, si: Lexoni fragmentin. Emërtoni fjalët. Monitorohet puna nga mësimdhënësi/ja, korrigjohen gabimet. <i>Ua sa qenke rritur moj çupa?!</i> <i>Ej, Ela ti je?</i> <i>Se mjaft në robëri</i> <i>Moj e mjera Shqipëri</i> <i>O burra rrokni armët</i> <i>Ja vdekje, ja liri</i> Evidento pasthirrmat në fjalitë e dhëna.
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve Nxënësit njihen me informacionin që jepet në libër dhe ndalen të klasifikimi i pasthirrmave sipas kuptimit. Nxënësit punojnë në grupe dyshe me tabelën e konceptit. Ndalen të tingulllimitimet, të vendi dhe funksioni i pasthirrmave në fjali. Nxënësit do t'i paraqesin njohuritë e tyre paraprake dhe njohuritë e fituara në tabelën e konceptit.
Nxënësit, duke u bazuar në informacionet e reja, bëjnë përmbledhje më të detajuar, si:

Pasthirrmat	Emocionuese	Nxitëse	I. Pasthirrma të thjeshta
	Shprehin gëzim, admirim, kënaqësi.	Shprehin nxitje, urdhër ose lutje	Mund të jenë tinguj të veçantë ose grupe tingujsh.
	Shprehin mosbesim, mospërfillje, përbuzje.	Shprehin thirrje.	II. Pasthirrma të përngjitura
	Shprehin frikë, dëshpërim, hidhërim.	Shprehin përshëndetje, mirënjohje, mallkime, sharje, ngushëllime.	Formohen prej përdorimit të gjatë e të vazhdueshëm si formula urimi a përshëndetjeje.
	Shprehin pakënaqësi, keqardhje, mërzi, dhimbje.	<i>faleminderit, lamtumirë, mirëmëngjesi, mirupafshim, mirë se erdhe, natën e mirë, tungjatjeta, udha e mbarë</i>	Pasthirrma Shprehje Disa shprehje frazeologjike, kur përdoren si njësi të gatshme për të shprehur ndjenja të ndryshme, marrin rolin e pasthirmës.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Të ngjashme me pasthirrmat, janë edhe tingullimitimet (onomatopetë). Ato nuk shprehin ndjenja, as nuk nxitin për të vepruar, vetëm imitojnë tingujt e natyrës: *Mjau-mjau – dëgjohej macja.*

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

1- Nënvizoni pasthirrmat dhe thoni se çfarë lloji janë ato.

Oh! Sa të bukura janë lulet në pranverë! Ah, ku jeni o ditë të lumtura e gjithë diell! Ua, paska filluar shiu! Dreq o punë, m'u prish humori. Ahu, s'guxon njeriu të bëjë një plan! Uf, u mbyllëm brenda! Eh, iku edhe një ditë.

Oh – pasth/emoc, që tregon kënaqësi.

Ah/eh – pasthirmë emocionale, që tregon dhimbje e mërzi.

Ua – pasth/emoc shpreh habi.

Ahu – pasth/emoc shpreh mosbesim.

2- Dalloni pasthirrmat që shprehin ndjenjat e folësit, pasthirrmat nxitëse dhe tingullimitimet.

3- Vendosni në tabelë pasthirrmat: bobo, aha, bubu, korba, obobo, ehe, qyqja, o, oh, oho, ububu, e zeza, au, eu, oj, ou, bah, ehe, ahu, i, ohu, të lumtë, urra, u, ua, uh, ptu, y.

4- Shkruani një përshkrim të shkurtër, në të cilin të përdorni pasthirrma të grupeve të ndryshme.

Pasi mbarojnë punën, nxënësit lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit, secili grup.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:	
Vlerësohen nxënësit për dallimin e pasthirmave në fjali, për bashkëveprimin me shokët në punën në grup etj.	
Detyrat dhe puna e pavarur	<i>Shiko Fletore pune, f. 66</i>
Shkruani disa pasthirrma që imitojnë tinguj të ndryshëm frymorësh apo sendesh dhe krijoni fjali me to. Përshkruani figurën e mëposhtme me 5-6 fjali, ku të përdorni sa më shumë pasthirrma.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja njihet me pjesëzat. Dallon pjesëzat në fjali nga pjesët e tjera të ligjëratës. Përcakton llojin e pjesëzave. Analizon pjesëzat sipas mënyrë së ndërtimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Pjesëza			
Fjalët kyçe: pjesëza, dëftuese, përforcuese, përcaktuese-saktësuese, modale.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: – dallon pjesëzat në fjali nga pjesët e tjera të ligjëratës; – përcakton llojin e pjesëzave; – analizon pjesëzat sipas mënyrë së ndërtimit të tyre; – ndërton histori, duke përdorur pjesëza të llojeve të ndryshme.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; Letërsi; Artet.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Hapi I. Situata e të nxënës

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim – Punë e pavarur

Emërtoni fjalët me shkronja të zeza dhe thoni se ç'pjesë ligjërata janë.

*Ja dhe Jehona, shoqja ime më e mirë. E kam njohur **qysh** në fëmijëri, kur ishim në të njëjtin kopsht. Ajo **nuk** rrinte një sekondë pa lëvizur. Luante **pothuajse** gjithë ditën dhe **nuk** ia dilte dot kush. Edhe sot dallohet. Është në qendër të vëmendjes **pikërisht** si dikur.*

Të gjitha janë pjesëza.

Ja – dëftuese

Nuk – mohuese

Qysh – saktësuese

Pikërisht – saktësuese

Pothuajse – përafruese

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Mbajtje e strukturuar e shënimeve

Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstet dhe të mbajnë shënime në mënyrë të strukturuar dhe të diskutojnë më pas me mësuesin/en.

Pjesëza

Pjesëza është pjesë e pandryshueshme e ligjërates dhe shërben për të shprehur ngjyime kuptimore ose emocionale plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi apo të një fjalie.

Sipas kuptimit i klasifikojmë: pjesëza që shprehin ngjyime kuptimore të përgjithshme, modale dhe pjesëza emocionuese shprehëse

Pjesëza të thjeshta:

bile, ja, jo, nuk, po etj.

Pjesëza të përngjitura:

pale, posi, pothuajse etj.

Pjesëza shprehje:

as qe, ja qe, jo qe jo etj.

Plotësimi i tabelës bëhet nga nxënësit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shqyrtim i përbashkët

Punohen ushtrimet në tekst në faqen 239.

Ushtrimi 1. Në tekstin e mëposhtëm, gjeni pjesëzat dhe përcaktoni llojin e tyre sipas kuptimit dhe sipas ndërtimit.

Ushtria gati po rrokullisej si një trup që ka humbur kontrollin. Ne thuajse nuk nxirrim asnjë fjalë, por ecnim shpejt, gati pa marrë frymë. Armiku mund të na zbulonte edhe nga zhurma më e vogël, madje edhe nga frymëmarrja e rënduar e ndonjë të plagosuri. Vetëm komandanti seç bënte me dorë nga kalaja majë kodrës. Mbase na ftonë të uleshim e të maskoheshim më mirë. Vallë, a do të dilnim dot më prej atij vendi të lig?

Ushtrimi 2. Zëvendësoni pjesëzat e tekstit të dhënë dhe shpjegoni ndryshimin që ndodh në të.

Ushtrimi 3. Ndërtoni pesë fjali me pjesëza që shprehin ngjyime kuptimore të përgjithshme dhe me pjesëza emocionuese-shprehëse.

Ushtrimi 4. Shkruani një tregim të shkurtër, rreth 50 fjalë, ku të përdorni sa më shumë pjesëza që shprehin emocion.

Pasi mbarojnë punën, nxënësit lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Shkëmbehen librat mes grupeve dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit, secili grup.

Ushtrimet prezantohen para klasës. Klasa dëgjon dhe vlerëson punën e shokëve/shoqeve.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e saktë të pjesëzave në fjali, dallimin e llojeve të tyre sipas kuptimit dhe ndërtimit.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 67

Në pjesën e leximit me titull “Kërcimtarja e Dukagjinit”, gjeni dhe nënvizoni pjesëzat dhe thoni se ç’lloj janë.

Shkruani nga një fjali ku të përdorni *e*-në herë si pjesëz, herë si lidhëz dhe herë si pasthirmë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):			
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit			
II. VLERAT DHE QËNDRIMET			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË**IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS****Aspektet specifike të planit të orës mësimore****Njësia mësimore:** Të dua baltë shqiptare (2 orë)**Fjalët kyçe:** baltë, shqiptare, të dua, egërsisht, dëshpërimisht...**Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore****Nxënësi/ja:**

- rikujton poezitë patriotike;
- përshkruan vargjet e poezisë;
- dallon poezitë me temë të njëjtë.

Kriteret e suksesit:

Analizon figurën e krahasimit në poezi.

Diskuton për gjendjen shpirtërore të poetit “jam brenda teje/s’ dal dot/se s’ dua”.

Krijon/shkruan një poezi/ese me temë të njëjtë.

Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - Fleta të bardha, shënjues, tabela.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Edukatë qytetare; histori; gjeografi.**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:****Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikimi me terma paraprakë**

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë disa fjalë si p.sh.: baltë, të dua egërsisht, dëshpërimisht, shqiptare, magjistare, e ëmbël...

Nga nxënësit kërkohet që të krijojnë një fjalë ose vargje, duke përdorur termat paraprakë.

Pasi nxënësit të kenë krijuar fjalinë apo vargje, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e poezisë “Të dua baltë shqiptare” dhe shpalos para nxënësve jetën dhe veprimtarinë letrare të poetit Mitrush Kuteli.

Dhimitër Pasko: (lindi në Pogradec, 13 shtator 1907 — vdiq në Tiranë, 4 maj 1967) ka qenë ekonomist dhe ekspert ekonomie, përkthyes, i njohur për kritikën letrare dhe prozën e shkurtër së bashku me Ernest Koliqin, themelues i prozës moderne shqipe, ku njihet më shumë me emrin e pendës **Mitrush Kuteli**. Qëndrimet e Paskos mbi ekonominë shqiptare nuk u aplikuan në asnjërin nga periudhat për të cilat shkroi apo punoi, qoftë në periudhën e mesluftërave, gjatë kohës kur punoi në Bankën Shqiptare, duke mbrojtur kapitalin shqiptar kundrejt kërkesave të pushtimit gjerman, po ashtu edhe në fillimet e regjimit komunist, i cili edhe e burgosi. Veprimtaria e tij pas burgut u “tkurr” te profesioni i përkthyesit dhe pak letërsi për fëmijë. Është autor i shumë veprave, po veçojmë vetëm disa: *E madhe është gjëma e mëkatit*; *Vjeshta e Xheladin Beut dhe rrëfime të tjera*; *Ditari i ekonomistit*; *Pylli i Gështenjave*; *Xinxifillua*; *Tregime të moçme shqiptare etj.* Kuteli njihet edhe për thënien e tij “**TDHEU ËSHTË ATDHE EDHE KUR TË VRET**”.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon rubrikën para leximit dhe pastaj mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë poezinë (lexim artistik) me zë dhe pas leximit të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/emocionet që leximi i poezisë zgjoi tek ata. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre punuese detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1.

Grupi II: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 2.

Grupi III: Analizojmë poezinë, ushtrimi 3. Të dua egërsisht/Dëshpërimisht/Si ujku pyllin...

Grupi IV: Analizojmë poezinë, ushtrimi 3. Dhe dua fort të dehem/të prehem/(ah që tani!)/brenda teje.

Mësuesi/ja ndihmon grupet, nëse është e nevojshme, dhe vazhdon me detyrën 3. Në dërrasë të zezë vizatohet tabela dhe shkruhet detyra:

Cili është kuptimi i vargjeve të mëposhtme? Qarkoni alternativën që ju duket se qëndron dhe argumentoni zgjidhjen tuaj.

Të dua si balta baltën, si vala valën...

✓ a) Të dua si prindi fëmijën e vet.	Dashuria e prindit për fëmijën është më e madhja/sublime/hyjnore...
b) Të dua si veten.	
c) Të dua siç do njeriu të afërmin e vet.	

Alternativat e nxënësve mund të jenë të ndryshme, mësuesi/ja duhet të kërkojë që secila alternativë të argumentohet nga nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dypjesësh/Citat-koment

Nxënësit janë të lirë të zgjedhin nga 10 rreshta nga poezia dhe t'i komentojnë. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të gjejnë krahasimet në poezi, t'i nënvizojnë dhe të tregojnë se përse i ka përdor autorit ato, çfarë ka arritur të zgjojë te lexuesit me krahasimet dhe me baltën si element identifikues i identitetit etnik të poetit.

Vargjet/Citati	Komenti
Të dua baltë shqiptare Magjistare e ëmbël! si vetë vdekja, se thellë jam këtu brenda teje gjer mbi gju gjer mbi bel e gjer mbi krye.	Poeti përshkruan dashurinë e tij për vendin e tij të lindjes. Dashuri pa kushte, balta është element identifikues i identitetit të autorit ajo është magjistare, e ëmbël... vdekja në atdhe për poetin është e ëmbël...

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 32

Nxënësit do të zbërthejnë detyrën 4 dhe 5 të rubrikës “Interpretojmë tekstin” dhe do të kenë detyrë që të hulumtojnë në internet për jetën dhe veprimtarinë letrare të poetit Mitrush Kuteli. Gjithashtu nga nxënësit do të kërkohet që të punojnë detyrat nga rubrikat “Gjuha e poezisë” dhe “Reflektojmë rreth poezisë”. Do të shkruajnë nga një ese me temën “Të dua, baltë shqiptare!”.

Detyrat dhe eseja do të prezantohen në orën e dytë. Për orën e dytë, mësuesi/ja do të organizojë/udhëheqë nxënësit, që të punojnë sipas udhëzimeve dhe kërkesave të parashtruara te rubrika “Bashkëbisedojmë”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik			Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Leni lumejt...				
Fjalët kyçe: Bungu, deti Jon, Adrie.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: – njihet me jetën dhe veprën e autorit; – dallon në poezi spontanitetin dhe rrjedhshmërinë e gjërave; – zbërthen rolin dhe funksionin e figurave letrare.				
Kriteret e suksesit: Zbulon përshkrimin simbolik të peizazhit në poezi. Vlerëson përshkrimin e kohës në poezi dhe kupton mesazhin që përcjell poezia. Reciton bukur poezinë.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.				
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim vizual Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan titullin e poezisë në tabelë “Leni lumejt” dhe udhëzon nxënësit të hapin librin në fq. 127, të shikojnë fotografinë dhe të tregojnë çfarë përjetimi sjellë pamja. Nxënësit do të shprehin mendimet e tyre dhe të gjithë do të diskutojnë për pamjen e bukur që sjellë fotografia. Pastaj, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit pjesën para leximit dhe shpjegon për autorin Martin Camaj.				

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia pyetje/përgjigje

Pas leximit të poezisë, bëhet shpjegimi i fjalëve të panjohura dhe nëpërmjet metodës Pyetje-përgjigje nxënësit punojnë pyetjet dhe ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8. Mësuesi/ja ndërhyr nëse ndonjë nxënës/e ngecë. Pastaj udhëzohen të zgjedhin strofën e pëlqyer për komentim. P.sh.:

Strofa e pëlqyer	Komente
Ngjyra e grunit dhe e ullinit t'u shihet në faqe e në bebëzat e synit dhe kulmi i shpisë të jetë bunge e pragu guri.	"Nxënësit do të komentojnë për strofën e zgjedhur".

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Nxënësit do të punojnë një pesëvargësh. P.sh.:

Natyra
E qetë e bukur
Lulëzon hijeshon zbukuron
Vendi që e duan të gjithë
Lule

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur *Shiko Fletore pune, f. 33*

Do të mësojnë poezinë përmendësh.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënësve të temës: Një dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

- I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit
- II. VLERAT DHE QËNDRIMET
- III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË
- IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore**Njësia mësimore:** Ora e gjimnastikës**Fjalët kyçe:** Golgota, maratoni, Fisi.**Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore****Nxënësi/ja:**

- rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Ali Podrimja;
- analizon vargjet e krijuara nga Ali Podrimja;
- dallon poezitë me temë të njëjtë.

Kriteret e suksesit:

Dallon një poezi të autorit.


Diskuton për gjimnastikën dhe ndikimin e saj në shëndetin e njeriut.

Shkruan një poezi me temë të njëjtë.

Reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - Fleta të bardha, shënjes, tabela.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Edukatë qytetare; histori; gjeografi.**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:****Metodologjia për realizimin e njësies mësimore:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster**

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Ali Podrimja” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një kllaster me mendimet e tyre për temën. P.sh.:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë të njësies së re mësimore “Ora e gjimnastikës” dhe shpjegon për nxënësit pjesën para leximit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Ditari dypjesësh

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon një nxënëse/e të lexojë poezinë me zë dhe pas leximit komentojmë të gjithë së bashku për përshtypjet. Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre punuese.

Grupi i parë: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1 dhe Analizojmë poezinë, ushtrimet 2, 3 dhe 4.

Grupi i dytë: Interpretojmë poezinë, ushtrimi 5 dhe Gjuha e poezisë, ushtrimet 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Grupi i tretë: Reflektojmë rreth poezisë, ushtrimi 11.
Mësuesi/ja ndihmon në grup, nëse është e nevojshme.
Pastaj udhëzohen të zgjedhin vargjet e pëlqyer për komentim.
P.sh.:

Vargjet e pëlqyer	Komente
Kush ushtron, jeton më gjatë. Kërcim së largu Kërcim së larti Trehapëshi Njëqind metërshi	“Nxënësit komentojnë për vargjet e pëlqyera”

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh
Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen për pesëvargësh.

Gjymnastika
E bukur e rëndësishme
Ushtrohet krijohet luhet
Ora

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Kthejeni poezinë në prozë. Çfarë humbet poezia nga ky kthim?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Kërkim në fjalor. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe gjej kuptimet e fjalisë. Kujdes! Rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore**Njësia mësimore:** Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj**Fjalët kyçe:** Fjali, ndërtim, rregull, analizë, gramatikë, drejtshkrim.**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:****Nxënësi/ja:**

- rikujton njohuritë e marra për fjalinë;
- mëson rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore;
- njihet me grupet e fjalëve në fjali dhe rendin e tyre;
- veçon grupet e fjalëve në fjali.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, libri i nxënësit, *webfaqe*, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, shkumësa me ngjyra.**Lidhja me lëndët e tjera e mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:****Hapi I. Situata e të nxënit****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme:** DDM, Punë në dyshe

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: të drejtpërdrejta; të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve?	

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstat dhe të punojnë në plotësimin e rubrikës “Mësova”.

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Shumica e fjalëve të gjuhës shqipe kanë më shumë se një kuptim. Këto kuptime mund të jenë: - të drejtpërdrejta; - të figurshme.	Cilat janë mënyrat e krijimit të kuptimeve të figurshme të fjalëve? Ç’është fjalia?	Kuptimet e figurshme të fjalëve mund të krijohen nëpërmjet mënyrave të ndryshme: 1) nëpërmjet metaforës gjuhësore; 2) nëpërmjet përdorimit të prapashtesave me nuanca përkëdhelëse dhe keqësuese. Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikiisht e të shqiptuara me intonacion mbarimi. Pra, që fjalia të jetë e saktë, duhen përmbushur dy kritere të rëndësishme: ana gramatikore dhe ajo kuptimore.

Lexoni tabelën e mëposhtme dhe plotësoni kolonat e fundit.

Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj	
Ç'është fjalia?	Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimimit ligjërimor, që shprehet me një a më shumë fjalë të lidhura gramatikisht e të shqiptuara me intonacion mbarimi. Pra, që fjalia të jetë e saktë, duhen përmbushur dy kritere të rëndësishme: ana gramatikore dhe ajo kuptimore. Siç dëshmohet në shembujt e mësipërm, një grup fjalësh mund të lidhen sipas rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, por nëse nuk respektohet ana kuptimore, fjalia është e papranueshme: Dimri merrte ilaçe për ftohje të rëndë.
Rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore	Duhet bërë mirë dallimi mes lidhjes së fjalëve që nuk respektojnë rregullat morfo-sintaksore të shqipes dhe gabimeve drejtshkrimore. Folësit e gjuhës 1 241 amtare zotërojnë një njohje të mirë e të pavetëdijshme të të parave, ndërkohë që duhet të mësojnë t'i përdorin mirë të dytat. Thënë ndryshe, një folës i gjuhës amtare, edhe nëse nuk i njeh rregullat e gramatikës, nuk ndërton fjali të pasakta nga ana gramatikore, si: Mua nuk pëlqen morfologjia.
Grupet e fjalëve në fjali dhe rendi i tyre	Fjalia nuk është një shumë e dosidoshme fjalësh. Këto të fundit, duhet të lidhen së pari në grupe sipas rregullave dhe ligjeve të gjuhës e më pas grupet bashkohen në një fjali. Shembulli i sjellë që në krye: <i>Dimër nga mbulohen bora në malet.</i> - dëshmon që nuk mund të kemi fjali, kur fjalët ndjekin njëra-tjetrën pa një rend të caktuar.
<i>Për në qoftë se nxënësit kanë informacione të paqarta mësuesi/ja i udhëzon ata.</i> Nëpërmjet përdorimit të intonacionit të veçantë me nuanca: përbuzjeje, talljeje, shakaje, ironie: <i>Vërtet! Ashtu?! Posi?! Me gjithë mend?!</i> Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe Nxënësit udhëzohen të plotësojnë pjesën e ushtrimeve, si: Ushtrimi 1. Rishkruani si duhet fjalitë e mëposhtme pasi të keni analizuar gabimet për secilën. Ushtrimi 2. E vërtetë V apo e gabuar ✓? Ushtrimi 3. Dalloni dhe analizoni gabimet në fjalitë e mëposhtme. Ushtrimi 4. Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë e mëposhtme, duke ndryshuar rendin e tyre. Pasi mbarojnë punën, nxënësit lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.	
Vlerësimi i nxënësve:	
Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalive, rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore, grupet e fjalëve në fjali dhe rendi i tyre.	

Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 68
Ushtrimi 5. Zgjeroni fjalinë e mëposhtme duke ruajtur të njëjtin grup fjalësh. <i>Papritur, në qiell u mblodhën re të zeza.</i>	
Ushtrimi 6. Shkruani nga tri fjali për secilin rast të dhënë në tabelën e mëposhtme.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. I përdor drejt ato në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIME III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali				
Fjalët kyçe: Funksion, fjalë, fjali, përbërje, kryefjalë, kundrinor, gjymtyrë, mjet lidhës, fjalë lidhëse.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: - dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali; - dallon paraprijësin në pjesën kryesore; - analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë; - argumenton pozicionin ku ndodhen funksionet gramatikore të fjalëve në fjali.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.				

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:**Hapi I. Situata e të nxënës****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Mësimdhënie e ndërsjellë**

Mendimet tona i shprehim me fjalë të lidhura në fjali. Në çdo fjali, dallojmë grupin emëror dhe grupin foljor. Fjalët në fjali quhen **gjymtyrë të fjalisë**. Fjalët në gjuhën shqipe analizohen edhe nga pikëpamja sintaksore dhe quhen gjymtyrë. **Fjalja** është një bashkim fjalësh ose një fjalë e vetme që shpreh një kumtim. **Fjalja e thjeshtë** e pazgjeruar ka dy gjymtyrë kryesore: kryefjalën dhe kallëzuesin. Fjalja e thjeshtë e zgjeruar, përveç gjymtyrëve kryesore (kryefjalë, kallëzues), ka edhe gjymtyrë plotësuese (përcaktorë, kundrinorë, rrethanorë). Quhet fjali e përbërë fjalja që ka më shumë se një kallëzues. Gjymtyrët e fjalisë ndahen në gjymtyrë kryesore dhe gjymtyrë të dyta (plotësuese).

Në tabelë, renditen fjali të ndryshme dhe nxënësve u kërkohet që të veçojnë ato që përbëjnë një tekst. Nxënësit përqendrohen të tabela e konceptit, që mësuesi/ja e jep në tabelë për funksionet gramatikore të fjalëve në fjali. Rikujtojnë ato që kanë mësuar më parë për të.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e konceptit

Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi/ja, diskutojnë rreth plotësimit të tabelës së koncepteve, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit. Nxënësit punojnë në grupe dyshe me tekstin, njihen me informacionin e ri për funksionet gramatikore të fjalëve në fjali. Qëndrojnë 10 minuta, që të nxjerrin të rejtat që prezanton mësimi i ri nga ai i vitit të kaluar. Diskutojnë dhe analizojnë shembujt me fjali që jepen në libër, japin shembuj të tjerë, të ngjashme me to. Mësuesi/ja i udhëzon si të dallojnë funksionet gramatikore të fjalëve në fjali.

Mësimdhënësi/ja përfshin në diskutim tërë klasën.

- Shkruhet në tabelë tema e mësimi.
- Nxiten nxënësit të thonë të gjitha idetë që lidhen me njohuritë e marra rreth.

<i>Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali</i>	<i>Rregullat e caktuara</i>	<i>Pozicioni i funksioneve gramatikore</i>	<i>Jepni shembuj</i>
Fjalja nuk është një shumë e çfarëdoshme fjalësh, përkundrazi, fjalët lidhen sipas rregullave të caktuara të gramatikës, duke formuar kështu njësi të ndryshme sintaksore, siç janë gjymtyrët e fjalisë dhe fjalja.	Kështu, mes kryefjalës dhe kallëzuesit duhet të ketë përshtatje në vetë dhe në numë. Mes kallëzuesit dhe kundrinorit, duhet të ketë drejtim në rasë. Mes kallëzuesit dhe rrethanorëve, duhet të shprehet rrethana ose rrethanat, në të cilën kryhet veprimi.	Fjalët mund të luajnë rol drejtues ose të jenë të varura. Fjalët luajnë rol drejtues, kur u caktojnë fjalëve të tjera formën e shprehjes dhe rolin e tyre në fjali.	a) Të hënën, nxënësit e takuan shkrimtarin në studion e tij. b) E hëna, nxënësit e takuam shkrimtari në studios të tij.
Vëreni me kujdes përdorimin e fjalës <i>mal</i> në fjalitë e mëposhtme.	Ç'funksione sintaksore kryen fjala mal? Kush ia cakton këtë funksion? A del ajo si fjalë e varur apo drejtuese? Argumentoni përgjigjet tuaja.	Fjala në vetvete nuk mbart ndonjë funksion sintaksor, por e fiton atë, falë lidhjes që realizon me fjalën drejtuese.	

Plotësohet tabela nga nxënësit. Në rast se nxënësit kanë paqartësi, shpjegohen nga mësuesi/ja. Sugjerim! Punoni me këtë metodë, pasi kjo i bën nxënësit më aktivë në dhënien e mendimeve në fazën e parë dhe “detyron” nxënësin në fazën tjetër të mësimit të bëjë pyetje se çfarë duan të dinë rreth funksioneve gramatikore të fjalëve në fjali dhe të punojnë me tekstin deri në detaje. Në rastet më të shumta, nxënësit dëgjojnë shpjegimin e mësuesit/es për temën e re.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe-Rrjeti i diskutimit

Nxënësit punojnë me ushtrimet e më pas diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 1, fq. 246, Analizoni shembujt e mëposhtëm. Shpjegoni gabimet dhe klasifikojini ato sipas tabelës së dhënë.

Ushtrimi 2. Cilat fjalë dalin si gjymtyrë të varura dhe drejtuese. Argumentoni përgjigjen tuaj.

Ushtrimi 3. Ndërttoni pesë fjali, ku fjala “rrugë” të dalë si: kryefjalë, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë, rrethanor, përcaktor.

Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimit. Vlerësohen nxënësit për përdorimin e funksioneve gramatikore të fjalëve në fjali.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 69

Ushtrimi 4, fq. 246: Bëni analizën e gjymtyrëve në pjesën e mëposhtme.

– Ku është hyrja? – pyeti Mark Alemi. Njeriu tregoi me dorë anën e djathtë. Mënga e xhybes së tij ishte aq e gjerë, saqë ajo nuk mori aspak pjesë në tregimin e krahut. “O, Zot, ende me këto veshje”, – mendoi Mark Alemi duke ecur në drejtimin që i dha ajo dorë e hollë midis asaj mënge të përbindshme. Pas një copë here, ndjeu përsëri ca hapa përbri tij. Ishte prapë njeriu me xhybe.


Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimit.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënësit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe interpreton tekstin dramatik.	


Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Besëlidhja shqiptare
Fjalët kyçe: Perandoria turke, Abdyl Frashëri, Shqipëria, kuvendi, tokat shqiptare.
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – njeh jetën dhe veprimtarinë e autorit; – dallon tekstin dramatik dhe llojet e tij; – vlerëson qëndrimin e personazheve në fragment. Kriteret e suksesit: Analizon ngjarjen në fragment. Përshkruan një ngjarje tragjike të kombit tonë. Interpreton në role fragmentin.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - Fleta të bardha, shënjues, tabela.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/Kllaster Në këtë fazë, mësuesi/ja nxit nxënësit drejt një diskutimi në lidhje me temën. Nxënësit sjellin mendimet e tyre dhe diskutojnë me njëri-tjetrin për qëndrimet e tyre. Çfarë dini ju në lidhje me pushtimin e Shqipërisë nga perandoria turke? Nxënësit sjellin mendimet e tyre, që nëpërmjet diskutimit bëhen të qarta për të gjithë klasën.



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin “Besëlidhja shqiptare”, pastaj shpjegon pjesën para leximit dhe për shkrimtarin Sulejman Krasniqi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Pas leximit artistik dhe të ndarë në role të fragmentit “Besëlidhja e re”, për ta kuptuar sa më mirë brendinë e tij, mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë për tekstin dramatik.



Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë - Interpretojmë tekstin, detyrat 6, 7, 8.

Grupi i katër - Gjuha e tekstit, detyrat 9, 10.

Pastaj reflektojmë të gjithë rreth tekstit; detyrat 11,12. Çfarë dini rreth ngjarjes historike që përshkruhet në këtë skenë? Shqiptarëve u është dashur shpesh të përballen me situata tragjike për kombin e tyre. Përmendni disa prej tyre dhe pasojat që kanë pasur. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh Pas diskutimeve, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për krijimin e pesëvargëshit. Shqipëria E bukur, e re Trashëgohet, dashurohet, jetohet Vendi më i bukur në botë Kosova	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 34
Detyrë për orën e dytë: Luani në role fragmentin. Kujdesuni për shqiptimin e fjalëve, gjetet dhe lëvizjet në skenën e improvizuar. (Mësojeni fragmentin të ndarë në role në shtëpi, që ora e dytë të jetë interpretim në klasë. Në fillim do ta improvizoni skenën dhe personazhet e ndara duhet të sigurojnë veshjen e përshtatshme, që ora e aktrimit në klasë të jetë e njëjtë si në teatër).	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe interpreton tekstin dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore**Njësia mësimore:** I sëmuri për mend**Fjalët kyçe:** komedi, pasuri, sëmundje, skllav i mjekëve, mashtrim.**Rezultatet e të nxënës për orën mësimore****Nxënësi/ja:**

- njeh jetën dhe veprimtarinë e autorit (Molierit);
- dallon tekstin dramatik dhe llojet e tij;
- vlerëson qëndrimin e personazheve në fragment.

Kriteret e suksesit:

Analizon ngjarjen komike në fragment.

Përshkruan një personazh të njëjtë si Argani.

Interpreton në role fragmentin.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - Fleta të bardha, shënjes, tabela.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:****Metodologjia për realizimin e njësies mësimore:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh/Kllaster**

Në këtë fazë, mësuesi/ja nxit nxënësit drejt një diskutimi në lidhje me temën.

Nxënësit sjellin mendimet e tyre dhe diskutojnë me njëri-tjetrin për qëndrimet e tyre.

Si mendoni, a mund ta blejmë shëndetin me para?


Nxënësit sjellin mendimet e tyre, që nëpërmjet diskutimit bëhen të qarta për të gjithë klasën dhe tema për kllasterin është “Paraja”.



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin “I sëmuri për mend”, pastaj shpjegon pjesën para leximit dhe për shkrimtarin Jean-Baptiste Poquelin, Molieri.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Pas leximit artistik dhe të ndarë në role të fragmentit “I sëmuri për mend”, për ta kuptuar sa më mirë brendinë e tij, mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë për komedinë.



Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Interpretojmë tekstin, detyrat 4, 5, 6, 7.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 8, 9, 10.

Pastaj reflektojmë të gjithë rreth tekstit-detyrat 11,12.

Vlerësoni emocionet tuaja në lidhje me Arganin. Ky personazh ju bën të qeshni, ju bën të ndieni keqardhje për të apo të dyja?

Molieri i krijonte komeditë duke goditur fenomene ose karaktere të kohës së tij, megjithatë veprat e tij mbeten bashkëkohore. Çfarë mesazhi merrni nga kjo komedi? A njihni njerëz që i ngjajnë Arganit në fiksimin e tij?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Pas diskutimeve, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për krijimin e pesëvargëshit.

Komedia
E re, e vjetër
Krijohet, huazohet, pëlqehet
Është lloj i gjinisë dramatike.
Humori

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 35

Detyrë për orën e dytë: Luani në role fragmentin. Kujdesuni për shqiptimin e fjalëve, gjestet dhe lëvizjet në skenën e improvizuar. (Mësojeni fragmentin të ndarë në role në shtëpi, që ora e dytë të jetë interpretim në klasë. Në fillim do ta improvizoni skenën dhe personazhet e ndara duhet të sigurojnë veshjen e përshtatshme, me qëllim që ora e aktrimit në klasë të jetë e njëjtë si në teatër).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - njeh dhe interpreton tekstin dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden			
Fjalët kyçe: magji, eksplorues, magjizoolog, krijesa magjike, kafshët.			
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – njeh jetën dhe veprimtarinë e autores (J. K. Rowling); – dallon tekstin fantastik në fragment; – vlerëson qëndrimin e personazheve në fragment.			
Kriteret e suksesit: Analizon ngjarjen fantastike në fragment. Përshkruan personazhin e njohur Harry Potter. Interpreton në role fragmentin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe VIII - Fleta të bardha, shënjes, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Harry Potter” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë njohuritë e tyre për personazhin e njohur Harry. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës i lexojnë punimet dhe të gjithë diskutojmë për mendimet më të mira. Pastaj, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë “Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden ato”. Më tej, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit pjesën para leximit dhe për shkrimtaren J. K. Rowling.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Pas leximit artistik dhe ndarjen në role të fragmentit “Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden”, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Grupi i parë -Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë - Interpretojmë tekstin, detyrat 6, 7, 8, 9, 10.

Grupi i katër - Gjuha e tekstit, detyrat 11,12.

Pastaj reflektojmë të gjithë rreth tekstit; detyrat 13, 14, 15.

Çfarë mendoni se është krijesa që angullin? Kafshë shtëpiake, shpend apo kafshë magjike?

Çfarë rubrikash dhe shkrimesh mund të kenë revistat “Miku i magjistares”, “Magjistarja moderne” dhe “Shndërrimi Sot”, që motrat GOLLDSTIN kanë në apartamentin e tyre.

Nëse do të bënit magji, për çfarë do ta përdornit atë: për punë të përditshme, për të lexuar mendjen e të tjerëve apo për veprimtari të tjera?

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Pas diskutimeve, mësuesi/ja udhëzon nxënësit për krijimin e pesëvargëshit.

Harry
I ri, i ditur
Aktron, krijon, fantazon
Personazhi më i dashur i fëmijëve
Poter

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme, kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 36

Detyrë për orën e dytë: Luani në role fragmentin. Kujdesuni për shqiptimin e fjalëve, për gjestet dhe lëvizjet në skenën e improvizuar. (Mësojeni fragmentin të ndarë në role në shtëpi, që ora e dytë të jetë interpretim në klasë. Në fillim do ta improvizoni skenën dhe personazhet e ndara duhet të sigurojnë veshjen e përshtatshme, me qëllim që ora e aktrimit në klasë të jetë e njëjtë si në teatër).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë lidhur me ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe interpreton tekstin dramatik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Prometeu i mbërthyer			
Fjalët kyçe: Dikoj, Moirat, Erinitë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njeh biografinë e Eskilit; - dallon tekstin dramatik dhe vënien e tij në skenë; - vlerëson kontributin e Prometeut ndaj njerëzimit.			
Kriteret e suksesit: - Analizon tekstin dramatik dhe vënien e tij në skenë. - Përshkruan dialogun në mes të Prometeut dhe korit. - Krijon një shkrim vlerësues për Prometeun.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 8”, fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: <i>Çfarë dini për Prometeun?</i> Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre dhe vlerësohen nga mësuesi/ja. Pastaj, mësuesi/ja shënon titullin e njësisë mësimore në tabelë: “Prometeu i mbërthyer”, dhe shpjegon pjesën para leximit. “Prometeu, duke parë gjendjen e mjeruar në të cilën jetonin njerëzit, vodhi nga Olimpi zjarrin dhe jeta e tyre ndryshoi shumë. Ai u mësoi njerëzve edhe shumë njohuri shkencore, përmes së cilave ata e njohën më mirë natyrën dhe u përshtatën me të. Zeusi u zemërua që Prometeu kishte bërë diçka fshehurazi tij, megjithatë më tepër ishte i zemëruar ngaqë Prometeu, i cili kishte dhuntinë të shihte të ardhmen, nuk i tregonte një të fshehtë të madhe: kush do të ishte ai që do ta rrëzonte nga froni? Zeusi urdhëroi ta mbërthenin në një shkëmb në malet e Skithisë.”			

Pastaj shpjegon për jetën dhe veprimtarinë e autorit, Eskilit, dhe për tekstin dramatik dhe vënien e tij në skenë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim artistik, Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon tekstin dhe pjesën që do të mësojnë. Dy nxënës/e lexojnë tekstin me zë të ndarë me role. Pastaj nxënësit udhëzon të punojnë në grupet e tyre punuese. Nxënësit udhëzohen të lexojnë prapë në heshtje dhe të përgjigjen në pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyrat 1, 2.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 3, 4, 5, 6.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 7, 8.

Grupi i katër - Mitologjia greke është e mbushur me heronj me fat të paracaktuar. A mund të përmendni edhe raste të tjera të figurave mitologjike që vuajnë pasojat e fatit të pashmangshëm? Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: 3-2-1

Në këtë fazë, nxënësit/et udhëzohen të tregojnë:

- tri arsye pse duhet të studiohet autori, Eskili;
- dy tipare kryesore të krijimtarisë së tij;
- një informacion që nuk e kanë ditur, por që i befaso i fakt.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Ora e dytë do të jetë interpretim në skenë. Nxënësit do të ndahen në grupe punuese, duke respektuar udhëzimet e librit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon dhe përdor drejt llojet e fjalive me bashkërenditje dhe me nënrenditje si dhe lidhëzat përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS: Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe me nënrenditje			
Fjalët kyçe: fjali, fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, bashkërenditje, nënrenditje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: – dallon fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra; – analizon fjalitë me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje; – krahason fjalitë me bashkërenditje e nënrenditje; – gjykon rreth fjalive të dhëna në tekst, duke argumentuar përgjigjen e tij; – argumenton zgjerimin dhe ngushtimin e fjalive.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, *webfaqe*, libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, materiale, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Hapi I. Situata e të nxënës

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Di, Dua të di, Mësova

Lexoni me kujdes fjalitë e mëposhtme.

1) *Me nisjen e shirave dhe nën kërcënimin e daljes së lumenjve nga shtrati me pasojë përmytjen e mundshme të të gjitha zonave të ulëta të atij qarku, u mblodh, si çdo vit, këshilli i emergjencës, për të diskutuar rreth masave parandaluese, si dhe evakuimin e banoreve në rast rreziku.*

2) *Vendosen të largoheshin.*

Cila prej fjalive është e thjeshtë dhe cila e përbërë? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Kujtojmë:

<u>DI</u>
Fjalja e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.
Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.

Lidhni fjalitë e mëposhtme në një fjali të vetme.

Asaj i pëlqen teatri. Atij i pëlqen kinemaja.

Si e gjykoni fjalinë e mëposhtme? Ç'ndodh nëse fjalën "teatri" e zëvendësojmë me fjalën "shumë"? A ka të bëjë kjo me kuptimin e fjalës apo rolin që kryen ajo në fjali?

Asaj i pëlqen shumë, kurse atij i pëlqen kinemaja. Nuk mund ta zëvendësojmë fjalën teatri, pasi heqja e plotësisht kryesor në fjali e prish kuptimin e saj.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di, Dua të di, Mësova

<i>DI</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Fjalja e thjeshtë ka vetëm një kallëzues.	Ç' lloj marrëdhënies vendosen midis pjesëve bashkërenditëse?	Ato shprehin lidhje barazie. Lidhja e barazisë realizohet në ato raste, kur asnjëra nga pjesët e një fjalie të përbërë nuk varet prej tjetrës. Pra, secila mund të qëndrojë si fjali më vete.

Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me bashkërenditje, kur bashkohen me lidhëza bashkërenditëse.	Po midis pjesëve nënrenditëse?	Kur mes pjesëve të një fjalie të përbërë vendosen lidhje varësie, kemi të bëjmë me fjali nënrenditëse. Lidhja e varësisë, nënkupton se njëra pjesë fjalie varet prej pjesës tjetër, e cila e drejton të parën.
Pjesët e fjalive të përbëra, formojnë fjali të përbëra me nënrenditje, kur bashkohen me lidhëza nënrenditëse.	Si realizohen këto lloj marrëdhëniesh?	Te fjalitë foljet e tyre janë të plotësuar me gjymtyrët e domosdoshme, ndaj ato mund të qëndrojnë si fjali të thjeshta më vete.
Lloji i fjalisë nuk përcaktohet nga sasia e fjalëve që e përbëjnë atë, por nga numri i kallëzuesve.		

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

Punohet ushtrimi 1, fq. 249.

Dalloni fjalitë e thjeshta (TH) nga ato të përbëra (P). Nënvizoni kallëzuesit.

Gjëja më e mirë është t'i shënosh ngjarjet çdo ditë. TH

Të mbash ditar për të parë më qartë. TH

Kështu nuk të shpëtojnë hollësitë, edhe pse duken të parëndësishme. P

Duhet të hedh në letër si e shoh këtë tryezë, rrugën, njerëzit, sepse janë pikërisht këto që kanë ndryshuar. P

Duhet përcaktuar pikë për pikë zgjatja dhe natyra e këtij ndryshimi. TH

Ushtrimi 2.

Dalloni fjalitë me bashkërenditje b/r nga ato me nënrenditje n/r.

Argumentoni përgjigjen tuaj.

Frynte ere dhe gjethet binin. b/r

Gjethet binin, sepse frynte ere. n/r

Nuk mund ta kuptosh mësimin nëse je i pavëmendshëm. n/r

Nuk e kuptonte se kishte gabuar. n/r

Isha aty, por nuk dëgjova gjë. b/r

Nuk dëgjova, ç'u tha aty. n/r

Ushtrimi 3. Lidhni këto pjesë fjalish dhe shënoni llojin e tyre. Mund të përdorni lidhëza të ndryshme...

Ushtrimi 4. Zëvendësoni format foljore të pashtjelluara me forma të shtjelluara dhe analizoni fjalitë e përfutura.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje janë ndërtuar me ndihmën e lidhëzave bashkërenditëse *dhe, por* etj., ndërsa fjalitë e përbëra me nënrenditje janë ndërtuar me ndihmën e lidhëzave n/r nëse, sepse, se, apo pa ndihmën e lidhëzave.

Nxënësit punojnë në dyshe. Më pas, diskutojnë së bashku saktësinë e zgjidhjes së tyre.

Vlerësimi i nxënësve:
Bëhet vlerësimi për saktësinë e dallimit të fjalive të thjeshta nga ato të përbëra, për krahasimin e fjalive të përbëra me bashkërenditje e nënrenditje.
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 70</i>
Ushtrimi 5. Zgjeroni kallëzuesit e fjalive të mëposhtme, me të gjitha llojet e gjymtyrëve që mund të marrin. Vendosën të niseshin. _____ Nuk dinte si të sillej. _____ Iu lut të kthehej. _____ E kuptoi ç'duhej bërë. _____
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Situata e të nxënësve: Punë me tekstin.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Njësia mësimore: Ushtrime për fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje			
Fjalët kyçe: fjali, fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, bashkërenditje, nënrenditje.			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - dallon në tekstin e dhënë fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra me bashkërenditje e nënrenditje; - ndërton fjali të përbëra bashkërenditëse se të llojeve të ndryshme, nënrenditëse të llojeve të ndryshme.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti mësimor, <i>webfaqe</i> , Fjalori i Gjuhës Shqipe, shkumësa me ngjyra...			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, Punë në grupe, Punë individuale**Organizimi i orës së mësimi****Hapi I. Situata e të nxënësve**

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve:

Diskutohen së bashku me nxënësit ushtrimet e tekstit në faqet 248-249.

Ushtrimi 3. Lidhni këto pjesë fjalish dhe shënoni llojin e tyre. Mund të përdorni lidhëza të ndryshme.

a) Besoj se	b) nuk ndaloi.
b) Treni arriti në stacion, por	a) Javën tjetër ndryshon ora
c) A ia vlen që	c) T'ia fillosh nga e para
ç) Ka shumë mundësi që	ç) ky është rreziku i mbajtjes së ditarit
d) Në mos qofsha gabim	d) të vonohet.

Ushtrimi 4. Zëvendësoni format foljore të pashtjelluara me forma të shtjelluara dhe analizoni fjalitë e përfutuara.

Shpejtoi hapat për të mbërritur në kohë.

Shpejtoi hapat me qëllim që të mbërrinte në kohë

Një t'i rënë arbitri bilbilit, i gjithë stadiumi brofi në këmbë.

Kur arbitri i ra bilbilit, i gjithë stadiumi brofi në këmbë.

Duke parë e duke bërë.

Të shohim se çfarë mund të bëjmë për ty.

Doli pa folur.

Doli nga shtëpia dhe nuk foli me askënd.

Ushtrimi 5. Zgjeroni kallëzuesit e fjalive të mëposhtme, me të gjitha llojet e gjymtyrëve që mund të marrin.

Vendosen të niseshin.

Ata e vendosë në dje të niseshin herë të në mëngjes.

Nuk dinte si të sillej.

Nuk e dinte se në ç' mënyrë duhej të sillej me atë njeri.

Iu lut të kthehej.

Mamaja iu lut djalit të kthehej herët në shtëpi.

E kuptoi ç' duhej bërë. E kuptoi menjëherë se ç' duhej të bënte.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Punë individuale

Dallo fjalitë e thjeshta e të përbëra në tekstin e dhënë: “Për kë punon koha”, intervistë nga Ismail Kadare dhënë gazetën “Sheshi” të Kosovës, 18 korrik 1998.

Uniteti, thuhet apo nuk thuhet, është i pranishëm në çdo komb të gjallë sot. Ai s'është as luks, as virtyt.

Ai është domosdoshmë ri. Ndryshe këta popuj e shtete, që ne na duken të fuqishëm m e modernë, në të vërtetë janë të gjallë e janë në këmbë për hir të unitetit...

Uniteti i popullit shqiptar ka qenë përherë i vështirë, ndaj e rëndë dhe tragjike ka qenë historia e tij. Ajo nuk mund të jetë veç e tillë edhe në të ardhmen, në qoftë se kjo sëmundje nuk do të zbutet.

Uniteti i çdo populli, ashtu si pullazi i çdo tempulli, mbështetet mbi disa shtylla.

Kur shtyllat nisin e bien njëra pas tjetrës, pullazi do të bjerë e pas tij do të bjerë vetë kombi.

Gjergj Kastrioti, që ju përmendni, është programuesi kryesor i orientimit shqiptar.

Programi i tij vazhdon të jetë ende i saktë, ndaj goditja ndaj figurës së tij,

është goditje tradhtare kundër jetës së Shqipërisë. Uniteti është i vështirë,

por formula e tij është e thjeshtë. Uniteti për t'u njëmëndësuar kërkon nga gjithkush të heqë dorë nga diçka nga vetja...

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe

Ndërttoni një tekst, duke përdorur fjalë të thjeshta e të përbëra b/r e n/r.

Grupi 1: Projektet e mia për të ardhmen.

Grupi 2: Miku njihet që është mik, në nevojë e në rrezik.

Grupi 3: Lufta midis brezave.

Grupi 4: Nënë Tereza na frymëzon me veprën e saj.

Nxënësit punojnë të qetë e më pas përgjigjen për punët e bëra. Ata vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shiko Fletore pune, f. 70

Mblidhni fjalë të vjetra që përdoren ende në qytetin/fshatin tuaj. Kjo detyrë mund të përfshihet si punim portofoli.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon dhe përdor drejt llojet e fjalive me bashkërenditje dhe me nënrenditje si dhe lidhëzat përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre

Fjalët kyçe: Fjali e përbërë, bashkërenditje; shtuese, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra;
- analizon fjalitë me bashkërenditje;
- krahason fjalitë me bashkërenditje shtuese, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse;
- gjykon rreth fjalive të dhëna në tekst duke argumentuar përgjigjen e tij;
- argumenton zgjerimin dhe ngushtimin e fjalive.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VII, *webfaqe*, libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, materiale, dëshmi të para të gjuhës shqipe, video...

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Hapi I. Situata e të nxënit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Punë e pavarur/Analizë/Bashkëbisedim/Përkufizim

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalitë dhe kërkon që nxënësit të dallojnë foljet në çdo fjalë: Tringës i vdes vëllai i sëmurë / **dhe** ajo del për të luftuar në vend të tij. Mbron nderin, pragon, bukurinë e vet. Trimëria e atdhetaria deri në flijim janë bashkuar / **e** lidhen me një orkestrim të habitshëm e të magjishëm të natyrës. Tringa, në botën poetike të Fishtës, i dorëzohet jo vdekjes, po pavdekësisë.

Nxënësit, me ndihmën e mësuesit/es, analizojnë fjalitë, gjejnë foljet: për fjalinë e dytë folja kallëzues shoqërohet nga tre kundrinorë homogjenë. Nxënësit dallojnë te fjalja e tretë se dy kallëzuesit janë homogjenë, pasi kanë të përbashkët edhe kryefjalën, edhe kundrinorin me parafjalë (me një orkestrim të habitshëm). Pra, janë tri fjali të thjeshta dhe një fjalë i përbërë me bashkërenditje (fjalja e parë).

Duke analizuar fjalitë, nxënësit thonë përkufizimin për fjalinë: si një tërësi fjalësh a një fjalë të bashkuar rreth kallëzuesit që na japin një informacion dhe kanë intonacion të përfunduar.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim dhe reflektim/pyetje-përgjigje

Nxënësit lexojnë për 5 minuta informacionin që jepet në libër për fjalitë e përbëra me bashkërenditje.

Njohuritë që jepen, nxënësit i shprehin me pyetje (në grupe dyshe).

- Si përbëhen pjesët me njëra-tjetrën në fjalitë me bashkërenditje?
- Në sa grupe i ndajmë fjalitë e përbëra me bashkërenditje?
- Si i dallojmë fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga njëra-tjetra?

- Cilat janë lidhëzat që lidhin dy pjesët e bashkërenditura?
- Si i dallojmë për nga kuptimi katër llojet e bashkërenditjes?

Pyetje-përgjigje

Nxënësit i lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe u përgjigjen atyre, duke dhënë shembujt e librit.

- *Turistët shkuan në mal, ndërsa ne qëndruam në qytet.*
- *Beni vraponte dhe Arbri e ndiqte pas.*
- *U mat të thoshte diçka, por nuk foli.*
- *O bëhet kjo punë tani, o nuk bëhet më kurrë.*
- *Iliri kërkoi falje, pra është ndërgjegjësuar për gabimin.*

Nxënësit i lexojnë pyetjet që kanë formuluar dhe u përgjigjen atyre duke dhënë shembujt e librit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me grupe-punë e pavarur

Ushtrimi 1. Përcaktoni llojin e fjalive të bashkërenditura.

Ushtrimi 2. Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse.

Ushtrimi 3. Plotësoni pjesët e fjalive të dhëna me pjesë të bashkërenditura.

Ushtrimi 4. Lidhni pjesët e mëposhtme, përcaktoni llojin e fjalive.

Ushtrimet i punojnë në libër me grupe dyshe, këmbajnë librat dhe qortojnë gabimet e njëri-tjetrit.

Edhe mësuesi/ja kontrollon punën e tyre. Më pas, diskutojnë së bashku saktësinë e zgjidhjes së tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Bëhet vlerësimi për saktësinë e dallimit të fjalive të përbëra, për krahasimin e fjalive të përbëra me bashkërenditje shtuese, kundërshtore, veçuese, përmbyllëse.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 73

Ushtrimi 5. Lidhni fjalitë e thjeshta duke i bashkërenditur me njëra-tjetrën.

Ushtrimi 6. Dalloni lidhëzat dhe tregoni ç'loj pjesësh të bashkërenditura janë fjalitë e mëposhtme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor presjen, duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër; e shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Përdorimi i presjes në fjalitë me bashkërenditje
Fjalët kyçe: përdorim, ndahet me presje, rregulla pikësimi, vihet midis presjesh, fjali.
Rezultatet e të nxënësve për orë mësimore: Nxënësi/ja: - shpjegon rastet e përdorimit të presjes; - dallon presjen në fjali; - përdor drejt presjen në fjali, duke respektuar të gjitha rastet e dhëna në libër; e shkruan saktë në fjali apo në një tekst që krijon vetë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, uebfaqe, fjalor, fotografi të dokumenteve, shkurtesa me ngjyra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Nxënësi/ja zhvillon komunikimin. - Letërsi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Hapi I. Situata e të nxënësve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: <i>Stuhi mendimesh</i> Nxënësit japin disa raste që mbajnë mend për përdorimin e presjes në llojet e fjalive me bashkërenditje: • E kërkoi Benin edhe në shkollë, edhe në palestër, edhe në lagje, por nuk e gjeti. • T’i pranova mendimet e tua, prandaj më dëgjo tani. • T’u kërkosh mendim jo vetëm shokëve, por edhe prindërve. • S’u erdhi mirë nga veprimi yt, kurse unë nuk mendoj ashtu. Nxënësit japin edhe shembuj të tjerë të përdorimit të presjes në llojet e fjalive me bashkërenditje.
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë në grupe/ Pyetje-përgjigje</i> Një nxënës/e lexon në libër rastet e përdorimit të presjes që janë dhënë në dy grupe. Në grupe dyshe, nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit për rastet e përdorimit të presjes, duke dhënë edhe shembuj të tjerë, të ngjashëm me ata të librit. Si do t’i formulojmë rregullat e drejtshkrimit për rastet në libër? - Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat e përsëritura edhe..., edhe; hem..., hem... ; as..., as ... ; o ..., o ... ; ose..., ose... ; ja..., ja...; herë..., herë... Dhe kënga kish mbaruar, / dhe mikrofoni ishte flakur, / dhe vetë këngëtari ndihej shumë i lodhur, / dhe me zor merrte frymë... - Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat dyshe jo vetëm..., por edhe...; le që..., por edhe... Le gomari që na ngordhi, por s’na lënë rehat edhe mizat. - Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat kundërshtore po (por), kurse, ndërsa, veçse, veç, vetëm se... Në mëngjes zgjohej qëmenatë, kurse në mbrëmje e zinte gjumi herët. - Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzat përmbyllëse prandaj, andaj, ndaj: Kishin veshur atlete, prandaj nuk u dëgjua zhurma e tyre. - Fjalitë e bashkërenditura me lidhëzën pa: Ta kisha parë edhe një herë, pa ç’të ishte!

Punë në grupe Në grupe dyshe, nxënësit zhvillojnë lojën mësimore: një nxënës/e thotë rregullin, tjetri/a jep shembujt; këmbëjnë rolet: ai/ajo që tha shembujt, thotë rregullin e kështu me radhë.

II. Ndahen me presje:

- Fjalitë e varura që ndodhen para kryesores: Sa kishte folur, as ai vetë s’e dinte. Ç’të mbjellësh, do të korrësh.
- Fjalitë e varura me përemrat lidhorë që, i cili dhe me ndajfoljen ku, kur vijnë pas kryesores: Nisën të ndihen erëra të lagështa, që dukej se do të sillnin shiun.
- Fjalitë e varura me lidhëzat aq sa dhe kështu që, kur vijnë pas kryesores: Bukë s’kishim ngrënë, kështu që na u desh të nxitonim.
- Fjalitë e varura me lidhëzat në, po, nëse, në qoftë se, në rast se, sikur, kur, po qe se, me kusht që, kur vijnë pas kryesores: Ne do të mbeteshim pa folur, po të mos na kishte tërhequr vëmendjen mësuesja.
- Fjalitë e varura me lidhëzat megjithëse, ndonëse, sado që, sido që, edhe pse, kur vijnë pas kryesores: Askush nuk e mendoj rrezikun, ndonëse rruga ishte me rreze të shumta.
- Fjalitë e varura me lidhëzat: përveç që, në vend që, kur vijnë pas kryesores: Me hallin tim, unë i mërzita të gjithë, në vend që t’i kisha lënë të qetë.
- Fjalitë e bashkuara pa lidhëza: Verës, malin e përcëllon dhe e kris dielli, dimrit e pëlçet ngrica, stinëve të tjera e lajnë dhe e gërryejnë rrëketë.

Në grupe dyshe, nxënësit zhvillojnë lojën mësimore: një nxënës/e thotë rregullin, tjetri/a jep shembujt; këmbëjnë rolet: ai/ajo që tha shembujt, thotë rregullin e kështu me radhë.

Ndahen nxënësit në 4 grupe dhe në tabelë shkruajnë me bojëra uji 4 rregullat e përdorimit të presjes dhe i afishojnë në muret e klasës, ku do të qëndrojnë gjatë gjithë orëve të drejtshkrimit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

Vihet midis presjesh:

- Fjalitë e varur që futet në mes të fjalisë kryesore: Kënga e saj, sado që u interpretua bukur, nuk më la mbresa.
- Fjalitë e varur që hyn në mes të një fjalisë të bashkërenditur ose të varur: Nëna u bë merak, por, kur mësoi të vërtetën, u qetësua.

Nuk ndahen me presje:

- Fjalitë e varura me lidhëzat sa (ç’), se, sesa, se ç’, nga sa, nga ç’, kur kanë lidhje me një mbiemër a ndajfolje në shkallën krahasore: Ishte një këngë aq e bukur sa nuk doja të përfundonte.
- Fjalitë e varura me lidhëzat ku, tek, nga, kudo që, ngado që, që vijnë pas kryesores, kur plotësojnë foljen ose ndajfoljet aty, atje, këtu, andej etj. Atij iu duk sikur po fluturonte. Nga ata kërkohej të ishim gati në çdo kohë. Të kujtohet si prisnim me orë të tëra lajme nga perëndimi?

Ushtrimi 1: Klasa e shkruan saktë tekstin në fletore, qortojnë gabimet e njëri-tjetrit në përdorimin e pikës, presjes, shkronjës së madhe.

Ushtrimet 2, 3, 4: Nxënësit i plotësojnë në libër në grupe dyshe, mësuesi/ja kontrollon punën e tyre. I përsëritin rastet e përdorimit të presjes.

Ushtrimi 5: Nxënësit në grupe dyshe punojnë me pjesën “Ciklopi” që e kanë në tekst, nënvizojnë rastet e përdorimit të presjes dhe thonë cilës rregull i përket. Pasi mbarojnë, lexojnë rastet, argumentojnë mendimet.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i nxënësve do të jetë në vijimësi të vlerësimeve të motivuara gjatë orës së parë. Nisur nga shkalla e arritjeve të rezultateve të të nxënësve, nxënësit do të vlerësohen me notë.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Shkruani një shkrim të shkurtër me temë “Dita ime”, duke ndërtuar fjali me rastet e përdorimit të presjes.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Tekst rrëfyes			Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Nanë e dashtun!				
Fjalët kyçe: Nana, letra, Ajshe, Jusuf Gërvalla.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon letrën si lloj i tekstit joletrar; - njeh jetën dhe veprimtarinë patriotike të Jusuf Gërvallës; - merr njohuri për mesazhin që duhet të përmbajë letra si tekst joletrar.				
Kriteret e suksesit: Kupton letrën si lloj i tekstit joletrar. Analizon nëpërmjet ushtrimeve elementet e thurjes/ndërtimit të një letre. Shkruan një letër.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 8, interneti, fleta, shënjes, tabela.				

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatëorës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim/Pema e mendimit

Mësuesi/ja pyet nxënësit: Përveç teksteve letrare dini se çfarë tekste tjera mund të ketë?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre, të cilat mësuesi/ja i mban shënim në tabelë.

Kronika, intervista, biografi, shënime udhëtimi, letra, ligje, receta, artikuj, ese shkencore, enciklopedi, udhëzues të ndryshëm etj.

Mësuesi/ja plotëson në dërrasë të zezë pemën e mendimeve.

Tekstet joletrare kanë përmbajtje reale, nuk janë të trilluara. Tregojnë fakte dhe përshkruajnë rrethana apo objekte për qëllime funksionale të cilat lidhen me fushën e dijes për të cilën bëhet fjalë në tekst.

Tregojnë ngjarje reale që kanë në qendër njerëz real (kronika, shënime udhëtimi, biografi, intervista, ditarët).

Paraqesin të dhëna dhe informacione (njoftime, zëra nga enciklopeditë, raporte, relacione, fjalorë etj.).

Udhëzojnë, këshillojnë, urdhërojnë për të mbajtur qëndrime të caktuara (udhëzime, urdhra, receta, ligje, rregullore etj.).

Argumentojnë, duke u mbështetur ose kundërshtuar ide, opinione, fakte (ese, artikuj, fjalime me karakter nga jeta sociale, ekonomike, politike etj.).

Përshkruajnë njerëz, vende, kafshë, objekte (guida turistike, enciklopedi, tekste shkencore etj.).

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia/Pyetje-përgjigje/Diskutim

Para se të lexohet letra “Nanë e dashtun”, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se:

Letra përmban një mesazh të shkruar për të përcjellë informacion në distancë. Letrat ndahen në dy lloje: letra formale dhe letra joformale. Letrat formale janë letra zyrtare që i drejtohen një personi apo një institucioni për qëllime të ndryshme. Letrat joformale (jozyrtare) janë letra që i drejtohen një miku, një të afërmi ose një të njohuri. Letrat formale duhen shkruar, duke respektuar jo vetëm strukturën, por edhe formulat e duhura për t’iu drejtuar marrësit dhe për të mbyllur letrën. Gjuha duhet të jetë sa më e qartë, pa dykuptimësi dhe pa shkurtime. Si rregull, letrat formale duhen shkruar në shqipen standarde. Nga ana tjetër, letra joformale është intime dhe ka një gjuhë të figurshme, që ngjan me gjuhën e ligjërit bisedor. Letra joformale mund të mos ndjekë rregullat e shqipes standarde.

Fillon leximi i letrës joformale “Nanë e dashtun”, gjatë leximit, mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve të fjalët “*rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njerin. Dhe kush u mundue për nder, nder ka gjetë!*”. Pasi lexohet letra, nxënësit bëjnë zbërthimin e fjalëve të panjohura. Kjo letër është e shkruar në gjuhën dialektore. Është letër joformale/personale. Këtu kemi të bëjmë me letrën e patriotit Jusuf Gërvalla, të cilën ai ia kishte dërguar nënës së tij gjatë kohës kur ishte në burg.

Nxënësit nën udhëheqjen e mësuesit/es punojnë pyetjet e parashtuara në rubrikën Kuptojmë tekstin, për të vazhduar pastaj në grupe me pyetjet tjera. Grupi I - Analizojmë tekstin Grupi II - Interpretojmë tekstin Grupi III - Gjuha e tekstit Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit Në këtë fazë, nxënësit do të punojnë ushtrimet 12 dhe 13 - <i>Reflektojmë rreth tekstit</i>. Çfarë thuhet në tekst për indiferentët? Ju si mendoni, “a vyen me luftue për nder”? Bashkëbisedoni duke ndarë histori personale ose familjare të njerëzve që kanë luftuar për nderin dhe lirinë e tyre. Nxënësit do të paraqesin idetë dhe mendimet e tyre personale. Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur	<i>Shiko Fletore pune, f. 38</i>
Shkruani një ese me titull “Kush u mundue për nder, nder ka gjetë!”. Shkruani një letër për një njeri të shtrenjtë të familjes.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Tekst rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Idiz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë			
Fjalët kyçe: Idriz Ajeti, albanolog, Kosovë.			

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Nxënësi/ja: – diskuton për formën e organizimit të biografisë; – ilustron një biografi; – gjykon dhe arsyeton interpretimin, qëllimin dhe rëndësinë e biografisë. Kriteret e suksesit: Analizon formën e organizimit të biografisë si një tekst joletrar. Shfaq ide dhe mendime për përgatitjen e një autobiografie. Zbulon dhe zbërthen nëntekstin e titullit të autobiografisë.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ja.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikim me terma paraprakë Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe si: sot, u nda nga jeta, albanologji, babai, Kosovë, gjuha, shqipe, humbje... dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një shkrim të shkurtër me termat paraprake dhe të përdorin edhe fjalë shpesh për të krijuar një shkrim të shkurtër. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës/e prezantojnë shkrimet e tyre. Mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se teksti të cilin do të mësojnë, është një tekst i shkruar nga shkrimtari i njohur kosovar, Sabri Hamiti, dhe është një tekst i shkurtër përkujtimor e biografik për vlerat e personalitetit të gjuhësisë shqiptare, albanologut Idriz Ajeti, i cili u nda nga jeta në moshën 102-vjeçare, më 13 shkurt të vitit 2019.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim artistik/Marrëdhënia pyetje-përgjigje Në këtë fazë, mësuesi/ja mund të përzgjedh 3 nxënës/e, të cilët kanë aftësi në të lexuarin artistik, t'u ndajë tekstin dhe ta lexojnë para klasës. Pas leximit, shpjegohen fjalët e panjohura dhe të gjithë si klasë me ndihmën e mësuesit/es punojnë ushtrimin 1/kuptojmë tekstin. Pastaj, mësuesi/ja formon 3 grupe nxënësish dhe ndan detyrat. Grupi I - Analizojmë tekstin; Grupi II - Interpretojmë tekstin; Grupi III - Gjuha e tekstit Nxënësit, pasi të kenë përfunduar detyrat, paraqesin para klasës përgjigjet, mendimet dhe sugjerimet e tyre. Ata mund të bashkëpunojnë dhe të japin mendimin e tyre për përgjigjet e shokëve dhe shoqeve. Mësuesi/ja, nëse është e nevojshme, bën ndërhyrjet e duhura.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/Puno në dyshe/Tregoju të tjerëve Nxënësit do të punojnë në grupe dyshe detyrat 10 dhe 11 të rubrikës reflektojmë rreth tekstit. Pasi të kenë përfunduar detyrat, secili grup dysh përfaqësohet me një diskutim, ku prezanton idetë e veta për përgjigjet e dhëna. Kjo teknikë është mjaft e përshtatshme për të reflektuar rreth pjesës që nxënësit kanë lexuar dhe punuar më parë. Ndihmon nxënësit t'u japin formë mendimeve të tyre.	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 39</i>	
1. Kërkoni dhe gjeni më tepër informacion rreth jetës, veprës shkencore dhe veprimtarisë patriotike të Idriz Ajetit. Të dhënat që do të mblidhni, shkruajini në formën e një biografie për shkrimtarin. 2. Gjeni informacione rreth Konsultës së Prishtinës dhe Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënës të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje ffilluese: kryefjalore, kundrinore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënësi i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje ffilluese: kryefjalore, kundrinore			
Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, kryefjalë, kundrinor, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.			
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Nxënësi/ja: – dallon pjesën e nënrenditur ffilluese: kryefjalore, kundrinore në një fjali të përbërë; – dallon paraprijësin në pjesën kryesore; – analizon mjetin lidhës me anë të së cilit lidhen pjesët e fjalisë; – argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e nënrenditura ffilluese: kryefjalore, kundrinore në fjali e si ndahet me presje ajo.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Hapi I. Situata e të nxënës Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Organizues grafik Nxënësit përqendrohen të organizuesi grafik, që mësuesi/ja e jep në tabelë për fjalitë e përbëra me nënrenditje ffilluese: kryefjalore, kundrinore. Rikujtojnë ato që kanë mësuar më parë për të.			

Fjalitë e përbëra me nënrenditje filluese	Ç'tregon?	Ku bën pjesë?	Me se shprehet?	Me ç'pyetje gjendet?	Ç'vend zë në fjali?
Kryefjalore					
Kundrinore					

Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi/ja, diskutojnë rreth plotësimit të organizuesi grafik, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM

Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi/ja, diskutojnë rreth plotësimit të tabelës së koncepteve, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Nxënësit punojnë në grupe dyshe me tekstin, njihen me informacionin e ri për fjalitë e përbëra me nënrenditje filluese: kryefjalore, kundrinore. Qëndrojnë 10 minuta, që të nxjerrin të reja që prezanton mësimi i ri nga ai i vitit të kaluar: Fjala drejtuese e tyre, emër, folje. Diskutojnë dhe analizojnë shembujt me fjali që jepen në libër, japin shembuj të tjerë, të ngjashme me to. Mësuesi/ja i udhëzon si ta dallojnë fjalinë e përbëra me nënrenditje filluese: kryefjalore, kundrinore, edhe nga kuptimi që shprehin.

<i>Roli i pjesës së nënrenditur</i>	<i>Mjeti lidhës</i>	<i>Pozicioni në fjali i pjesës së nënrenditur</i>	<i>Përdorimi i presjes</i>
Në këto fjali, pjesa e varur është e lidhur ngushtësisht me kallëzuesin e pjesës kryesore, si pjesë e domosdoshme e tij. Për të kuptuar këtë lloj lidhjeje, së pari kujtojmë se edhe në fjalinë e thjeshtë, kallëzuesi, kërkon një numër të caktuar gjymtyrësh të domosdoshme, në varësi të llojit të foljes me të cilën shprehet.	<i>që, se</i> , por mund të bashkohen edhe pa lidhëza...	Në rastet më tipike qëndron para pjesës kryesore.	Ndahet gjithmonë me presje.
Tabela e tipareve dalluese të fjalive të përbëra me nënrenditje.			

Plotësohet tabela nga nxënësit. Në rast se nxënësit kanë paqartësi, shpjegohen nga mësuesi/ja. Sugjerim! Punoni me këtë metodë, pasi kjo i bën nxënësit më aktivë në dhënien e mendimeve në fazën e parë dhe “detyron” nxënësin në fazën tjetër të mësimin të bëjë pyetje se çfarë duan të dinë rreth fjalisë së përbërë me nënrenditje filluese: kryefjalore, kundrinore dhe të punojë me tekstin deri në detaje. Në rastet më të shumta, nxënësit dëgjojnë shpjegimin e mësuesit/es për temën e re.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe-Rrjeti i diskutimit

Nxënësit punojnë me ushtrimet e më pas diskutojnë rreth tyre.

Ushtrimi 1. Plotësoni shembujt e dhënë me nga një pjesë të varur kryefjalore.

Ushtrimi 2. Plotësoni shembujt e dhënë me nga një pjesë të varur kundrinore.

Ushtrimi 3. Në fjalitë filluese të mëposhtme, gjeni pjesën kryesore dhe pjesën e varur, duke përcaktuar llojin e saj.

Ushtrimi 4. Ktheni fjalitë pyetëse në pjesë të varura filluese të një fjalie të përbërë.

Shembull: Fjali pyetëse: Sa është ora? Pjesë e varur filluese: Nuk e di sa është ora.
Nxënësit vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimin. Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalive të përbëra me nënrenditje filluese: kryefjalore, kundrinore në tekste të ndryshme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 74

Ushtrimi 5, fq. 254 - Plotësoni tabelën sipas modelit të dhënë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimin.


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore: kohore, vendore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË QË ZHVILLOHEN TE NXËNËSI/JA: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kohore, vendore
Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, rrethanor, kohore, vendore, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: – dallon fjalitë e varura me nënrenditje, rrethanore: kohore dhe vendore; – analizon fjalitë me nënrenditje, rrethanore: kohore dhe vendore; – krahason fjalitë me nënrenditje rrethanore: kohore dhe vendore; – gjykon rreth fjalive të dhëna në tekst, duke argumentuar përgjigjen e tij; – argumenton zgjerimin dhe ngushtimin e fjalive.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti mësimor, <i>webfaqe</i> , Fjalori i Gjuhës Shqipe, shkurtesa me ngjyra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diagram Veni Nxënësit në grupe dyshe punojnë me diagramin e Venit për kundrinorët dhe rrethanorët:

Janë gjymtyrë të dyta,
por janë plotës kryesorë.
U përgjigjen pyetjeve me përemra
Shprehet me emër, GE, përemër

Janë gjymtyrë të dyta,
por jo plotës kryesorë.
U përgjigjen pyetjeve me ndajfolje
Shprehen me ndajfolje, emër, GE



- Janë gjymtyrë të dyta
- Formojnë GF me kallëzuesin
- Shprehen me emër, GE

Kur nxënësit mbarojnë, raportojnë punën, mësuesi/ja e plotëson diagramin, duke e shkruar në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Pyetje-përgjigje

Nxënësit punojnë në dyshe në libër dhe me njëri-tjetrin, u përgjigjen pyetjeve:

- Çfarë shpreh rrethanori?
- Ç'gjymtyrë e fjalisë është?
- Ç'fjalë drejtuese mund të ketë?
- Ç'vend zë në fjali?
- Sa lloje rrethanorësh njihni?
- Me se shprehet rrethanori i vendit? Po i kohës?
- Jep nga një shembull për çdo rrethanor.

Punë në grupe

E ndajmë klasën në pesë grupe dhe nxënësit përgatiten për t'ju përgjigjur pyetjeve. Mësuesi/ja kontrollon punën e grupeve, kush është gati, jep përgjigjet. Të tjerët dëgjojnë duke pasur parasysh organizuesin grafik, që mësuesi/ja e ka përgatitur si fletë pune ose e shkruan në dërrasë.

Çështja	Pyetja për t'u bërë	Çfarë tha folësi	Shënime
Fjalitë e varura rrethanore tregojnë rrethanën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja e pjesës kryesore.			
Fjalitë me pjesë të nënrenditur kohore.			
Fjalitë me pjesë të nënrenditur vendore.			

Grupet e tjerë mbajnë shënime për përgjigjet e grupit që flet, çfarë tha folësi, kanë mendime të ndryshme apo të kundërta, kanë vërejtje, drejtojnë pyetje etj. Mësuesi/ja ndjek me vëmendje diskutimin, por edhe debatin dhe vëren sa të vëmendshëm kanë qenë nxënësit në studimin e tekstit dhe si i lidhin njohuritë e mëparshme me ato të reja.

Sipas tabelës, shprehin mendime edhe përfaqësuesit e grupeve të tjera.	
Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.	
Ushtrimi 1. Plotësoni tabelën e mëposhtme, pasi të keni bërë dallimin mes rrethanorëve të kohës dhe fjalive të varura kohore.	
Ushtrimi 2. Plotësoni tabelën e mëposhtme, pasi të keni bërë dallimin mes rrethanorëve të vendit dhe fjalive të varura vendore.	
Ushtrimi 3. Bëni dallimin mes fjalive të varura fthilluese dhe atyre kohore. Analizoni rolin e fjalës “kur”.	
Ushtrimi 4. Zëvendësoni rrethanorët me fjalinë e varur përkatëse. Lexojnë disa nxënës fjalitë që kanë plotësuar sipas kërkesave, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.	
Vlerësimi i nxënësve:	
Bëhet vlerësimi i nxënësve për saktësinë e dallimit të fjalive të thjeshta nga ato të përbëra, për përdorimin e fjalive të përbëra me nënrenditje rrethanore të kohës dhe të vendit etj.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	<i>Shiko Fletore pune, f. 76</i>
Ndërtoni gjashtë fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura rrethanore: kohore, vendore.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Tekst rrëfyes			Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerr idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET				

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË**IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS****Aspektet specifike të planit të orës mësimore****Njësia mësimore:** Erza, shqiptarja me famë botërore nga muzika drejt kinematografisë**Fjalët kyçe:** Erza, këngëtare, yll.**Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- dallon intervistën si lloj i tekstit joletrar;
- rrit frymën e bashkëpunimit në grup duke vlerësuar/respektuar mendimin e shokëve/shoqeve;
- jep mendimin e tij/saj mbi efektin që përcjell te lexuesi/dëgjuesi intervista dhe shpjegon qëllimin e intervistës kushtuar Erza Muqollit.

Kriteret e suksesit:

Kupton intervistën si lloj i tekstit joletrar.

Analizon elementet ndërtimore të intervistës si tekst joletrar rrëfimtari.

Shkruan një intervistë, duke u mbështetur në udhëzimet dhe informacionet e fituara gjatë orës mësimore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital-Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja parashtron pyetjen nxënësve: A mund të tregoni se cilat lloje të shkrimeve joletrare përdoren për të shkruar gazetat? Nxënësit, duke rikujtuar njohuritë nga mësimet e mëparshme, do të shpërthejnë me përgjigjet e tyre: Biografia, autobiografia, intervistat, artikujt, kronikat, letrat etj. Pikërisht sot do të zgjerojmë njohuritë për intervistën si tekst rrëfimtari joletrar- mund t'u drejtohet mësuesi/ja nxënësve. Për këtë njësi mësimore, mësuesit mund të përdorin edhe projektorin (në mungesë të projektorit mund të shërbehen me celularët e tyre).

Mësuesi/ja shpjegon, plotëson dhe saktëson njohuritë e nxënësve për intervistën.

Intervista është bisedë në formë dialogu mes një gazetari dhe një personi, e cila realizohet përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Intervista botohet në shtyp ose transmetohet në radio a në televizion. Teksti i intervistës konsiderohet rrëfyes, ku i intervistuari rrëfen rreth përvojave dhe qëndrimeve të tij personale.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia/Pyetje-përgjigje/Diskutim

Para leximit të intervistës “Erza, shqiptarja me famë botërore nga muzika drejt kinematografisë”, mësuesi/ja, duke u mbështetur te rubrika para leximit, njofton nxënësit se si fëmijët e suksesshëm me sukseset e arritura bëjnë kombet e tyre të ndihen krenarë. Dy nxënës/e lexojnë intervistën dhe pastaj së bashku me mësuesin/en, nëpërmjet metodës pyetje -përgjigje, u japin përgjigje pyetjeve të ushtrimeve në tekst.

Klasa ndahet në grupe dhe punon detyrat e caktuar nga mësuesi/ja.

Grupi I - Kuptojmë tekstin

Grupi II - Analizojmë tekstin

Grupi III - Interpretojmë tekstin Grupi IV - Gjuha e tekstit Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para shokëve/shoqeve në klasë. Nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Mendo/Puno në dyshe/Tregoj të tjerëve Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të punojnë në dyshe. Ata/ato duke lexuar udhëzimet e mëposhtme në tekstet e tyre, te rubrika <i>Detyrë</i> do të zhvillojnë një intervistë me shokun ose shoqen e klasës, duke luajtur rolin e gazetarit dhe të një personazhi të famshëm. Në përfundim, çdo grup dysh do të prezantojë idetë e veta për zgjedhjet e tyre.	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur	<i>Shiko Fletore pune, f. 41</i>
Nxënësit do të kryejnë detyrat 13, 14 dhe 15 të rubrikës <i>Reflektojmë rreth tekstit</i> dhe detyrën: <i>Intervistoni prindërit rreth kujtimeve të tyre shkollore. Pyetjet dhe përgjigjet shkruajini në fletore.</i>	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Tekst rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Gjirokastra			

Fjalët kyçe: Gjirokastra, antik, mesjetar, mrekulli.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përshkruan tekstin rrëfyes, duke u bazuar në tekstin shkollorë/videoprojekt;
- dallon tekstin rrëfyes si tekst jolettrar;
- analizon monumentet e rëndësishme të qytetit të Gjirokastrës.

Kriteret e suksesit:

Kupton shkrimin e tekstit rrëfyes.

Vlerëson tekstin e lexuar, duke u ndalur te vlerat historike që sjellë.

Shkruan një tekst rrëfyes për Gjirokastrën, duke hulumtuar dhe mbledhur informacione të sakta.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 8, interneti, fleta, shënjes, tabela.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Prezantim digjital/Kllaster

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Gjirokastra”. Pastaj udhëzon të shikojnë një reportazh të përgatitur për Gjirokastrën dhe me videoprojektor (në mungesë, mësuesi/ja përdor celularin) shfaqë pjesën e zgjedhur për nxënësit.

Pastaj, nxënësit udhëzohen të krijojnë një *Kllaster* për qytetin e Gjirokastrës, duke u bazuar në reportazhin e dhënë ose në tekstin shkollor. P.sh.:



Gjithsesi, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se Gjirokastra është edhe vendlindja e shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare.

Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një-Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se teksti është një udhëpërshkrim i Elvija Çelebiut. *Në nëntor të vitit 1670, udhëtari turk, Evlija Çelebiu, pas një udhëtimi nëpër Kosovë në dhjetor të vitit 1660, dhe një udhëtimi në Shqipërinë e Veriut dhe në Malin e Zi në shkurt të vitit 1662, filloi udhëtimin e tij të tretë dhe më të gjatë në trevat shqiptare. Kësaj radhe, ai hyri në Shqipëri nga jugu. Pas një qëndrimi të shkurtër në Delvinë, Zhulat dhe Kardhiq, ai erdhi në qytetin e Gjirokastrës (turqisht Ergiri), ku u habit shumë nga zakonet e gjirokastritëve. Ja dhe përshkrimi i vizitës së tij në atë qytet para më shumë se treqind viteve...*

Klasa ndahet në grupe:

Grupi I - Diskutues: Pasi kanë lexuar tekstin, përfaqësuesi i grupit prezanton para shokëve/shoqeve udhëpërshkrimin e lexuar për qytetin e Gjirokastrës. Përshkruan vendin, zakonet dhe monumentet historike që ndodhen në Gjirokastrë. Po ashtu, edhe përshtypjen e tyre për udhëpërshkrimin e lexuar.

Grupi II - Afinitet: Ky grup udhëzohet që pasi ta ketë lexuar tekstin, të krijojnë pyetje për nxënësit e tjerë për detyrë shtëpie, duke u bazuar në mangësitë që ka teksti dhe çfarë të dhëna do të sjellin orën tjetër që teksti të plotësohet.

Grupi III - Kritikët: Pasi kanë lexuar tekstin, përfaqësuesi i grupit duhet të prezantojë para shokëve/shoqeve mendimet pozitive për udhëpërshkrimin, po ashtu mund të paraqesin edhe ndonjë mendim negativ nëse kanë, por çdo herë duke u bazuar me komentet e tyre, duke dhënë arsyetimet e mendimeve.

Para se nxënësit të udhëzohen për detyrën, punojnë së bashku me mësuesin/en detyrat te rubrika *Kuptojmë tekstin*. Pastaj ashtu siç janë në grupe, nxënësit punojnë:

Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet 1 dhe 2.

Grupi II - Interpretojmë tekstin, ushtrimet 4 dhe 5.

Grupi III - Gjuha e tekstit, ushtrimet 6 dhe 7.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.

Nxënësit do të punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Pastaj të gjithë si klasë reflektojnë rreth tekstit, duke dhënë përgjigjet për ushtrimet 8 dhe 9.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim grupor

Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë në grupet e tyre me shokët/shoqet e grupit dhe të diskutojnë për pyetjet e tekstit.

Puna në grup.

*Vizatoni një hartë dhe shënoni mbi të vendet që keni vizituar, madje përshkruajini këto udhëtime.

*Rrëfëni në grupe nga një histori interesante që lidhet me ato që ju kanë ndodhur gjatë udhëtimeve tuaja.

*Diskutoni dhe shprehni ide, opinione, mbresa për ekskursionet që keni zhvilluar së bashku me mësuesit/et dhe klasën tuaj.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 42

Gjeni informacion për monumentet e kulturës në Gjirokastrë, që përbëjnë vlerë për trashëgiminë kulturore shqiptare. Cilat objekte përmenden edhe në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebiut, duke i rezistuar kështu peshës së shekujve?

Kjo detyrë duhet të prezantohet në orën tjetër mësimore, mësuesi/ja mund të zhvillojë një garë mes nxënësve, duke kërkuar që të zgjidhet udhëpërshkrimi më i bukur (i shkruar me stil dhe i argumentuar).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komuni kimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje shkakore, qëllimore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: shkakore, qëllimore			
Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, rrethanor, shkakore, qëllimore gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon pjesët e nënrenditura në fjalitë e përbëra shkakore dhe qëllimore; - dallon mjetet lidhëse, lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore, që lidhin pjesën kryesore dhe të nënrenditur; - analizon pozicionet e pjesëve të nënrenditura, në raport me pjesën kryesore; - argumenton përdorimin e presjes që lidh pjesët në fjalitë e përbëra me nënrenditje.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti mësimor, <i>webfaqe</i> , Fjalori i Gjuhës Shqipe, shkurtesa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Bashkëbisedim <i>Cili prej jush thotë se cila është marrëdhënia që vendoset midis pjesëve në fjalitë dhe vargjet e mëposhtme?</i> <i>Toka punohej mirë, se ishte gjithë vlagë dhe e qëruar nga gurët.</i> <i>Dilnin çdo mbrëmje për shëtitje, që të merrnin ajër të pastër.</i> <i>Në mes tuaj kam qëndruar</i>			

*e jam duke u përvëlur,
që t'u ap pakëzë dritë,
natënë t'ua bënj ditë.
Do të tretem, të kullohem,
të digjem, të përvëlohem,
që t'u ndrinj mir' e të shihni,
njëri-tjatërin të njihni.*

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela INSERT

+	V	—	?
Pjesa e nënrenditur qëllimore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren. 1) Vendoset pas pjesës kryesore: Toka duhet mirëmbajtur, në mënyrë që të mos i kundërvihet njeriut. 2) Vendoset para pjesës kryesore: Me qëllim që të mos i kundërvihet njeriut, toka duhet mirëmbajtur. 3) Vendoset në mes të pjesës kryesore: Toka, që të mos i kundërvihet njeriut, duhet mirëmbajtur.	Mes pjesëve të fjalive me nënrenditje shkakore vendoset marrëdhënia shkak-pasojë. Pjesa e varur shpreh shkakun apo arsyen e asaj që thuhet në pjesën kryesore.		
Si mjet lidhës për pjesët e fjalive qëllimore, zakonisht shërben lidhëza që, e cila shpeshherë mund të mos jetë e pranishme, kur pjesa e varur fillon me folje në mënyrën lidhore.			
Pjesa e nënrenditur shkakore mund të ketë tri pozicione në lidhje me kryesoren. 1) Vendoset pas pjesës kryesore: Fluturimet kishin vonesë, ngaqë ishte ngricë e madhe.			

2) Vendoset para pjesës kryesore: <i>Ngaqë ishte ngricë e madhe, fluturimet kishin vonesë.</i>			
3) Vendoset në mes të pjesës kryesore: Fluturimet, <i>ngaqë ishte ngricë e madhe, kishin vonesë.</i>			

Udhëzohen nxënësit të hapin tekstet dhe të plotësojnë tabelën e dhënë.

Nëse ka ndonjë paqartësi, shpjegohet nga mësuesi/ja.

Ndërtoni fjali shkakore, duke përdorur lidhjet e mëposhtme.

vonë / humbas trenin: Nëse do të jem vonë, do të humbas trenin.

nuk flet / nuk njih gjuhën: Rri i heshtur e nuk flet, për shkak se nuk e njih gjuhën.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Zëvendësoni rrethanorët e shkakut me pjesë të varura shkakore.

Gjethet binin nga era.

Gjethet binin, për shkak se frynte erë.

Të shkurajuar nga vështirësitë, hoqën dorë nga ky mision.

Ata hoqën dorë nga ky mision, ngaqë ishin të shkurajuar nga vështirësitë.

Ata e humbën lojën nga një pakujdesi e vogël.

Ata e humbën lojën, sepse u treguan të pakujdesshëm.

Nuk dilet në rrugë, për shkak të trafikut të rënduar.

Nuk dilet në rrugë, sepse është rënduar trafiku.

Nxënësit punojnë me ushtrimin:

Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të trajtoni çështje që mbartin situatë shkak/pasojë dhe tregojnë rrethana qëllimore. Vëreni si reflektohen ato në fjalitë që keni përdorur. Përdorni lidhëza, si: *se, sepse, ngaqë, meqë, duke qenë se, për shkak se, nga frika se; që, me qëllim që, në mënyrë që* etj.

*Kujdes! Duhet t'i udhëzoni nxënësit që përcaktimi i lidhëzës nuk është kryesore për të caktuar llojin e fjalisë, por duhet të shikojnë rolin e tyre në fjali!

Mund të ndodh që lidhëza *që* të përdoret për të lidhur fjali qëllimore, fjali përcaktore, fthilluese !

Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 1. Ndërtoni pesë fjali shkakore, duke përdorur lidhjet e mëposhtme.

Ushtrimi 2. Zëvendësoni rrethanorët e shkakut me pjesë të varura shkakore.

Ushtrimi 3. Ktheni format foljore të pashtjelluara në pjesë të varura qëllimore.

Ushtrimi 4. Rishkruani tekstin në gjuhë standarde dhe analizoni mënyrën e shprehjes së marrëdhënieve shkakore e qëllimore në të dy variantet.

Ushtrimi 5. Dalloni marrëdhëniet shkakore dhe qëllimore mes fjalive dhe gjymtyrëve të tyre. Analizoni format e ndryshme të shprehjes së tyre. Plotësoni tabelën e mëposhtme.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për zëvendësimin e rrethanorëve të shkakut me pjesë të nënrenditura shkakore, për analizën e pjesëve të fjalisë së përbërë me nënrenditje shkakore dhe qëllimore etj.

Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 77
Ushtrimi 6. Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të trajtoni çështje që mbartin situata shkak/pasojë dhe tregojnë rrethana qëllimore. Vëreni si reflektohen ato në fjalitë që keni përdorur. Përdorni lidhëza, si: <i>se, sepse, ngaqë, meqë, duke qenë se, për shkak se, nga frika se; që, me qëllim që, në mënyrë që</i> etj.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: rrjedhimore me anë të lidhëzave, por edhe nga kuptimi që shprehin. Formon vetë fjalitë me nënrenditje mënyrore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethimore: rrjedhimore (ora e dytë)			
Fjalët kyçe: Fjali e përbërë, pjesë kryesore, pjesë e nënrenditur rrjedhimore, mjet lidhës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon pjesën e nënrenditur rrjedhimore në një fjali të përbërë; - analizon mjetin lidhës me anë të së cilit lidhen pjesët e fjalisë; - argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e nënrenditur rrjedhimore në fjali dhe si ndahet me presje ajo.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencorë, fjalor, foto të dokumenteve, video...			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:**Hapi I. Situata e të nxënës****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Bashkëbisedim**

Diskutohet detyra e shtëpisë e dhënë një orë më parë. Nxënësit diskutojnë së bashku. Ata vlerësojnë mendimet e njëri-tjetrit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e Koncepteve

Fjalitë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore			
Roli që luan pjesa e nënrenditur	Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës	Pozicioni i pjesës së nënrenditur	Përdorimi i pjesës
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore, shprehet marrëdhënia mes aktit a ngjarjes së shprehur në fjalinë kryesore dhe përfundimit logjik të saj, të shprehur në fjalinë e varur.	Lidhëza nënrenditëse rrjedhimore <i>ndaj</i> . Krahë saj, si mjete lidhëse mund të shërbejnë edhe lidhëzat: <i>sa, sa që, aq sa, që, kështu që</i> etj.	Pjesa e varur RRJEDHIMORE mund të qëndrojë pas pjesës kryesore, gjithmonë.	Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa kryesore.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me dyshe

Nga çdo dy fjali të thjeshta, formoni dhe shkruani një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.

Era ishte shumë e fortë, aq sa ajo përmbysi vazot e luleve.

Ky ishte një argument i fortë, kështu që Drini nuk do të kundërshtonte më.

Drita ishte e dobët, saqë rruga nuk dukej.

Analiza ishte e imtësishme, kështu që zgjati tetë orë.

Fëmijët bënë zhurmë, kështu që studiuesi u çorientua.

Plotësoni pjesët e mëposhtme, duke i kthyer në fjali të përbëra rrjedhimore.

E kishte bërë modë gënjeshtren, kështu që askush nuk i besonte më.

Kishte vrapuar shumë, aq sa nuk mbushej dot me frymë.

Nxënësit, në grupe dyshe, punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 3. fq. 262. Dalloni rrethanorët nga fjalitë me pjesë të nënrenditur rrethanore. Plotësoni tabelën.

Ushtrimi 4. Nga çdo dy fjali të thjeshta, formoni dhe shkruani një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.

Ushtrimi 5. Plotësoni pjesët e mëposhtme, duke i kthyer në fjali të përbëra rrjedhimore.

Ushtrimi 6. Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Analizoni këto të fundit.

Ushtrimi 7. Hartoni një tekst të shkurtër ku fjalitë të shprehin marrëdhënie mënyrore dhe rrjedhimore.

Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse si dhe mjetet e lidhjes.

Disa nga nxënësit lexojnë fjalitë që kanë plotësuar sipas kërkesave, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësohen nxënësit për analizën që u bëjnë fjalive me pjesë të nënrenditur rrjedhimore.
Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 79</i>
Hartoni një tekst të shkurtër ku fjalitë të shprehin marrëdhënie rrjedhimore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse si dhe mjetet e lidhjes.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekstet informuese-paraqitëse		Rezultati i të nxënit të temës: Rrëfen për ngjarje të ndryshme personale apo ndonjë ngjarje tjetër me gojë dhe me shkrim para një publiku të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Kulti i disa gjallesave të natyrës			
Fjalët kyçe: Kulti, dhia e egër, kaprolli, shqiponja, bleta.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – kupton tekstin informues; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – analizon attribute kulti të disa gjallesave në mitologjinë shqiptare.			
Kriteret e suksesit: Vlerëson tekstin informues-paraqitës. Mbledh të dhëna për një tekst informues-paraqitës. Shkruan një tekst informues-paraqitës për karakteristikat e ndonjë gjallese.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit, materiale nga interneti, materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore, shoqëria dhe mjedisi.	
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:	
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, nxënësit tregojnë njohuritë e tyre për tekstet informuese dhe të gjitha mendimet shënohen në tabelë. Mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se disa gjallesa kanë attribute kulti te njerëzit. Po ashtu, edhe në mitologjinë shqiptare ndeshim kafshë, shpendë a insekte me attribute kulti. Teksti që do të punohet, ka parasysh disa prej tyre si p.sh.: Dhia e egër, kaprolli, shqiponja dhe bleta. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/Marrëdhënia Pyetje-përgjigje Para se të fillojë leximi i pjesës, mësuesi/ja shpjegon se: <i>Veprat studimore përbëhen zakonisht nga tekste informuese-paraqitëse. Teksti i mëposhtëm është shkëputur nga një vepër studimore për mitologjinë ndër shqiptarët. Mitologjia ka të bëjë me mitet, që janë rrëfenja a tregime për qenie të mbinatyrshme ose për ngjarje të çuditshme. Në këtë tekst përmenden disa kafshë, për të cilat, në mite apo legjenda të hershme, shqiptarët shfaqin adhurim a nderim të madh.</i> Pasi të përfundojë leximi i pjesës dhe të jenë zbërthyer fjalët e panjohura, nxënësit, së bashku me mësuesin/en, punojnë ushtrimin 1/Kuptojmë tekstin. Për të punuar ushtrimet e tjera, në klasë formohen tri grupe nxënësish (6-8 nxënës): Grupi I - Analizojmë tekstin. Grupi II - Gjuha e tekstit. Grupi III - Reflektojmë rreth tekstit. Pasi të kenë përfunduar, nxënësit paraqesin përgjigjet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura dhe kërkon nga nxënësit që përgjigjet të paraqiten jo vetëm nga përfaqësuesit e grupeve por edhe nga nxënësit e tjerë. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ese e shkurtër informuese-paraqitëse Nxënësit do të shkruajnë në fletore një tekst të shkurtër informues-paraqitës për karakteristikat e bletës si insekt, pa u ndalur kësaj radhe te vendi që zë ajo në besimet popullore.	
Vlerësimi i nxënësve	
Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).	
Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 43
Bashkëbisedoni rreth kulteve të këtij teksti. A vlerësohen sot këto lloje kafshësh, shpendësh ose insektesh, ashtu si dikur? Kërkoni ndihmën e prindërve, burimeve nga internetit ose të mësuesit/es për t'u përgatitur për këtë temë.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Tekstet informuese-paraqitëse		Rezultati i të nxënit të temës: Rrëfen për ngjarje të ndryshme personale apo ndonjë ngjarje tjetër me gojë dhe me shkrim para një publiku të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT -Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Zogjtë			
Fjalët kyçe: etolog, dinamikë, formacion, luzma, të centralizuar, union, kaleiodoskopike.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – kupton tekstin informues; – dallon shprehjet e figurshme dhe mesazhin e pjesës; – analizon vetorganizimin grupor të zogjve.			
Kriteret e suksesit: Debaton për tekstin informues. Dallon shkrimin e një titulli në reportazh dhe nëntitullin. Reflekton rreth tekstit dhe tregon: A mbyllet pjesa me një konkluzion të qartë nga ana e shkencëtarëve? Argumentoni përgjigjen tuaj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, nxënësit tregojnë njohuritë e tyre për tekstet informuese dhe të gjitha mendimet shënohen në tabelë . Pastaj shpjegon për titullin e një shkrimi dhe nëntitullin një shkrimi, artikulli apo reportazhi është tepër i rëndësishëm, pasi është elementi i parë me të cilin përballet lexuesi. Ndaj, zakonisht autorët zgjedhin një titull që tërheq vëmendjen, që përshkruan përmbajtjen e tekstit ose që zgjon kërshërinë e lexuesve për ta lexuar tekstin më tej.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim/Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Para se të fillojë leximi i pjesës, mësuesi/ja shkruan titullin e pjesës në dërrasë të zezë “Zogjtë”. Mësuesi/ja shpjegon pjesën dhe udhëzon nxënësit për lexim.

Pasi të përfundojë leximi i pjesës dhe të jenë zbërthyer fjalët e panjohura, nxënësit së bashku me mësuesin/en punojnë ushtrimin 1/**Kuptojmë tekstin**.

Për të punuar ushtrimet e tjera, mësuesi/ja formon në klasë tri grupe nxënësish (6-8 nxënës):

Grupi I - ushtrimet 2 dhe 3 - Analizojmë tekstin.

Grupi II - ushtrimet 4 dhe 5 - Gjuha e tekstit.

Grupi III - Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimet 6 dhe 7.

Pasi të kenë përfunduar, nxënësit paraqesin përgjigjet dhe sugjerimet e tyre. Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura dhe kërkon nga nxënësit që përgjigjet të paraqiten jo vetëm nga përfaqësuesit e grupeve, por edhe nga nxënësit e tjerë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Reflektim teksti/Shkrim i shkurtër

Nxënësit do të shkruajnë një shkrim të shkurtër: Si e kuptoni frazën: “Të heqësh një paralele midis shoqërisë së njerëzve dhe tufave të zogjve është një objektiv që shkon përtej synimeve të kërkuarve”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shko Fletore pune, f. 44

Shkruani një tekst shpjegues-informues rreth një eksperimenti shkencor që keni kryer në shkollë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje kushtore dhe lejore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, kushtore dhe lejore			
Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, kushtore, lejore, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon pjesën e nënrenditur kushtore, lejore në një fjali të përbërë; - analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë; - argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e nënrenditur kushtore dhe lejore në fjali e si ndahet me presje ajo; - argumenton lidhjen kusht-pasojë në tekstet e krijuara.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti mësimor, <i>webfaqe</i> , Fjalori i Gjuhës Shqipe, shkurtesa me ngjyra.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Hapi I. Situata e të nxënit			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Tabela e Konceptit Nxënësit përqendrohen të <i>tabela e konceptit</i> , që mësuesi/ja e jep në tabelë për fjalitë e përbëra me nënrenditje kushtore dhe lejore. Rikujtojnë ato që kanë mësuar më parë për të.			
Fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore			
Roli që luan pjesa e nënrenditur	Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës	Pozicioni i pjesës së n/r	Përdorimi i presjes
Në fjalitë me pjesë të nënrenditur kushtore, shprehet marrëdhënia kusht-pasojë. Veprimet apo gjendjet që shprehen në dy pjesët e fjalisë janë të ndërvarura. Veprimi apo mosveprimi të njëra, kushtëzon kryerjen apo moskryerjen e veprimit të tjetra.	Në, nëse, në qoftë se, sikur, po qe se...	Rendi i pjesëve të fjalisë është i lirë.	Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore.

Fjalitë me pjesë të nënrenditur lejore			
Roli që luan pjesa e nënrenditur	Si lidhen pjesët e fjalive? - Mjeti lidhës	Pozicioni i pjesës së n/r	Përdorimi i presjes
Në këto fjali, veprimi apo gjendja që shprehet në pjesën e varur pritët të bëhet pengesë për atë të pjesës kryesore, por, në të vërtetë, veprimi kryhet.	<i>megjithëse</i> <i>sado</i> <i>sido që</i> <i>kudo</i> <i>kushdo</i>	Pjesët e fjalisë lejore kanë rend të lirë, domethënë, pjesa e varur mund ta ndjekë, t'i paraprijë ose të futet në mes të pjesës kryesore: Ata nuk shfaqnin shenja pendese, ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë. Ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë, ata nuk shfaqnin shenja pendese. Ata, ndonëse kishin nëpërkëmbur një popull të tërë, nuk shfaqnin shenja pendese.	Pjesa e varur ndahet gjithnjë me presje nga pjesa e kryesore. <i>Koha e së vërtetës vjen, sado e kopsitur të jetë gënjeshtër. Sido që të jetë, prindërit janë prindër. Njeriu e ndihmon njerinë, kushdo qoftë.</i>

Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi/ja, diskutojnë rreth plotësimit të *tabela e konceptit*, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit në bashkëpunim

Nxënësit bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në zgjidhjen e ushtrimeve.

Vijoni arsyetimin e shprehur me pjesë kushtore sipas modelit të dhënë.

Ky ushtrim punohet dhe si lojë në çift.

Po të isha i pasur, do të bëja një udhëtim rreth botës. Po të udhëtoja rreth botës, do të bëhesha më i ditur. Po të isha më i ditur do të ndihmoja njerëzimin duke gjetur kurën e shërimit të kancerit/Po të gjeja kurën kundër kancerit, do të shpëtoja shumë njerëz. Po të shpëtoja shumë njerëz, jeta ime do të ishte më e bukur...

Po të kisha një shkop magjik ... *vazhdo arsyetimin*

Po të isha dhe një herë e vogël...

Plotësoni pjesët e mëposhtme me nga një fjali të varur lejore.

Ndonëse ia kam premtuar vetës disa herë, nuk e kam mbajtur fjalën.

Kushdo të jetë kundërshtari le të vijë e të përballët me mua.

Sido që të vijnë punët, do të jem në anën tënde.

Megjithëse nuk e kam ende të drejtën e votës, unë kam bindjet e mia politike.

Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 1, fq. 265. Dalloni fjalitë kushtore, pjesët përbërëse të tyre dhe llojin e mjeteve lidhëse.
Ushtrimi 2. Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara.
Ushtrimi 3. Vijoni arsyetimin e shprehur me pjesë kushtore sipas modelit të dhënë.
Ushtrimi 4. Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara.
 Lexojnë disa nxënës fjalitë që kanë plotësuar sipas kërkesave, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i lirë

Hartoni një tekst të shkurtër ku të shprehni marrëdhëniet kusht-pasojë, si dhe ato lejore.

Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse dhe mjetet e lidhjes.

Nxënësit punojnë individualisht për të hartuar tekstin.

Nëse ushtrimi nuk mbaron në klasë, jepet detyrë shtëpie.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Duhet të bëjmë kujdes për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për dallimin e fjalive me pjesë të nënrenditura kushtore dhe lejore në një tekst, për bashkëveprimin e tyre brenda grupit etj.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 80

Ushtrimi 5. Hartoni një tekst të shkurtër ku të shprehni marrëdhëniet kusht-pasojë, si dhe ato lejore. Analizoni fjalitë, pjesët e tyre përbërëse dhe mjetet e lidhjes.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore: krahasore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore**Njësia mësimore:** Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethore: krahasore**Fjalët kyçe:** Fjalitë, përbërje, nënrenditje, rrethore, krahasore, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.**Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- dallon pjesën e nënrenditur krahasore në fjalitë e përbëra;
- analizon mjetin lidhës në to;
- argumenton përdorimin e presjes para pjesës së nënrenditur krahasore;
- ndërton tekste ku përdor fjali me pjesë të nënrenditura krahasore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, *webfaqe*, libra shkencorë, fjalor, foto të dokumenteve, video.**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:**Hapi I. Situata e të nxënës****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Lojë në çift**

Krahaso vetën me shoqen/shokun e bankës.

Krahaso klasën tënde me një klasë të paralelit tënd.

Krahaso futbollin shqiptar me atë anglez.

Krahasimin bëje me fjali të nënrenditura krahasore.

*Nxënësit diskutojnë së bashku. Ata vlerësojnë mendimet e njëri-tjetrit.***Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e Konceptit**

Roli i pjesës së nënrenditur	Mjeti lidhës	Pozicioni në fjali i pjesës së nënrenditur	Përdorimi i presjes
Në këto fjali, veprimi apo gjendja, për të cilën bëhet fjalë në pjesën kryesore jepet me anë të një krahasimi në pjesën e varur.	<i>Sa, aq sa, nga, nga sa...</i>	<i>Në rastet më tipike qëndron para pjesës kryesore.</i>	<i>Ndahet gjithmonë me presje.</i>
Krahasimi nuk bazohet gjithnjë te kallëzuesit e fjalive, siç ndodh në shembujt e mësipërm, por mund t'i referohet një gjymtyrë tjetër, kryesisht në shkallën krahasore...			

Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara. Sa ç'është e bukur natyra, aq e bukur është dhe ajo. Ai më shumë flet, sesa dëgjon. Duaji të tjerët, aq sa vetën. Mesa flet muri, flet burri. Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe-Rrjeti i diskutimit Rishkruani fjalitë, duke këmbyer ku është e mundur, rolin e pjesëve të tyre. Diskutoni rreth formës dhe kuptimit të të dy varianteve. <i>Sa ç'ishte i papërballueshëm i ftohti, aq ishte e padurueshme vapa.</i> <i>Sa më shumë afrohej dhelpër, aq më shumë dridhej lepuri.</i> <i>Sa më shpejt të mbyllet kjo punë, aq më mirë është.</i> <i>Më mirë të rrish vetëm, sesa të shoqërohesh më të këqijtë.</i> <i>Më mirë të jesh se të kesh.</i> Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Ushtrimi 1. Plotësoni pjesët e mëposhtme dhe analizoni fjalitë e përfutuara. Ushtrimi 2. Rishkruani fjalitë duke këmbyer ku është e mundur, rolin e pjesëve të tyre. Diskutoni rreth formës dhe kuptimit të të dy varianteve. Ushtrimi 3. Thoni nëse krahasimi bazohet te kallëzuesit e fjalive apo te ndonjë gjymtyrë tjetër. Nxënësit punojnë në dyshe. Më pas, diskutojnë për ushtrimin e dhënë dhe vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit. Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalive nënrenditëse krahasore në tekste të ndryshme etj. Detyrat dhe puna e pavarur <i>Shiko Fletore pune, f. 81</i> Ushtrimi 4. Gjeni dhe shkruani dhjetë fjalë të urta ku të shprehen marrëdhënie krahasore. Analizoni ndërtimin dhe kuptimin e tyre, si dhe mjetet e lidhjes. Për mbledhjen e tyre, kërkoni edhe ndihmën e më të rriturve. Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore

Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, përcaktor, rrethanor, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon pjesën e nënrenditur përcaktore në një fjali të përbërë;
- dallon paraprijësin në pjesën kryesore;
- analizon mjetin lidhës, me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë;
- argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e nënrenditura përcaktore në fjali e si ndahet me presje ajo.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, *webfaqe*, libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:

Hapi I. Situata e të nxënit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: DDM

Nxënësit përqendrohen të tabelës DDM, që mësuesi/ja e jep në tabelë për fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore. Rikujtojnë ato që kanë mësuar më parë për të.

<i>Di</i>	<i>Dua të di</i>	<i>Mësova</i>
Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hynë në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj. Më pëlqeu libri <i>që lexova dje</i> .		

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: DDM

Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi/ja, diskutojnë rreth plotësimit të tabelës DDM, plotësojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Di	Dua të di	Mësova
Në fjalitë përcaktore, pjesa e varur hyn në lidhje me një gjymtyrë emërore të pjesës kryesore dhe tregon një tipar apo veçori të saj. Më pëlqeu libri që lexova dje.	<i>Cilët shërbejnë si mjete lidhëse për fjalinë me pjesë të n/r përcaktore?</i>	Si mjete lidhëse për fjalitë përcaktore mund të shërbejë përemri lidhor që ose <i>i cili/e cila</i> .
	<i>Në cilin pozicion qëndron pjesa e n/r përcaktore në raport me pjesën kryesore?</i>	Pjesa e varur përcaktore mund të qëndrojë pas pjesës kryesore dhe në mes të saj.
	<i>Si ndahet me presje me pjesën kryesore, pjesa e n/r?</i>	Pjesët e varura përcaktore, që lidhen me përemrat lidhore <i>i cili, e cila</i> , ndahen me presje. Kur paraprihen nga përemri lidhor që, zakonisht nuk ndahen me presje.

Plotësohet tabela nga nxënësit. Në rast se nxënësit kanë paqartësi, shpjegohet nga mësuesi/ja.

Sugjerim! Punoni me këtë metodë, pasi kjo i bën nxënësit më aktivë në dhënien e mendimeve në fazën e parë dhe “detyron” nxënësin në fazën tjetër të mësimin të bëjë pyetje se çfarë duan të dinë rreth fjalisë së përbërë me n/r përcaktore dhe të punojë me tekstin deri në detaje. Në rastet më të shumta, nxënësit dëgjojnë shpjegimin e mësuesit për temën e re dhe nuk i hapin tekstet në shtëpi a më pas.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe-Rrjeti i diskutimit

Plotësoni pjesët kryesore me nga një pjesë të varur përcaktore.

Më kujtohen ende fjalët, të cilat m'i thoshe përditë.

Përgjithësisht, më pëlqejnë filmat, që kanë subjekt miqësinë.

Ai ka një zakon, që ta shpif.

Ka disa ngjarje në historinë e vendit, që ngelen të pashlyeshme.

Ai është i vetmi vend, që të ngelet në kujtesë shumë gjatë.

Nxënësit punojnë me ushtrimet e më pas diskutojnë rreth tyre.

Ata vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për angazhimin e tyre gjatë orës së mësimin. Vlerësohen nxënësit për përdorimin e fjalive nënrenditëse përcaktore në tekste të ndryshme.

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 82

Shkruani një tekst të shkurtër me temë “Ndërrimi i stinëve” ose “Intervistë me veten” ku të përdorni sa më shumë fjali përcaktore. Si mjete lidhëse përdorni përemrat lidhore që, *i cili/e cila*, duke i shoqëruar këta të fundit edhe me parafjalë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimin.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore. Tregon me se shprehet, ku qëndrojnë në fjali, cila është fjala drejtuese. E përdor drejt atë në fjali.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore/Ushtime			
Fjalët kyçe: Fjalitë, përbërje, nënrenditje, përcaktor, rrethanor, gjymtyrë, fjalë drejtuese, mjet lidhës, fjalë lidhëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: – dallon pjesën e nënrenditur përcaktore në një fjali të përbërë; – dallon paraprijësin në pjesën kryesore; – analizon mjetin lidhës me anë të cilit lidhen pjesët e fjalisë; – argumenton pozicionin ku ndodhet pjesa e nënrenditura përcaktore në fjali e si ndahet me presje ajo.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i klasës VIII, <i>webfaqe</i> , libra shkencore, fjalor, foto të dokumenteve, video.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe; letërsi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Hapi I. Situata e të nxënit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim Diskutohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Nxënësit vlerësojnë punët e njeri-tjetrit dhe sqarojnë paqartësitë.			
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e Konceptit - Punë në dyshe			

Dalloni përcaktorët nga pjesët e varura përcaktore. Plotësoni tabelën.

Vajza, e lodhur nga leximi i tepërt, u largua nga biblioteka. Një i moshuar që po lexonte gazetën në park, e flaku papritur atë në një kosh pranë tij. Trikon e punuar me dorë nga gjyshja, nuk e heq nga dollapi. Punëtorët të cilët bëjnë pastrimin e qytetit, janë banorët e tij të natës. E ndërtuar me gurë të bardhë, shtëpia dukej si në përralla. Shtëpia në të cilën mblidheshim të gjithë së bashku, ruan ende kujtimet e të shkuarës.

Përcaktor	Fjali përcaktore	Mjeti lidhës
<i>E ndërtuar me gurë të bardhë, shtëpia dukej si në përralla</i>	<i>Një i moshuar që po lexonte gazetën në park, e flaku papritur atë në një kosh pranë tij.</i>	<i>Që</i>
	<i>Punëtorët të cilët bëjnë pastrimin e qytetit, janë banorët e tij të natës.</i>	<i>Të cilët</i>

Nxënësit plotësojnë tabelën.

Formoni pesë fjali ku lidhëza që të lidhë pjesët e një fjalie:

Qëllimore: *Emigroi në Gjermani, që të jetonte një jetë më të mirë.*

Përcaktore:

Kryefjalore:

Kundrinore:

Kushtore:

Zëvendësoni përcaktorët me pjesë të varura përcaktore dhe anasjellas.

Hanxhiu kishte një grua zemërdhembshur, që i vinte keq për mjerimet e tjetrit. E bija e saj, një vajze e re me pamje të bukur, e ndihmonte për të porepsur mysafirin. Në këtë han, punonte një shërbëtorë asuriane me gojë të gjerë, kokë të madhe, hundë plloçkë, me njërin sy të shtrembër e me tjetrin jo fare të shëndoshë, por që të gjitha kusuret ia mbulonte bukuria e shtatit.

Hanxhiu kishte një grua që ishte zemërdhembshur dhe që i vinte keq për mjerimet e tjetrit.

Hapi III. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe-Rrjeti i diskutimit

Ndërto një fjali ku pjesa e nënrenditur të lidhet më kryesoren me mjetin lidhës që dhe të qëndrojë herë pas pjesës kryesore dhe herë në mes të saj.

Nxënësit punojnë të qetë dhe më pas shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin për të kontrolluar saktësinë e kryerjes së ushtrimit. Puna arkivohet në dosje.

Nxënësit në grupe dyshe punojnë ushtrimet dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 1. Plotësoni pjesët kryesore me nga një pjesë të varur përcaktore.

Ushtrimi 2. Dalloni përcaktorët nga pjesët e varura përcaktore. Plotësoni tabelën.

Ushtrimi 3. Formoni pesë fjali ku lidhëza “që” të lidhë pjesët e një fjalie.

Ushtrimi 4. Zëvendësoni përcaktorët me pjesë të varura përcaktore dhe anasjellas.

Nxënësit punojnë me ushtrimet e më pas diskutojnë rreth tyre.

Ata vlerësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin saktë të mjeteve lidhëse në fjalinë me pjesë të n/r përcaktore etj.

Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 82
Shkruani një tekst të shkurtër me temë “Ndërrimi i stinëve” ose “Intervistë me veten”, ku të përdorni sa më shumë fjali përcaktore. Si mjete lidhësem përdorni përemrat lidhorë <i>që, i cili/e cila</i> , duke i shoqëruar këta të fundit edhe me parafjalë.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm të nxënësit dhe të orës së mësimi.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Teksti udhëzues			Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar			
Fjalët kyçe: Këshilla, libri, thelbi, vlerësimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: – gjen/planifikon kohën për lexim; – vendos të lexojë librin; – përzgjedh librin për ta lexuar.			
Kriteret e suksesit: Analizon librin e përzgjedhur. Argumenton, shpjegon ngjarjet në libër. Mbledh dhe mban shënim të dhënat nga libri.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.			


Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- *Ju pëlqen të lexoni? Kemi në klasën tonë nxënës të cilët kanë pasion leximin? Po cilat zhanre librash preferoni më tepër? Apo ndoshta tani më tepër preferoni lojërat digjitale?*

Nxënësit do të përgjigjen, mund të ketë nxënës/e, të cilët nuk preferojnë leximin dhe ju duket humbje kohe!

Duke renditur mendimet e nxënësve, mësuesi/ja krijon pemën e mendimeve në dërrasë të zezë.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Di/Dua të di/Mësova-Marrëdhënia Pyetje-përgjigje**

Lexohet teksti udhëzues “Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar”. Pas leximit të tekstit, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se sa e rëndësishme është të dimë të zgjedhim librin e duhur. Pastaj, së bashku me nxënësit, plotësojnë rubrikën Di/Dua të di/Mësova.

Çfarë dinim më parë rreth përzgjedhjes së librit të duhur për ta lexuar?	Çfarë mësuam nga teksti që lexuam?	Cilat janë këshillat që morëm nga teksti i mësipërm?
.....	<i>Të bëjmë një listë dhe të zgjedhim librat që përshtaten me moshën dhe aftësitë tona.</i>	<i>Të shikojmë me sy kritik librin që lexojmë.</i>

Pasi të jetë plotësuar tabelat, nxënësit punojnë në grupe ushtrimet në rubrikën *Studim teksti*.

Grupi I - Kuptojmë tekstin

Grupi II - Analizojmë tekstin

Grupi III - Gjuha e tekstit

Pasi nxënësit kanë përfunduar ushtrimet, përfaqësuesit e grupeve i prezantojnë ato para klasës.

Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura dhe udhëheq nxënësit drejt zgjidhjes së problemit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Karrigia e nxehtë

Për të kuptuar më mirë rëndësinë e organizimit dhe të përpilimit të një liste para se të udhëtojmë, mësuesi/ja mund të zgjedh një nxënës (mund të ulet dhe vet) të ulet në karrige (karrigia e nxehtë), ndërsa nxënësit e tjerë, duke u mbështetur në pyetjet e rubrikës reflektojmë rreth tekstit ushtrimet 8, dhe 9 i parashtrajnë pyetje nxënësit/es që gjendet i ulur në karrige.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve dhe përgjigjeve nëse është e nevojshme, mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur*Shiko Fletore pune, f. 45*

Shkruani pesë këshilla për të rritur përqendrimin gjatë orës mësimore.

Kujdesuni që t'i shkruani qartë këshillat, në mënyrë që të jenë sa më të kuptueshme. Shkruani sipas një ecurie logjike, duke i shpjeguar veprimet hap pas hapi. Përdorni vetën e dytë, sepse ju ndihmon për të orientuar lexuesit.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**Fusha kurrikulare:**

Gjuhët dhe komunikimi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Shkalla e kurrikulës:

IV

Klasa: VIII**Tema:** Teksti joletrar

Teksti argumentues

Rezultati i të nxënit të temës:

Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.****II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.****III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.****IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.****V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.****VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.****Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):****I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT****II. VLERAT DHE QËNDRIMET****III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË****IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS****Aspektet specifike të planit të orës mësimore****Njësia mësimore:** Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit**Fjalët kyçe:** Shpyllëzimi, përparësitë, të metat.**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:****Nxënësi/ja:**

- mëson për përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit;
- analizon dhe i kupton këto përparësi;
- jep mendimin e tij/saj mbi rëndësinë dhe të metat shpyllëzimit.

Kriteret e suksesit:

Kupton rëndësinë dhe të metat e shpyllëzimit.

Krahason përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit sot.

Bashkëbisedon dhe çmon vlerat e mirëfillta që sjell shpyllëzimi duke iu dhënë prioritet vetëm vlerave.

Vetëdijësohet për mbrojtjen dhe ruajtjen e ekosistemit në planetin Tokë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.


Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

Si mendoni se ishin pyjet në të kaluarën? Po sot, si janë? Ka ndonjë ndryshim, ju kanë folur në shtëpi për këtë çështje? Si i kanë ruajtur apo i kanë shkatërruar pyjet dikur?

Nxënësit do të shpërthejnë me përgjigjet, idetë dhe mendimet e tyre. Natyrshëm do të shprehin mendimet, mësuesi/ja hedh në dërrasë të zezë mendimet e tyre në formën e pemës së mendimeve.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje/ Bashkëbisedim/Studimi i rastit

Mësuesi/ja fillon leximin e rubrikës *Para leximit* dhe pastaj teksti mund të ndahet në disa pjesë dhe të lexohet nga nxënësit.

Pas leximit, të gjithë si klasë me ndihmën e mësuesit/es punojnë ushtrimin *Kuptojmë tekstin*.

Mësuesi /ja ndan klasën në 4 grupe dhe punojnë:

Grupi I - Analizojmë tekstin

Grupi II - Interpretojmë tekstin

Grupi III - Gjuha e tekstit

Pasi nxënësit kanë përfunduar ushtrimet, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë ato para klasës.

Mësuesi/ja bënë ndërhyrjet e duhura dhe udhëheq nxënësit drejt zgjidhjes së problemit. Duke u mbështetur te nënrubrika *Reflektojmë për tekstin*, mësuesi/ja së bashku me nxënësit mund të bashkëbisedojnë për problemet që i sjell shpyllëzimi i egër.

Diskutoni rreth ndryshimeve që kanë pësuar pyjet ndër vite. Çfarë vihet re vitet e fundit? Çfarë dini për të ashtuquajturën “efekti serrë”? Ku e vini re këtë? Si mendoni, pse ndodh kjo dukuri?

Gjatë bashkëbisedimit, mësuesi/ja do të përpiqet t’u shpjegojë nxënësve se çfarë e shkakton këtë efekt.

Efekti serrë ndikon negativisht në kushtet klimatike të planetit Tokë. Prerja e egër e pyjeve shkatërron ekosistemin e planetit, sepse me prerjen e pemëve nuk do të jetë e mundur ulja e dioksidit të karbonit në atmosferë. Pemët lirojnë oksigjenin, i cili është vendimtar për jetën e qenieve të gjalla në planeti tonë dhe thithin dioksid karbonin, i cili dukshëm dëmton shëndetin e qenieve të gjalla. Pa pyje, planeti ynë vdes dhe bashkë me planetin, shuhemi edhe ne. Pyjet janë shumë të domosdoshme për mbijetesën tonë dhe të të gjitha qenieve tjera për të cilat Toka është shtëpia e vetme që kemi.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Nxënësit do të punojnë ushtrimin 11 të rubrikës reflektojmë për tekstin.

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë pyetjen:

A ndodh gjithmonë që pemët e prera të zëvendësohen me mbjelljen e pemëve të reja? Çfarë tregon kjo për pasojat e shpyllëzimit?

Po

Jo

Pse?

Nxënësit mund të shkëmbejnë mendimet në dyshe e në katërshe. Pastaj klasa pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Përfaqësuesit e grupeve raportojnë para klasës për arsyet pro apo kundër çështjes. Për çdo paraqitje, caktohet një kufi kohor prej një-dy minute. Gjatë kohës që grupet raportojnë për arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicionin dhe të kalojnë te grupi i cili i ka arsyet më bindëse.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 46

Gjeni informacione rreth efektit serrë dhe shkruani se si lidhet shpyllëzimi me këtë efekt.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar Teksti argumentues		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: A duhet të lejohen celularët në shkollë?
Fjalët kyçe: Celularët, studimet, ndalohen, shkolla...
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore: Nxënësi/ja: – mëson për përparësitë e ndalimit të celularëve në shkollë; – analizon dhe i kupton këto përparësi; – jep mendimin e tij/saj mbi rëndësinë e ndalimit të mbajtjes së celularëve në shkollë.
Kriteret e suksesit: Kupton rëndësinë dhe seriozitetin e iniciativës. Krahason përparësitë dhe dobietë e përqendrimit në studime kur nuk kemi celularin me vete. Bashkëbisedon dhe çmon kujdesin dhe iniciativën e shoqërisë për përqendrimin dhe dobietë e studimeve. Vetëdijësohet për rëndësinë e koncentrimin dhe përqendrimit të mësimave/aktiviteteve shkollore dhe vetëm aktiviteteve shkollore.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënës; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Parashikimi me terma paraprakë Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa terma si: <i>shkolla, celularët, shpërqendrim, mësim, ndalon, nxënës...</i> dhe kërkon nga nxënësi që të formojnë një fjali. Nxënësve iu lejohe të shtojnë dhe fjalë tjera ndihmëse. Nxënësi shkruajnë fjalinë dhe i lexojnë para shokëve/shoqeve. Celularët duhet të ndalohen nëpër shkollë, ata shpërqendrojnë nxënësin gjatë mësimin. Para se të fillojë leximi i tekstit jolettrar-argumentues, mësuesi/ja shpjegon për nxënësin se: <i>Debati për lejimin ose jo të celularëve në shkollë ka kohë që zhvillohet në vende të ndryshme të botës. Një studim në Britani zbuloi se shkollat që ndaluan celularët, kanë rezultate më të mira akademike. Sipas këtij studimi, kur nxënësi nuk shkon në shkollë me celular me vete, rezultatet e tyre në mësim rriten në të njëjtën mënyrë sikur nxënësi të kishin bërë një javë më shumë mësim. Sakaq, ka ende shumë të tjerë që mendojnë se celulari duhet të merret në shkollë, për shkak të funksioneve pozitive që mund të ketë.</i> Para se të fillojë leximi i tekstit, mësuesi/ja mund të kërkon nga nxënësi që të plotësojnë tabelën sipas mendimeve të tyre, por njëherësh të lënë anash edhe kolonat të cilat do t'i plotësojnë pas leximit të tekstit argumentues. Tabela vizatohet në dërrasë të zezë dhe pas leximit të pjesës plotësohen edhe dy kolonat tjera, të cilat do të argumentohen sipas statistikave dhe të dhënave që do të nxirren nga teksti argumentues.

Mendimi i nxënësve pro lejimit të celularëve në shkollë/ arsyet	Argumente pro lejimit të celularëve (kjo pjesë plotësohet pas leximit të tekstit)	Mendimi i nxënësve kundër lejimit të celularëve në shkollë/ arsyet	Argumente kundër lejimit të celularëve (kjo pjesë plotësohet pas leximit të tekstit)
1.	1.	1.	1.
2.	2.	2.	2.
3.	3.	3.	3.
4.	4.	4.	4.
5.	5.	5.	5.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/ Bashkëbisedim/Studimi i rastit

Mësuesi/ja fillon leximin e tekstit argumentues “A duhet të lejohen celularët në shkollë?”. Pasi lexohet teksti nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara te rubrika kuptojmë tekstin. Nxënësve do t’ju kërkohet që të plotësojnë kolonat e zbrazëta në tabelën, e cila është e vizatuar dhe gjysmë e plotësuar në dërrasë të zezë. Nxënësit do të vërejnë se sa ndryshojnë mendimet individuale nga ato argumentuese, të cilat bazohen në hulumtime dhe fakte.

Për të vazhduar me demonstrimin e rezultateve, mësuesi/ja ndan klasën në 3 grupe dhe punojnë:

Grupi I - Analizojmë tekstin, ushtrimet 2, 3, dhe ushtrimin 9 te rubrika Gjuha e tekstit.

Grupi II - Interpretojmë tekstin.

Grupi III - Gjuha e tekstit, ushtrimet 7, 8 dhe 10.

Pasi kanë përfunduar ushtrimet, përfaqësuesit e grupeve prezantojnë ato para klasës.

Mësuesi/ja bënë ndërhyrjet e duhura dhe udhëheq nxënësit drejt zgjidhjes së problemit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Nxënësit do të punojnë ushtrimet 11 dhe 12 të rubrikës Reflektojmë për tekstin.

11. Përse përdorimi i celularëve në klasë është shqetësues për mësuesit?

12. A qëndrojnë, sipas jush, argumentet që jepen në lidhje me lejimin e celularëve në shkollë?

Nxënësit mund të shkëmbejnë mendimet në dyshe e në katërshe. Pastaj klasa pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Përfaqësuesit e grupeve raportojnë para klasës për arsyet pro apo kundër çështjes. Për çdo paraqitje, caktohet një kufi kohor prej një -dy minute. Gjatë kohës që grupet raportojnë për arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicionin dhe të kalojnë te grupi i cili i ka arsyet më bindëse.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shiko Fletore pune, f. 48

Gjeni informacione rreth efektit serrë dhe shkruani se si lidhet shpyllëzimi me këtë efekt.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Tekst përshkrues			Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Përshkruajmë në mënyra të ndryshme				
Fjalët kyçe: Përshkrimi, objektiv, subjektiv.				
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: – dallon tekstin përshkrues si lloj i tekstit joletrar; – njeh llojet e përshkrimit; – merr njohuri për përshkrimin objektiv dhe subjektiv si lloje të tekstit joletrar.				
Kriteret e suksesit: Kupton përshkrimin si lloj i tekstit joletrar. Analizon nëpërmjet ushtrimeve elementet e thurjes/ndërtimit së përshkrimeve objektive dhe subjektive. Shkruan një përshkrim për një send apo qenie të gjallë, duke veçuar karakteristikat e të dy përshkrimeve, objektiv dhe subjektiv.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 8, interneti, fleta, shënjes, tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Diskutim/Pema e mendimit Mësuesi/ja pyet nxënësit: Si mendoni, çfarë mund të përshkruajmë dhe si? P.sh. nëse bëjmë përshkrimin e një kafshe shtëpiake që ju e keni për zemër, si do ta përshkruanit? Do të tregoni vetëm karakteristikat e pamjes fizike apo do të gërshetonit këto karakteristika edhe me emocionet pozitive që ngjall te ju qeni, macja, apo ndonjë shpezë me të cilën ju ndoshta kaloni një pjesë të kohës suaj, pra, argëtoheni dhe kujdeseni për te.				

Nxënësit japin përgjigjet e tyre, të cilat mësuesi/ja i mban shënim në tabelë. Shënimet ndahen në dy kolona, në njërin kolonë vendosen përshkrimet fizike të kafshës/qenies, ndërsa në kolonën tjetër vendosen përshkrimet emocionale të cilat nxënësit i bëjnë për kafshën/qenien e tyre të preferuar.

Përshkrimi objektiv	Përshkrimi subjektiv
P.sh. QENI/ është i <i>racës dalmatine</i> , ka <i>ngjyrat bardh dhe zi. Ai vrapon</i> kaq kilometra.... ka <i>sy ngjyrë</i> ka mësuar të bëjë këtë..... PESHQIT NË AKUARIUM/ kam <i>2 ose më shumë</i> ata <i>kanë ngjyrën e</i> ushqehen me... <i>njëri është</i> <i>tjetri është</i> etj...	Qeni dalmatin është qeni <i>më i bukur në botë</i> për mua. Sytë e tij <i>buzëqeshin</i> sa herë më takon mua. Ne jemi shokë të pandarë, <i>unë dhe qeni im kemi gjuhën</i> të cilën e kuptojmë vetëm ne..... etj

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje/Diskutim

Para se të lexohet teksti “Ariu i zi” dhe “Hardhuca”, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se, dy tekstet e mëposhtme janë përshkruese. Në to përshkruhen dy kafshë: ariu i zi amerikan dhe hardhuca. Tekstet ndryshojnë nga njëri-tjetri, jo vetëm për shkak të kafshës që përshkruajnë, por edhe për shkak të mënyrës se si e realizojnë përshkrimin: në mënyrë objektive dhe subjektive.

PËRSHKRIMI OBJEKTIV	PËRSHKRIMI SUBJEKTIV
Kur përshkruajmë nëpërmjet një morie të dhënash objektive për të informuar lexuesin rreth pamjes së objektit/ frymorit që përshkruajmë, cilësive, karakteristikave, pa shprehur kurrësi përshtypje, emocione, ndjesi, vlerësime, kemi realizuar një përshkrim objektiv. Përdoren dendur terma specifikë apo mbiemra.	Kur përshkruajmë në mënyrë personale, nëpërmjet mbresave, përshtypjeve dhe opinioneve. Autori përshkruan objektin/ frymorin nga këndvështrimi i tij, ashtu siç i duket atij në atë çast të veçantë, duke shprehur tërë emocionet. Subjektiviteti shfaqet sidomos nëpërmjet gjuhës së pasur me krahasime për të shprehur gjykimet dhe opinionet e shpeshta të autorit.

Lexohen nga nxënësit përshkrimet në tekst për ariun e zi dhe për hardhucën dhe vazhdohet me detyrat dhe ushtrimet.

Grupi I - Kuptojmë tekstin

Grupi II - Analizojmë tekstin

Grupi III - Interpretuojmë tekstin

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Gjuha e tekstit, ushtrimi 7. Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke u mbështetur në njohuritë e fituara.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe/tandem.

Mbiemra dhe terma specifikë që përdoren për të përshkruar ariun e zi.	Krahasime dhe similituda që përdoren për të përshkruar hardhucën.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).
Detyrat dhe puna e pavarur
Përshkruani në mënyrë objektive dhe subjektive një nga kafshët që ju pëlqen më shumë.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: VIII
Tema: Teksti joletrar/Teksti përshkrues		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan dhe nxjerrë idetë kryesore, argumentet dhe perspektivat e tekstit, duke përdorur dijet për strukturën e tekstit, organizimin e tij dhe qëllimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Vendi me më shumë libra se sa banorë			
Fjalët kyçe: Mundal, qytet, libra, nder.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: – përshkruan tekstin rrëfyes duke u bazuar në tekstin shkollorë; – dallon tekstin përshkrues si tekst joletrar; – analizon rëndësinë e librit dhe vlerat e qytetit Mundal.			
Kriteret e suksesit: Kupton qëllimin e tekstit përshkrues. Vlerëson tekstin e lexuar, duke u ndalur te vlerat morale që sjellë leximi i libri. Shkruan një ese përshkruese duke ndjekur hapat e tekstit përshkrues si tekst joletrar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 8, interneti, fleta, shënjes, tabela.			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore **“Vendi me më shumë libra se sa banorë”**. Pastaj udhëzon nxënësit të tregojnë a kanë dëgjuar për ndonjë vend të tillë. Nëse po, cili është ai vend dhe si është e mundur që një vend të ketë më shumë libra se sa banorë.

Mendimet e nxënësve mbahen shënim në dërrasë të zezë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Secili mëson një-Pyetje-përgjigje

Para fillimi të leximit të tekstit, mësuesi/ja shpjegon për nxënësit se: *teksti që do të lexojnë, përshkruan karakteristikat e një qyteti që është disi i pazakontë, sepse në të, kudo të sheh syri libra. Hollësitë e shumta e bëjnë më të gjallë dhe më të prekshëm përshkrimin. Tekstet që përshkruajnë vende, përfshijnë përshkrime të hollësishme rreth emrit dhe pozicionit gjeografik të vendit që përshkruhet; rreth klimës, natyrës, njerëzve dhe mënyrës së jetesës. Teksti që do të lexoni, megjithatë, përqendrohet te përshkrimi i asaj që e bën të veçantë këtë qytet, krahasuar me të tjerët.*

Klasa ndahet në grupe:

Grupi I - Diskutues: Pasi kanë lexuar tekstin, përfaqësuesi i grupit prezanton para shokëve/shoqeve përshkrimin e lexuar për qytetin e Mundalitsi, vendi me më shumë libra se sa banorë. Përshkruan vendin, numrin e banorëve, numrin e librave dhe të dhënat e tjera, të cilat këtë qytet e bëjnë të veçantë.

Grupi i II - Afinitet: Ky grup udhëzohet që pasi që ta ketë lexuar tekstin të krijojnë pyetje për nxënësit tjerë për detyrë shtëpie, duke plotësuar detyrat e dhëna në tekst, dhe çfarë të dhëna do të sjellin orën tjetër që teksti të plotësohet.

Grupi i III - Kritikët: Pasi kanë lexuar tekstin përfaqësuesi i grupit, duhet të prezantojë para shokëve/shoqeve mendimet pozitive për përshkrimin, po ashtu mund të paraqesin edhe ndonjë mendim negativ nëse kanë, por çdo herë, duke u bazuar me komentet e tyre e duke dhënë arsyetimet e mendimeve.

Para se nxënësit të udhëzohen për detyrë, punojnë së bashku me mësuesin/en detyrat te rubrika *Kuptojmë tekstin*. Pastaj ashtu siç janë në grupe, nxënësit punojnë:

Grupi I - Analizojmë tekstin.

Grupi II - Interpretojmë tekstin.

Grupi III - Reflektojmë rreth tekstit.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.

Nxënësit do të punojnë në heshtje. Përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre para klasës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Gjuha e tekstit

Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe detyrat 9 dhe 10 të rubrikës *Gjuha e tekstit*.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme kur ata kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës mësimore).

Detyrat dhe puna e pavarur	Shiko Fletore pune, f. 49
Përshkruani me detaje fshatin ose qytetin ku banoni. Teksti duhet të përshkruajë cilësitë dhe karakteristikat më tipike të vendit (Ndaluni të përshkrime të hollësishme rreth emrit dhe pozicionit gjeografik të tij; rreth klimës dhe natyrës; rreth njerëzve dhe mënyrës së tyre të jetesës). <i>Për të shkruar esenë përshkruese, nxënësit udhëzohen të ndjekin hapat, të cilët janë në tekstin shkollorë të rubrika Shkruajmë.</i>	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Do të jetë zgjedhja e mësuesit/es.	

TEST (LETËRSI) DYMUJORI I PARË

1. Rrëfimi fantastik, i cili ka qëllim t'u përcjellë lexuesve një mësim të veçantë, që quhet moral, në të cilin kafshëve dhe sendeve u vishen tipare, virtyte dhe të meta të njerëzve dhe ka protagonist kafshë e sende që flasin, është:

- a. Miti
- b. Fabula *e saktë*
- c. Legjenda

(3 pikë)


2. Për cilin virtyt të lashtë të popullit shqiptar bëhet fjalë te balada “Kush e solli Doruntinën?”. Shpjegoni si realizohet ky virtyt te kjo baladë.

(5 pikë)

Te balada “Kush e solli Doruntinën” bëhet fjalë për virtytin e besës. Besën e dhanë nuk e tret as dheu. Në këtë baladë, Konstantini ngrihet nga varri për të mbajtur besën që i kishte dhënë nënës së tij.

3. Lexoni me kujdes tekstin, rikujtoni vetitë e Ciklopit dhe Odisesë dhe lidhni më poshtë me shigjetë vetitë dalluese të njërit dhe tjetrit.

Te rrëfimet popullore, keni lexuar edhe pjesën “Ciklopi” të Euripidit të përshtatur në prozë. Në qendër të saj, është një ciklop i fuqishëm dhe i frikshëm me emrin Polifem, i cili shfaqet i egër dhe ushqehet me kafshë e njerëz. Ai jeton në një shpellë të madhe ku ka robëruar plakun Silen dhe bijtë e tij, satirët, të cilët i shërbejnë dhe i rrisin bagëtitë. Gjatë peripecive për t'u kthyer në atdheun e tij, Odiseja dhe shokët e tij do të ndalojnë në ishullin e Polifemit, Sicilia e sotme. Ata do t'i shpëtojnë ciklopit vetëm falë zgjuarsisë dhe dinakërisë së Odisesë.



(4 pikë)

4. Proverbat janë fjalë të urta. Ato janë shprehje të njohura me kuptim të njësishtëm e zakonisht të figurshëm, që përgjithësojnë një vëzhgim a një vlerësim për dukuritë e ndryshme të jetës. Në tabelën e më poshtme, shkruani nga një proverb për temat e kërkuara.

Një proverb për diturinë	<i>(Më mirë të dish se sa të kesh)</i>
Një proverb për punën	<i>(Ku ka bletë, ka mjaltë)</i>
Një proverb për koprracinë	<i>(As gurë s'të jep koprraci)</i>
Një proverb për miqësinë	<i>(Thuamë ç'shokë ke të të them cili je)</i>

(6 pikë)

5. Lexoni me kujdes tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve.

Leni aty, bre shejtana! – u bërtiti me hidhërim. – Mos ma prekni mallin...

Fëmijët u trembën dhe menjëherë ikën. Ikën, por me xhepa dhe gji plot. Duke parë në hall, pemëshitësit plak iu afruan dyqanxhinjtë fqinj. Ndërsa i mblidhnin enët, perimet dhe pemët, fëmijët qëndronin anash dhe shikonin veglat e tyre të lojës, të cilat kishin mbetur atje ku filluan të grabisnin pemët.

– S’ka hajr prej fëmijëve të sodit! – pikllueshëm i ankohej Ymeri fqiut, i cili i ndihmonte për rregullimin e mallit. Gjysmën e pemëve ma kanë rrëmbyer, bre *hajnat* që janë!...

Duke i ndëguar këto fjalë, fëmijët shikuan njëri-tjetrin. Duart u shkuan pavetëdijshtë kah xhepat, kah gjinjt. U erdh keq për të shkretin bablok.

– T’ia kthejmë! – tha njëri gjallërisht dhe u hodhi shokëve një shikim pyetës....

- a) Ky fragment është shkëputur nga _____ e shkrimtarit _____.
- b) Si u sollën fëmijët me pemëshitësin? _____
- c) Si ndikoi mërzia e pemëshitësit te fëmijët? _____
- d) Çfarë mendonin se bënë fëmijët më pas? _____

(6 pikë)

- a) *Kujtimet, Hivzi Sylejmani.* b) *Fëmijët u penduan;* c) *Fëmijët i kthyen pemët pemëshitësit.*

6. Duke u mbështetur te romani “Historia e Skënderbeut” e shkrimtarit Odhise Grillo, shpjegoni: Pse thuhet se Skënderbeu ishte i barabartë mes të barabartëve?

(6 pikë)

Skënderbeu i trajtonte luftëtarët e tij ashtu si dhe veten e tij _____ Ai ishte i thjeshtë e i dashur, i urtë e burrë i fjalës dhe i shpatës _____.

7. Shpjegoni fjalët me shprehjet e figurshme të renditura më poshtë.

As nam, as nishan _____

Nuk bëri as gëk, as mëk _____

Po rrinin sus _____

Më goditi me thikë pas shpine _____

(5 pikë)

Nuk i mbeti asgjë, në kuptimin u zhduk; Nuk kundërshtoi; Nuk bëzanin, në kuptimin e qetësisë apo kur nuk ke çfarë të flasësh, kundërshtosh; Kur tradhtohesh nga dikush.

8. Shkruani me një fjali kuptimin e fjalës madhështi, duke u nisur nga fjalët kyçe:
madhështia, guximi, mirësia, dashuria.

(5 pikë)

9. Kthe në shqipen standarde fjalët:

Përthekoj _____ (*lidh*)

Mbërthej _____ (*kopsit*)

Sajë _____ (*slita*)

Mahallë _____ (*lagje*)

Hala _____ (*ende*)

Dardaleca _____ (*dordolec*)

Sokak _____ (*rrugë*)

Tutë _____ (*frikë*)

(5 pikë)

10. Lidh me shigjetë veprën dhe autorin e veprës.

Mrekullia _____ Kasëm Trebeshina

Histori e Skënderbeut _____ Hivzi Sylejmani

Kujtimet _____ R. J. Palacio

Një jetë e vështirë _____ Odhise Grillo

(5 pikë)

Mrekullia - R.J.Palacio; Histori e Skënderbeut - Odhise Grillo; Kujtimet - Hivzi Sylejmani; Një jetë e vështirë - Kasem Trebeshina

Vlerësimi:

0-19 (1)	20-29 (2)	30-39 (3)	40-44 (4)	45-50 (5)
Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
0-38%	40-58%	60-78%	80-88%	90-100%

TEST (GJUHË SHQIPE) DYMUJORI I PARË

1. Çfarë është gjuha si mjet komunikimi gojor dhe shkrimor: (4 pikë)

Gjuha është mjete themelor i komunikimit për shoqëritë njerëzore. Ajo mund të përdoret në formën e saj të folur dhe të shkruar. Forma shkrimore e gjuhëve u parapri nga vizatime që njeriu primitiv bënte në shpella dhe në gurë. *e saktë*

2. Shqipja është një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Kur është dokumentuar shkrimi shqip? (4 pikë)

Dokumentimi i shkrimit të gjuhës shqipe është relativisht i vonë, deri më sot, mund të flasim për dëshmi shkrimore të shqipes, që datojnë jo më herët se shekulli XIV, ndonëse ka shumë gjasa që kjo gjuhë të jetë shkruar shumë kohë më parë. *e saktë*

3. Tregoni në cilin dokument gjenden fjalët e dhëna më poshtë: (3 pikë)

<i>Boicke</i>	<i>vene</i>	<i>oie</i>	<i>mische</i>	<i>jat</i>	<i>foeije</i>	<i>krup</i>	<i>myr</i>	<i>kyckge</i>	<i>megarune...</i>
<i>Bukë</i>	<i>verë</i>	<i>ujë</i>	<i>mish</i>	<i>djathë</i>	<i>vezë</i>	<i>kripë</i>	<i>mire</i>	<i>keq</i>	<i>me ngrënë...</i>

1. Formula e Pagëzimit
2. Fjalori i Arnold fon Harfit (1497) *e saktë*
3. Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve

4. Shkruani ese me temën: *Rëndësia e dokumentimit me shkrim të një gjuhe.* (5 pikë)

5. Përdorni shqip formulën: “Unte’ paghesont premenit Atit et Birit et Spertit Senit” (Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjtë). Në cilin dialekt dhe alfabet u shkrua ky dokument? (4 pikë)

Ky dokument u shkrua në dialektin e veriut (gegërisht) dhe me alfabetin latin. Ekzistenca e shkrimit të “Formulës së Pagëzimit”, në shqip, u zbulua jo më parë se në vitin 1915.
e saktë

6. Çfarë kuptojmë me fjalë fonemë? (3 pikë)

Fjala “fonemë” vjen nga greqishtja e vjetër: *phone* - tingull, zë. Ndryshimi i tingujve vjen si pasojë e ndikimit të tyre mbi njëri-tjetrin. Kështu, për shembull, fonema *n* ndryshe shqiptohet kur ndiqet nga një zanore, si në rastin e fjalës nesër, ku ndiqet nga zanorja –e dhe ndryshe kur ndiqet nga një bashkëtingëllore e tillë si ajo –g, si në fjalën kongres.
e saktë

7. Çfarë kuptojmë me ndryshime kombinatorë? (2 pikë)

Me ndryshime kombinatorë, kuptojmë atë ndryshim fonemor që vjen si rezultat i ndikimit të një tingulli mbi një tjetër, si rezultat i kombinimit, i fqinjësisë mes tyre. *e saktë*

8. Përcaktoni ndryshime kombinatorë: (7 pikë)

1. Akomodimi (përshtatja)	vëlon: lëvon	(e saktë)
2. Asimilimi (përngjasimi)	zemra: zembra	molla: mu oll
3. Disimilimi (e kundërta e as.)	shtëpi: ship	fëtyre: fytyrë
4. Metateza (ndërrim vendi)	birbil: bilbil	birbil: bilbil
5. Shtesat e tingujve	fëtyre: fytyrë	vëlon: lëvon
6. Rëniet e tingujve	vajzë e re: vajz'e re	zemra: zembra
7. Elizioni	molla: mu oll	shtëpi: ship
		vajzë e re: vajz'e re

9. Çfarë janë ndryshimet pozicionale? (3 pikë)

Ndryshimet pozicionale janë ato ndryshime fonemore, si rrjedhojë e të cilave fonema të ndryshme mund të zhduken ose disa tipare të tyre mund të dobësohen. *e saktë*

10. Gjeni shembuj për llojet e ndryshimeve pozicionale, si: (3 pikë)

- Reduktimi i zanoreve _____ (nxënësit: nxënsit - e saktë)
- Shurdhimi i bashkëtingëlloreve _____ (shteg: shtek/ brez: bres)

11. Gjeni llojet e ndërrimeve të zanorëve në gjuhën shqipe, duke dhënë shembuj. (6 pikë)

<i>Llojet</i>	<i>Shembuj</i>

<i>Llojet</i>	<i>Shembuj</i>
Metafonia	djalë-djem / shoh-sheh
Apofonia	dal-dola / sjell-solla
Përzierja	të+e: ta / më+e: ma
Kontraksioni	voe: ve (vezë) / ngae: nge

12. Gjeni ndërrimet e bashkëtingëlloreve në gjuhën shqipe, duke dhënë shembuj. (6 pikë)

<i>Llojet</i>	<i>Shembuj</i>
k-q	mik-miq; park-parqe
g-gj	zog-zogj; breg-brigje
s-t	shes-shet; flas-flet
ll-j	kungull-kunguj; yll-yje
r-j	lepur-lepuj; flamur-flamuj
r-rr	bjerr-bora; nxjerr-nxora

Nota	1	2	3	4	5
Pikë	0-19/0-38%	20-29/40-58%	30-39/60-78%	40-44/80-88%	45-50/90-100%

Referenca:

- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2011), *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2016), *Kurrikula Bërthamë (e rishikuar)*.
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (2019), *Plani dhe programi lëndor për klasën e tretë në arsimin e mesëm të ulët në Republikën e Kosovës (i rishikuar)*.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:811.18(072)(075.2)

Zeqiri, Melihate

Gjuhë shqipe 8 : libër për mësuesin/en : për klasën e 8-të të
arsimit 9-vjeçar / Melihate Zeqiri, Meleqe Kursoni, Dafina
Roka. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 246 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm

1. Kursoni, Meleqe 2. Roka, Dafina

ISBN 978-9951-843-22-5

Libër për mësuesin/en

Gjuhë shqipe

8

ISBN: 978-9951-843-22-5



9 789951 843225